



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27, 28 MARS DHE 3 PRILL 2014

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27., 28. MARTA I 03. APRILA 2014. GODINE

MARS/PRILL - MART/APRIL
2014

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
5. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o opštim izborima u Republiki Kosova,
5. Izbor Narodnog advokata,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Kosovskoj agenciji za upoređivanje i proveravanje svojine,
7. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Organa za razmatranje javne nabavke za 2013. godinu,
8. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatorne komisije za Javnu nabavku za 2013. godinu,
9. Razmatranje Izveštaja Komisije za evropske integracije o nadgledanju sprovođenja Zakona o readmisiji,
10. Razmatranje i usvajanje Deklaracije o partnerstvu između Skupštine i Civilnog društva,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br.04/L-061 o prodaji stanova za koje postoji stanarsko pravo.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta.

Nëse grupet parlamentare kanë deputetë që flasin në emër të grupit është mirë të lajmërohen. Partia Demokratike, a flet ndokush në emër të Grupit? Jo. Lidhja Demokratike? Jo. “Vetëvendosja? Jo. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës? Po.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Pushtetit Lokal,
Përshëndetje për deputetët e Parlamentit të Kosovës,
Javën e kaluar, së bashku me kolegun Armend Zemaj, ishim të ftuar në Parlamentin polak në një takim me përfaqësues të parlamenteve të 15 shteteve evropiane për t’i shkëmbyer përvojat e funksionimit të praktikave parlamentare të shteteve me demokraci të konsoliduar dhe demokraci të brishta.

Për ju, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe për publikun kureshtar, po e sjell një fakt mjaftë relevant dhe inkurajues.

Kuvendi i Kosovës i ka në funksion praktikat parlamentare më të avancuara evropiane, ishte konkludim i të gjithëve në këtë takim.

Këtë fakt po e sjell për dy arsye, sepse ky Kuvend dhe kjo përbërje e deputetëve është bërë tabelë qitjeje e gjithkujt dhe goditjet vijnë nga gjithkrah.

Dhe e dyta, që është shumë e nevojshme ta zhvillojmë edhe më shumë, të rritet kontrolli i zbatimit të ligjeve.

Shteti ligjor duhet të funksionojë për njeriun dhe vetëm për njeriun. Një krahasim shkarazi për ta akceptuar sidomos domosdoshmërinë e funksionimit të shtetit ligjor do të mundohem ta përshkruaj me një togfjalësh të vrazhdë, por ilustrativ.

Pa shtetin ligjor, shoqërinë më shumë e dëmtojnë njerëzit se bagëtia. Një bagëti mund të hyjë ta dëmtojë grurin, misrin, apo një të mbjellë barishtore, por ajo do të dëmtojë aq sa

mund ta mbushë barkun dhe të ngihet, pastaj ndalet dhe do të përfundojë procesi i dëmtimit.

Shteti ynë ka ndërmarrë një veprim për matrikulimin dhe po të duam ta identifikojmë bagëtinë kjo mund të bëhet nëpërmjet atyre numrave dhe nuk e mohon dëmin. Njeriu pa shtetin ligjor nuk e ka shprehinë e bagëtisë vetëm sa për ta mbushur barkun dhe as për të mos e mohuar dëmin. Është i pangishëm, i pandalshëm, e madje i pangopshëm. Njeriu nuk di të ndalet, përkundrazi familjarizohet me këtë shprehje derisa ta ndalë forca e ligjit.

Kontrolli i zbatimit të ligjeve nëpërmjet mekanizmave parlamentarë duhet të forcohet gjithsesi dhe me kapacitete të plota nga Kuvendi i Kosovës në çdo përbërje të përparojë dhe kjo është një e domosdoshme, që natyrisht se e preferojnë të gjithë njohësit e mirë të fushës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Por, ti e di atë sintagmën “E di luga çka ka vegshi”. Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Dje në Suharekë u varrosën martirët e lirisë. Nga dhimbja e familjarëve dhe qytetarëve të dukej se kishin vdekur tani, e jo 15 vjet më parë.

Nga shiu që binte dukej se edhe qielli qante, sepse po varroseshin disa fëmijë të pafajshëm, që u vranë në mënyrën më mizore.

Kjo është njëra nga ngjarjet më të dhimbshme gjatë luftës në Kosovë. Them ndër më të dhimbshmet, sepse aty vdiqën shumë fëmijë, gra e pleq.

Në kujtim të atyre, kësaj here do të sjell disa fragmente të marra nga rrëfimi i Shyhrete Berishës, e mbijetuar, së cilës atë ditë iu vra bashkëshorti, dy vajza dhe dy djem.

“Duke ikur të shastisur nga të shtënat në drejtime të ndryshme, ne u ndalëm te vendi që kishte qenë kafene shqiptare dhe atje gjetëm edhe familje të tjera, Berisha. Serbët kishin qëlluar kundër fëmijëve të mi, kur ata po largoheshin me vrap. Altini, i cili ishte i qëlluar, zemra po i rrihte shumë shpejt dhe fytyrën e kishte të zbehtë. E mora Redonin nga Majlinda dhe nxora një shishe qumësht, që e kisha në pantallona, dhe ia dhashë. Pas sulmit të parë, ata duket të na kenë dëgjuar kur po flisnim, sepse erdhën te dera dhe hodhën përsëri granata. Nuk mbaj mend ndonjë shpërthim, por kur u ktheva t’i shikoj fëmijët e mi, e pashë djalin tim Redonin të ulur atje, i mbuluar me gjak dhe ende mbante në dorë shishen me qumësht. Pashë Majlindën me gjysmë kafke, pashë Ismetin e vogël 3-vjeçar që po qante dhe po thërriste emra të të gjithëve dhe kërkonte ujë”.

E solla në kujtim këtë ngjarje, duke e lutur Zotin që kurrë më të mos përsëriten.

Familjarët e tyre kërkojnë nga Qeveria e Kosovës dhe nga faktori ndërkombëtar të bëjë presion mbi Serbinë dhe të kërkojë që të tregojë se ku janë edhe rreth 1 700 persona të zhdukur në luftën e vitit '98-'99.

Familjarët kanë të drejtë të kërkojnë dhe të dinë për fatin e më të dashurve të tyre. Edhe pse shteti agresor asnjëherë, edhe pas luftës, nuk tregoi civilizim, asnjëherë nuk kërkoi falje për të gjitha viktimat dhe dëmet e bëra gjatë luftës, është momenti i fundit për të bërë presion edhe nga faktorët ndërkombëtarë për të zbardhur çështjen e pagjeturve, për të zbutur, apo lehtësuar sa do pak dhimbjen e familjarëve.

Dje organizata joqeveritare "Gratë në të zeza" e mori hapin dhe kërkoi publikisht falje. Këtë duhet ta bëjnë edhe institucionet në Serbi.

Edhe në fund, djali i vogël i mbijetuar, Gramozi, sot ekonomist i diplomuar, studenti im i mirë, tha: "Ne jemi mjaftueshëm të fuqishëm të përballemi me këtë fat. Ata që e shkaktuan padrejtësinë duhet t'i frikësohen së ardhmes, ndërsa ne duhet t'i gëzohemi asaj".

Për të gjithë ata që e dhanë jetën për liri...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: "Vetëvendosja" nuk ka. Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Siguria e qytetarëve është temë për të cilën nuk duhet të ketë asnjëherë kompromis dhe siguria e jetës dhe e pronës së qytetarëve është obligim kushtetues i shtetit, i mekanizmave të shtetit, të cilët udhëhiqen nga Qeveria qendrore.

Rritja enorme e rasteve të cenimit të jetës dhe të pronës së qytetarëve të Kosovës anekënd saj definitivisht është kthyer në një shqetësim të madh dhe mbi të gjitha është një dështim i madh i kësaj Qeverie që po shkon.

Qytetarët e Pejës do të protestojnë nesër për shkak të mungesës së sigurisë.

Qytetarët e Karaçevës të Dardanës kanë protestuar shumë herë, shpeshherë për shkak të mungesës së sigurisë.

Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme vazhdojnë të jenë dëshmitarë të rrahjeve, plagosjeve apo vrasjeve brenda shkollave, apo rreth tyre. Dhe, raste të tilla të këqija vazhdojnë.

Normalisht, nuk po e shohim kryeministrin të shkojë në vendin e ngjarjes. Nuk ka se si t'u premtojë këtyre qytetarëve të shqetësuar dhe të frikësuar as investime, as paga, sepse mendjen e ka te pushteti.

Kryeministri, zëvendëskryeministrat që i ka me bollëk, ministrat që i ka të shumtë, zëvendësministrat të cilët as emrat opinionioni publik nuk ua di, nuk e kanë këtë shqetësim. Për vete sillen edhe me roje, edhe me vetura të shtrenjta që i paguan populli i Kosovës, dhe duken se nuk e kanë fare idenë se cili është niveli i ndjenjës të pasigurisë së qytetarëve për jetën dhe pronën e tyre.

Vrasjet janë rritur, vjedhjet janë rritur, aksidentet janë rritur.

Në anën tjetër, përgjegjësia e Qeverisë ka rënë. Madje, kohëve të fundit dhe rasteve të fundit tashmë nuk po e shohim se këta rreth 60 zyrtarë të lartë që paguhen nga Buxheti i Kosovës, të sistemuar në pozita të larta të Qeverisë, nuk po e marrin mundin as të paktën deklarativisht të solidarizohen me familjarët e të vrarëve nëpër komuna të ndryshme anekënd Kosovës.

Në anën tjetër, në nivelin komunal situata është e rëndë dhe e dhimbshme. Ai zotëria që krejt fushatën e egër parazgjedhore e kishte kthyer pikërisht në temën e sigurisë dhe gjendjen e sigurisë në Pejë, tashmë e ka mbyllur gojën. Nuk i funksionon as këshilli komunal për siguri në bashkësi. Duket se nuk e ka as idenë më të vogël se çfarë mund të bëjnë institucionet për sigurinë e qytetarëve.

Ndërkohë Qeveria qendrore ka telashe të tjera, ka preokupime tjera, vazhdon t'i punësojë të afërmit, familjarët e vet, të ndaj tenderë, vetë interesohet për...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Gëzim Kelmendi e ka fjalën, në emër të Grupit.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

Pothuajse ka kaluar një vit nga muaji prill i vitit të kaluar 2013, kur në të njëjtin vend, të njëjtën foltore, pothuajse për të njëjtën arsye kam dalë ta ngre këtë çështje dhe prapë fatkeqësisht më duhet ta bëj pas një viti, ngase është e natyrës së njëjtë.

Rasti në fjalë ka qenë që në muajin prill të vitit të kaluar në qytetin e Pejës është vrarë afaristi pejan, Sali Kastrati. Dhe, unë këtu, nga kjo foltore e Kuvendit të Kosovës i kam kërkuar nga ministri i Brendshëm të organizojë një njësi speciale 'task forcë' për atë regjion si qytet i ndjeshëm për shkak të situatës së rëndë, me të cilën atje po ballafaqohen qytetarët e Pejës, dhe fatkeqësisht, jo që nuk është arritur të themelohet ajo njësi speciale, por ne në vitin 2013 është shuar njësia speciale në rajonin e Pejës. Dhe, ç'është më e keqja, rastet e rënda dhe vrasjet po ndodhin, ashtu siç është kjo vrasja e fundit, i cila është mjaft tronditëse për qytetarët e Pejës, kur në mes të ditës, në qendër të qytetit të Pejës, në

largësi jo më të madhe se 300 metra nga Stacioni Policor i Pejës, vriten qytetarët e Pejës, ndërsa vrasësit ende sot e kësaj dite, as ata në të kaluarën dhe as tash, nuk zbulohen.

Unë e di që Policia e Kosovës ka nevojë për mbështetje, edhe logjistike, edhe morale, edhe materiale. Pa dyshim që rritja e pagave duhet ta përfshijë këtë sektor shumë më shumë se sektorët tjerë për faktin se kemi të bëjmë me një shkallë të lartë të krimit të organizuar dhe mungesës së sigurisë.

Jo rastësisht në Raportin e Progresit, Kosova cilësohet si vendi me shkallën më të lartë të krimit të organizuar.

Prandaj, kërkoj edhe një herë nga ministri i Brendshëm që maksimalisht ta shfrytëzojë potencialin e tij në kuadër të Ministrisë së Brendshme, që në atë rajon të themelohet një njësi speciale e Pejës, e cila do të kontribuojë për të gjitha këto vrasje që ka ndodhur deri më tash dhe njëherë e përgjithmonë qytetarët e Pejës, rajonit në përgjithësi dhe Kosovës në përgjithësi të jenë të qetë dhe të mos ballafaqohen me vrasje të tilla të përditshme dhe të dhunës se, në fund të fundit, një fjalë e urtë popullore thotë: “Në çdo send të keq ka një dritë”. Edhe këtu po them, në të gjitha këto po ndodh diçka që vërtet na jep të kuptojmë diçka të mirë dhe një argument se në kohën e fundit, e di që ndoshta dikush nuk do të pajtohet me mua, por është përfolur shumë për mandatin e EULEX-it në Kosovë dhe unë mendoj që me gjithë këto vrasje që po ndodhin në Kosovë, shkallës së lartë të krimit të organizuar, është herët të mendohet për largimin e EULEX-it nga Kosova.

Ende ka mjaft punë këtu për EULEX-in për faktin se mungon vullneti, mungon dëshira që të luftohet krimi i organizuar në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Grupit “6+”, Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Kosova Eğitim Yasasının 27.2 maddesine göre, I-IX sınıflarda okuyan öğrencilere Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığı tarafınca kitapların basılarak, ücretsiz dağıtılması gerekiyor.

Bugüne kadar sunmuş olduğumuz çabalarımızla, yasayı kısmen yürürlüğe geçirebilmenin mutluluğunu yaşıyoruz.

Ancak burada da Türk toplumuna yapılan bir ayrımcılıkla karşı karşıya geliyoruz.

I-IX sınıflara kadar, diğerleri arasında sekizinci ve dokuzuncu sınıfların ders kitaplarında ana dili ders kitabı olan “Türkçe Okuma “ kitabı bile yokken, diğer dillerde basılan ders kitaplarında Matematik ve Yurttaşlık ders kitapları yanısıra, ek ders kitabı ile çalışma defterleri de ta 2007-2011 yıllarında baskıdan çıkmış bulunmaktadır.

Topluluk haklarına, insan haklarına ve çocuk haklarına aykırı olan bu davranışın ortadan kalkmasını arz ediyoruz.

Kosova'da yaşayan diğer topluluklarla birlikte, Türk toplumunun yapıcı unsur olmasıyla birlikte, diğer dillerdeki eğitime önem verildiği kadar Türkçe eğitime de verileceğine inanıyor ve bu eksikğin en kısa zamanda giderilmesini bekliyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën, në emër të Grupit.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar, kryetar!

Deputetët të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kosova sapo ka hyrë në 6-vjetorin e pavarësisë dhe ekzistencës si shtet i pavarur dhe i shpallur, e po t'i ishte thënë diku që pas 6 vjetëve dhe pas gjithë kësaj kohe papunësia dhe varfëria do të jetë në nivelin e njëjtë si në vitin 2004, apo 2005, kjo do të ishte dukur e pabesueshme, por ja jemi në vitin 2014 dhe Qeveria e Kosovës nuk ka ditur se si ta përkthejë shtetësinë e Kosovës në mirëqenie, punësim dhe zhvillim për popullin e Kosovës.

Pushteti politik ka shërbyer si privilegj për përfitime personale në dëm të forcimit të shtetit. Pavarësia e Kosovës nga pushtetarët qeveritarë është konceptuar më tepër si një arritje individuale që atyre ua siguron madhështinë e përjetshme në altarin e historisë, aq sa të mos kenë nevojë të punojnë për shtetin, por që shteti të punojë për ta.

Ajo që e ka karakterizuar pushtetin qeveritar të Kosovës në këto 6 vjetët e pavarësisë ka qenë po ashtu një prirje e vazhdueshme për të lëshuar pe ndaj Serbisë. Qeveritarët e Kosovës janë treguar kompromisaxhi të pashembullt.

Në vitin 2008 trumbetohej se gjithçka me Serbinë kishte përfunduar dhe se i takonte së kaluarës. Në vitin 2011, kryeministri Thaçi premtoi se nuk do të ketë negociata me Serbinë për çështjet e brendshme të Republikës së Kosovës. Më 2011 filluan negociatat me Serbinë pikërisht për çështjet e brendshme të Kosovës. Në vitin 2012 nisën takimet e nivelit të lartë ndërmjet Thaçit e Daçiqit dhe një vit më pas, si pasojë e këtyre takimeve, na erdhi marrëveshja me Serbinë, e cila e sakatoi shtetësinë e vendit tonë, duke e krijuar Bashkësinë e Komunave Serbe, si dhe një polici dhe drejtësi me bazë etnike. Kurse në vitin 2014, pra në vitin e tanishëm, Serbia po mban zgjedhje nacionale brenda Kosovës, kurse Qeveria e Kosovës po bën sehir.

Prej vitit 2008 mund të renditen me dhjetëra raste, të cilat tregojnë se Qeveria e Kosovës ka hequr dorë nga mbrojtja e shtetësisë sonë me një lehtësi të paparë. Regjistrat civilë e librat kadastralë kopje, fshehja e targave të automjeteve, mospranimi i pasaportave nga Serbia, fusnota, mungesa e simboleve shtetërore nëpër komunat serbe, si dhe prania e simboleve të Serbisë nëpër komunat e veriut, heqja e stemës nga fletëvotimet e zgjedhjeve, mohimi i simboleve shtetërore për t'ua bërë qejfin kryetarëve të komunave të veriut të Kosovës, inkorporimi i pjesëtarëve të MUP-it nëpër strukturat institucionale të pjesës veriore të Kosovës, e kështu me radhë.

Qeveria jonë e ka shndërruar Kosovën në shtetin e vetëm në botë, i cili madje negocion edhe me zyrtarët e vet. Në njërën prej takimeve negociatore në Bruksel, në anën e kryeministrit të Serbisë, Daçiq, ishin edhe pjesëtarët e Listës serbe, kurse kryeministri Thaçi dhe Qeveria jonë negocionte me zyrtarët e vet. Ky, ma merr mendja se është rasti i

vetëm në botë, kur Qeveria thotë që këta zyrtarë të zgjedhur po punojnë për shtetin e Kosovës, kurse në fakt ata shkojnë dhe rrinë në krahun e kryeministrit të Serbisë, Ivica Daçiq. Të gjitha këto tregojnë se politikanët dhe Qeveria janë ata që po bëjnë koncesione të vazhdueshme me shtetësinë dhe janë pikërisht këta të njëjtit, të cilët më së shumti i akuzojnë ata që nuk kursejnë asgjë për forcimin e sovranitetit dhe shtetësisë të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtë vit, qytetarët e komunës së Vushtrrisë pritët ta realizojnë ëndrrën e tyre për të pasur ujë të pijshëm nga rrjeti i ujësjellësit në sasi të mjaftueshme, pasi punimet në ndërtimin e fabrikës së përpunimit të ujit të pijshëm po shkojnë sipas dinamikës së paraparë me kontratë. Këtë informatë e sigurova dhe për t'i qetësuar dhe demantuar zërat që kanë filluar t'i hutojnë qytetarët lidhur me një të pavërtetë sikur fabrika i ka ndërprerë punimet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Duke e ditur që ky lajm ka shkaktuar shqetësim te ju, drejtpërdrejt nga zyrtarët që e përcjellin këtë dinamikë të punës dhe kontraktorët e punimeve, dua që nga kjo ulëse e Parlamentit të ju inkurajoj të gjithë ju për të qenë të sigurt se shumë shpejt do ta kemi mbyllur një herë e përgjithmonë një hall që nuk ka qenë lehtë i përballueshëm për të gjithë ne.

Duke qenë një projekt aq i madh, sigurisht që i ka pasur të parapara edhe fazat dhe dinamikën e tij të punës dhe në këtë drejtim po ashtu konfirmoj se 75% e punimeve të saj kanë përfunduar, duke kujtuar që projekti ka qenë trevjeçar.

Aktualisht, pra, punimet janë në ndërtim të rezervarit të ujit dhe janë në përfundim, kështu që pritët vetëm vendosja e gypave dhe mbulimi i tyre me dhe. Ndryshe, ky rezervuar ka kapacitetin e 10 milionë litrave dhe është ndërtuar në kodrën ndërmjet fshatrave Balincë dhe Oshlan, në lartësi prej 650 metrave.

Sipas kësaj dinamike, fabrika e ujit do të jetë në shfrytëzim nga qytetarët në këtë vit dhe me kapacitet prej 350 litrave në sekondë. Kjo fabrikë do të pajiset me teknologjinë më të re bashkëkohore. Krahas rregullimit të rezervuarit të ujit, janë duke u kryer punimet në ndërtim të rezervarit për pastrim në thellësi prej 11 metrash dhe 7 baseneve të tjera përcjellëse.

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë këtë premtim e morën në vitin 2011 nga kryeministri i vendit dhe tanimë po bëhet realitet. Qytetarët e komunës së Vushtrrisë, me zgjidhjen e këtij problemi që preokupon me dekada, e mbyllin një epokë të përmbushjes të projekteve të mëdha nga infrastruktura. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë unë e kam shprehur shqetësimin tim lidhur me gjendjen e sigurisë në vend, me theks të veçantë ngjarjet e fundit në regjionin e Pejës. Andaj, edhe sot dua ta bëj një gjë të tillë, ta ngre këtë çështje në këtë Kuvend, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ditë më parë, në këtë Kuvend u debatua për gjendjen e sigurisë në shkollat tona dhe pati shumë folës nga ne për këtë temë dhe u vlerësua se gjendja e sigurisë te institucionet shkollore nuk është e mirë. Në këtë fillimvit, rastet e vrasjeve dhe plagosjeve kanë shënuar rritje dhe këtë e them bazuar në kronikat e përditshme të mjeteve të informimit.

Rasti i fundit në Pejë, ku u vranë 2 persona dhe 6 të tjerë u plagosën, përbën shqetësim për qytetarët e vendit, përbën shqetësim në veçanti për qytetarët e asaj pjese dhe natyrisht do të duhej të ishte shqetësim edhe për ne. Në mesin e plumbave të shkëmbyer atë ditë, në mes të ditës, sipas medieeve, u vra një person kalimtar i pafajshëm dhe 6 të tjerë u plagosën. Mendoj që shumë qytetarë atë ditë të asaj pjese janë ndier me fat që nuk kanë qenë kalimtarë të rastit.

Vrasësit deri më tani nuk u zunë, andaj institucionet e sigurisë duhet ta kryejnë punën e tyre, duhet të krijojnë ambient të qetë dhe të sigurt për qytetarët e vendit, në përgjithësi. Sipas qytetarëve, gjithnjë në atë pjesë, pas orës 20:00 dhe 21:00 nuk dilet më në qytet.

Policia e Kosovës, si institucion me imazh pozitiv, i besueshëm për qytetarët e vendit, i pranueshëm, këtë imazh nuk mund ta ruajë vetëm me spote dhe reklama, por duhet ta ruajë me zgjidhjen e rasteve të tilla. Pajtohem me zotëri Krasniqin, nga PDK-ja, që thotë se Kosova duhet të funksionojë si shtet ligjor, duhet të funksionojnë institucionet e rendit dhe të sigurisë dhe assesit nuk duhet neglizhuar situatën e sigurisë së krijuar në vend, sepse ajo mund të çojë deri në përshkallëzim, edhe pse, edhe si e tillë, është mjaft shqetësuese. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pasi zotëri Ramadani nuk i shfrytëzoi minutat Grupit, por vetëm 3 minuta, atëherë minutat e Grupit të Aleancës po i shfrytëzoj unë.

I nderuar zoti kryetar,

Kolegë deputetë,

Ministra,

Unë do ta ngre një çështje që e kam ngritur edhe disa herë në këtë Kuvend, që të gjitha institucionet e Kosovës, në aspektin e punësimit, ashtu siç e ka me ligj për mbrojtjen dhe të drejtën e komuniteteve, nuk është duke i kryer ato obligime.

Edhe zoti Krasniqi tha që në Poloni na kanë lavdëruar për legjislacion shumë të mirë, por na kanë kritikuar për shkak të moszbatimit të ligjeve. Prandaj, ne këtu si ligjvënës jemi që ato ligje të zbatohen me përpikëri. Dihet që Ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve e ka një nen, në të cilin thuhet që të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të jenë punësuar në ndërmarrje publike, bie fjala në KEK, në PTK, në Aeroport, dhe në të gjitha këto ndërmarrje asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian nuk është i punësuar. Atëherë kjo është shkelje e ligjit drejtpërdrejt.

Ne e dimë që kemi shumë mekanizma për mbrojtjen e komuniteteve, por mund të them lirisht se janë shumë sterilë. Për shembull, Komisioni për Komunitete, Këshilli Konsultativ për Komunitete, i cili merret vetëm me këshilla, dhe shumë mekanizma tjerë. Unë jam i interesuar që të gjithë këta mekanizma të bien poshtë dhe të fillojë me të vërtetë integrimi i sigurtë i disa komuniteteve, të cilat nuk janë të integruara në shoqërinë kosovare. Unë dua ta përmend vetëm raportin e fundit të Human Rights Watch, i cili thotë që komuniteti egjiptian është i diskriminuar në Kosovë. Unë nuk dua që në raportet e organizatave të tilla të dalin raporte të tilla, kur institucionet tona vendore mund t'i kryejnë këto obligime ligjore.

Nuk kërcet kiameti nëse në Policinë e Kosovës mund të ketë më tepër pjesëtarë të komunitetit egjiptian. E marrim rastin e Gjakovës, ku jetojnë mbi 5 000 pjesëtarë të komunitetit egjiptian dhe nuk është asnjë polic. Ndoshta e meta e tyre është sepse nuk kanë përvojë në MPB, ndoshta ajo është e metë, sepse shkolla të mesme ka, përgatitje shkollore kanë, mirëpo e meta është ndoshta nuk kanë përvojë. Dhe, derisa merret me urdhëresë të pranohen 300 pjesëtarë të këtij ose atij komuniteti, është mirë që të punësohen edhe disa pjesëtarë të komunitetit egjiptian. Kjo duhet të ndodhë edhe në Doganë, kjo duhet të ndodhë edhe në institucionet vitale të shtetit.

Shpeshherë themi dhe i marrim shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe para 10 vjetëve unë isha atje, e në asnjë institucion nuk shihja njerëz të një race, por shihja edhe afrikano-amerikanë, shihja edhe evropiano-amerikanë, shihja edhe hespanikë, prandaj edhe Kosova duhet të jetë e tillë, dhe jo vetëm në letër, jo vetëm të jetë multietnike, por në të vërtetë Kosovë multietnike, po në të vërtetë të jetë në praktikë multietnike, të jetë e punësuar dhe nuk është sikur kohëve të fundit, shumë subjekte politike janë duke e marrë si ditë të kiametit nëse bëhen edhe vende të rezervuara edhe një mandat.

Unë dua të them dhe jam le të hiqen vendet e rezervuara, por le të bëhet integrimi i plotë, le të jenë njerëz të mi edhe në Postë, le të jenë njerëz të mi edhe në KEK, le të jenë njerëz të mi edhe në Polici, jo vetëm punëtorë fizik, jo vetëm sharrëxhinj , por të jenë asi qysh i përket edhe në bazë të përgatitjes shkollore dhe superiore.

Unë besoj që edhe komuniteti egjiptian ka njerëz të tillë, ka konkurse të tilla, po asnjëherë ose nuk thirren ose anashkalohen. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka pa grup ose po vjen rrallë, dhe fundit është deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani kolege poslanici,
Želim vrlo kratko da iskoristim ovo vreme i da izrazim svoju zabrinutost zbog hapšenja i privođenje advokata na severu Kosova i Metohije sa jedne strane, a sa druge strane jednu nezainteresovanu....., zato što prema mojim informacijama koje dolaze gospodin Berani iz južne Mitrovice gotovo dnevno se konsultuje sa potencijalnim svedocima u procesu protiv Olivera Ivanovića i po mojim saznanjima on indoktriniran te ljude u smislu načina na koji će optužiti gospodina Ivanovića.

Ja duboko verujem poznavajući ga jako dugo i znajući koliko je učinio na u posle ratnom periodu na približavanje Srba i Albanaca da zaista Oliver nije čovek koji mogao da ubija i sa te strane ja bih zamolila da i delovanje gospodina Beranija bude pod monitoringom u smislu pritiska na potencijalne svedoke. Hvala!

KRYETARI: Është harxhuar koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Deputetët është mirë t'i presin vendimet e gjykatave dhe pastaj t'i thonë mendimet e tyre.

Po, nga Qeveria ka kërkuar fjalën e vet, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri.

ZËVENDESKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni të jap disa nga pikëpamjet tona si Qeveri e Republikës së Kosovës lidhur me suksesin e madh që e ka mbërri Kosova në gjashtë vitet e pavarësisë, në të gjitha planet dhe t'ju them që për të parë sukseset e një shteti që ka vetëm gjashtë, vjet duhet të bëhet analiza komparative me shtetet të cilat kanë kaluar shtet ndërtimin dhe për të parë se çfarë kanë mbërri ato shtete për këto gjashtë vjet.

Në bazë të shumë analizave, por edhe vlerësimeve të Qeverisë tonë mund të themi se forcimi i shtetit të Kosovës në planin e brendshëm dhe në planin e jashtëm rrinë lartë në listën e shteteve që për kohë të shkurtër kanë arritur kaq shumë suksese.

E dyta, për të forcuar shtetin nuk duhet përdor politika të mohimit, sepse politikat e mohimit mund të shërbejnë për interesa të ngushtë, por realisht çdo individ, çdo politikan, çdo subjekt politik duhet të jetë realist, të shohë edhe të arriturat edhe ngecjet.

Unë dëgjova këtu çështje që kanë të bëjnë me dialogun dhe më lejoni t'ju them se dialogu i Brukselit i shërben politikave të jashtme të Kosovës për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim rajonal që janë dy kushte kryesore për çdo shtet që aspiron të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

Ky dialog ka sjell rezultate të prekshme e para, nuk është marrë me çështje të brendshme të Kosovës, është marrë me ndërhyrjen e Serbisë në punë të brendshme të Kosovës, prandaj rezultatet kanë qenë në shuarjen e strukturave ilegale që të tillët që e kanë logjikën e "makushit" nuk i kanë parë që ekzistojnë në Kosovë që nga viti 1999.

Ka vënë kufirin shtetëror, janë vënë autoritete e shtetit në veri, në pikat Jarinjë dhe Bërnjak që nuk i kemi pasur për shumë vite, është mbyllur policia ilegale, janë integruar policët në Policinë e Kosovës, po mbyllet strukturat paramilitare, po shuhen strukturat e drejtësisë dhe po shtrihet sovraniteti në çdo pikëpamje, përfshirë edhe janë mbyllur komunat ilegale dhe po funksionojnë ato legale.

Për fund dhe shkurt, mendoj se të tillët që i mohojnë simbolet shtetërore të shtetit të vet, nuk kanë të drejtë të merren me mohimet që ia bëjnë ndonjë subjekt apo ndonjë individ në Kosovë. Etika politike, interesi nacional, vetëdija kombëtare e thotë: në qoftë se vetë mohon simbolet shtetërore, çfarë morali ke të kërkosësh të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë. Po, ti ke të drejtë tre minuta, Glauk.

GLAUK KONJUFCA: Zonja zëvendëskryeministre, Sytë janë për të parë dhe ju me këtë propagandë nuk mund t'i hidhni hi syve të qytetarëve të Kosovës, të cilët po e shohin dita-ditës se çka po ndodh në veriun e Kosovës.

Politika juaj ndaj Serbisë dhe ndaj veriut të Kosovës, mendoj që ka qenë një dështim total për arsye se ju keni bërë kompromise në pikat kyçe të shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës.

Ju ishit ata që me vendimet tuaja e krijuat një entitet në bazë etnike të cilin e kontrollon Beogradi e që është: bashkësia e komunave serbe, ju po gënjeni, më falni që po e përdor këtë fjalë, pra nuk po e thoni të vërtetën kur po thoni që nuk ka struktura paralele dhe kriminale në veriun e Kosovës. Njëra prej tyre është edhe Mbrojtja Civile në veriun e Kosovës, që është një strukturë e armatosur e cila nuk është shpërbërë fare dhe që ta dini të vërtetën ju madje pikërisht edhe për shkak të këtyre strukturave të cilat i kontrollon Beogradi as nuk guxon për të shkelur në veri, as nuk guxon të shkoni personalisht në veri.

Përveç kësaj unë mendoj që lista serbe e Daçiqit e cila i mori pushtetet lokale nëpër të gjitha këto komunat, ishte një dështim tjetër i kësaj Qeverie të Kosovës, e cila thoshte se partnerët tanë të koalicionit dhe serbët e moderuar do ta marrin pushtetin në këto komuna. Ishte politika e Daçiqit ajo e cila ngadhënjeu dhe në anën tjetër ju nuk ishit të gatshëm që të dilni në krye të detyrave për mbrojtjen e shtetësisë së Kosovës.

Një dështim tjetër i Qeverisë së Kosovës janë shqiptarët e Luginës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Ju keni bërë premtime bashkë me kryeministrin që do të zgjidhet edhe çështja e tyre, përveç që nuk u zgjidh çështja e tyre, ajo është përkeqësuar edhe më shumë gjendja e tyre, ata po shpërngulen dita-ditës. Prej se keni hyrë ju në negociatë u hoq lapidari i UÇK-së, u konfiskuan librat e nxënësve shqiptarë në Preshevë dhe të gjitha këto edhe dhjetëra tjera janë dështime, të cilat duhet t'ju faturohen juve dhe për të cilat ju duhet të jepni përgjegjësi dhe të mos e mashtroni popullin e Kosovës.

KRYETARI: Replikë, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Konjufca, më duket problemi juaj është tek thënia: “sytë janë për me pa”. Nuk shihet me sy zoti Konjufca, por me mendje.

Edhe populli sheh me mendje, jo me sy dhe më duket se tash e kam kuptuar tamam se ku janë problemet, pse ju i shihni vetëm anët jo të mira dhe injoroni dhe mohoni rezultatet e prekshme që konfirmohen edhe nga faktori ndërkombëtar.

Për sa i takon veriut, ne jemi tashmë në veri, sepse kemi shtrirë sovranitetin në fushat që i theksova: në drejtësi, në siguri, në funksionalizimin e komunave, përkatësisht në pushtetin lokal, në dogana, në kontrollin kufitar të shtetit dhe kemi vu kufirin ndërshtetëror me Serbinë.

E fundit, derisa ju me retorik angazhoheni për çështjet e kombit, ne punojmë me politika strategjike për zgjidhjen e çështjes kombëtare edhe atë jo në mënyrë parciale siç po e flitni ju me Luginën e Preshevës, por të plotë, të përgjithshme bazuar në drejtësinë e cila duhet t’i ndodh kombit tonë nga padrejtësia e fillim shekullit XX. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk e kreve, një minutë e ke. Mirë, një minutë kundër replikë. Merre lexo Rregulloren edhe pastaj fol, ju lutem mos u përzini, lexoje Rregulloren dhe e sheh që unë kam të drejtë, e s’keni drejtë ju.

Jo, se keni lexuar se po ta kishe lexuar s’kishe folur hiç.

GLAUK KONJUFCA: Mendoj që të gjitha këto që i tha zëvendëskryeministrja si retorikë pompoze dhe asgjë më shumë, bien poshtë dhe bien në ujë me një fakt shumë të thjeshtë dhe vulgar.

Ende ekzistojnë barrikadat në veri, dhe ende ekziston barrikada në lumin Ibër. Kjo e tregon se sa e ka shtri sovranitetin Qeveria e Hashim Thaçit në veri. Në anën tjetër është shumë problem që sa i përket këtyre njerëzve, të cilët zëvendëskryeministrja po i quan: njerëz të cilët punojnë për shtetësinë e Kosovës, unë nuk jam i bindur që ata po punojnë për shtetësinë e Kosovës.

Unë i kam parë ata krahë për krah me Daçiçin dhe i kam parë duke e mohuar shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër pjesëtarëve të MUP-it po u njihen edhe gradat të cilat i kanë fituar gjatë viteve ’90. Gradat e policëve të cilët janë fituar gjatë viteve ’90, ne e dimë se si janë fituar. Janë fituar duke rrahur, duke maltretuar, duke vrarë dhe duke masakruar shqiptarë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Po edhe ai pastaj e kërkon një minutë. Urdhëro! Ju lutem, mos u përzieni ju tjerët, se unë jam kah e drejtoj seancën. Urdhëro, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit!

Përsëri po shihni vetëm me sy zoti Konjufca. A e dini pse? Sepse, po flitni për barrikada.

Po e dini sa kanë qenë e sa janë sot? Kanë qenë 18, sot kanë mbetur vetëm 2, që së shpejti hiqen. A e dini sa rrugë alternative kanë qenë e nuk ekzistojnë më. A e di që në Jarinjë e Bërnjak s'ke pasur as policinë kufitare, as doganat i ke me Marrëveshje e IBM-it.

A e din që deri sa ti po sheh me sy takimet e Brukselit, unë po them që nëse sheh me mendje, nuk i sheh fotografitë, por rezultatet. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk, s'ke të drejtë më. Daut Haradinaj, i ke tre minuta.

DAUT HARADINAJ: Po mundohem të flas sa më shkurt, kryetar.

Është e vërtetë, që gjendja në veri nuk ka ndërruar zëvendëskryeministre, përkundrazi duket që edhe vetëm po vazhdon të përkeqësohet. Nëse flasim për doganat, më 17 shkurt kur e keni shpallur pavarësinë e Kosovës, ka pasur dogana. Nuk ka pasur barrikada, kanë qenë doganat funksionale dhe ato në kohën kur ju e festoni në Prishtinë, digjeshin nga strukturat paralele në veri dhe është dashur shumë vite për të ardhur deri te një situatë e re me kaluar edhe nëpërmes Brukselit që sot deri diku me pas funksionim doganat.

Na kemi thënë që fusnota do të shkrihet shumë shpejtë, e patëm një ngjarje të mirë sportive kur Kosova luajti ndeshjen e parë. Nuk e di a e keni parë edhe ju a jo, kishte fusnotë edhe në fanellën e sportistëve se lëre më diçka tjetër. Flasim më konkretisht, unë shpresoj që ato fjalë tuaja janë reale, por gjendja atje nuk ka ndryshuar. Nëse shkoni sot dhe e shihni gjendjen e vërtetë, sinqerisht mundem t'ju them që është më keq se shumë vjet më përpara.

Nëse flasim keni deklaruar që nuk do të ketë zgjedhje serbe në Kosovë ose të Serbisë, edhe ne e pamë fare mirë që pat zgjedhje, pat vendvotime, pat siguri nga Policia e Kosovës, pat deklarata të zyrtarëve policorë që votimi shkoi qetë dhe i suksesshëm. Për cilat zgjedhje Policia e Kosovës e ka dhënë atë deklaratë mund të na përgjigjesh sot.

KRYETARI: Urdhëro, se të pyetën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Haradinaj,

Nuk kam dëshirë me ty kështu për të shkuar me polemika po pasi ma dhe rastin me kënaqësi po e bëj.

E para, siç e dini, edhe AAK-ja ka qenë në pushtet kur ka pasur struktura paralele.

Haradinaj, tash po flas unë. Ka pasur që nga viti 1999 struktura paralele, i ka mohuar edhe UNMIK-u me logjikën e "makushit", i kanë mohuar edhe të gjitha qeverisjet që kemi pasur, përfshirë edhe kjo e AAK-së.

Prej shqetësimeve që kam pasur unë për këto punë, doktoratura ime merret me strukturat ilegale paralele dhe dështimet e UNMIK-ut, këtu kam doktoruar, në këtë temë, sa për informim.

E dyta, fusnota hapi rrugë, zoti Haradinaj. Fusnota ia dha Kosovës Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, i rriti njohjet dhe të gjithë neve na çoi në Mitrovicë për ta parë lojën, sepse mundësoi që të hapen rrugët e futbollit ndërkombëtar për shtetin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, replikë Radë, ka kërkuar Dauti, e pastaj e keni ju fjalën! Regjia, fjalën deputetit Daut Haradinajt.

DAUT HARADINAJ: Ndoshta u keqkuptuam që unë nuk i mohova aftësitë tuaja intelektuale, domethënë këtu u keqkuptuam diçka. Pyetja ishte shumë e thjeshtë, a është shkrirë apo nuk u shkrirë fusnota te strukturat ilegale, nuk thashë që ti i ke krijuar ato struktura, po ato kanë ekzistuar dhe po vazhdojnë dhe po e bllokojnë qytetin, sikurse është rasti, për shembull në rast se ti po thua ka pasur shumë rrugë të tjera alternative, të cilat sot nuk ekzistojnë më, ku janë ato rrugë, kur ti Urën e Ibrit e ke sot të bllokuar?

Është shumë e thjeshtë. Domethënë, ne po flasim shumë konkret edhe me të thënë të drejtën, shkoj nganjëherë në Mitrovicë dhe e shoh gjendjen reale, shkoj edhe në veri. Edhe të kisha sugjeruar edhe ty të shkosh ndonjëherë në Boletin, në Cerajë, Koshtovë, atje për ta parë gjendjen se si jetojnë populli jonë, se ka shqiptarë atje. Edhe sa për me ta dhënë edhe një këshillë, fëmijët transportohen me një “kombi” tash e sa vite, nga jugu në veri. Ta marrim vetëm rastin e fundit, kur e keni shpallur “Zonë të lirë ekonomike”, nuk e keni deklaruar se cilën Mitrovicë e keni shpallur, për shkak se janë dy Mitrovica, tash. Edhe këtu domethënë, shumë sende po mundoheni t’i hidhni hi, pluhur syve popullit. Populli nuk është ...

KRYETARI: Po e dëgjojmë një herë Radën, pastaj, hajt kryeje me Dautin. Një minutë!

ZËVENDESKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Haradinaj, duke ndenjur afër me Glaukun ke marrë pak një virus të mohimit, po s’ka problem. Me respekt.

Tani kështu, më lejo të them, që nuk e di kur ke shkuar herën e fundit në veri, por po të shkosh tash, me shikimin drejt shuarjes së strukturave ilegale dhe shtrirjes së pushtetit, ka ndryshime esenciale.

E dyta, kur të doni shkojmë bashkë. Bile, bile, delegacionin e kam formuar, Glauku, ti dhe unë.

E treta, më lejoni t’ju them që sa do që do të ketë tendenca, për shkak të fushatës politike për t’i mohuar rezultatet...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani kolege,

Ja zaista ne vidim da se suštinski razlikuje ono što govori potpredsednica Edita Tahiri, i ono što su izgovorili predstavnici Alijance i što su izgovorili predstavnici Samoopredeljenja. Suštinski samo se razlikuje ko će snažnije retorički izneti projekte represije nad Srbima sa severa Kosova.

I ja ne vidim da tu ima i reči nečega što podrazumeva jednu miroljubivu integraciju severa i sve traume koje prate nažalost Srbe sa severa Kosova u smislu i hapšenja i nestabilnosti ljudi i navikavanje na jedan novi način funkcionisanja u smislu postavljanja administrativnih institucija, na koje oni nisu navikli.

Ali ono što niko ne govori, a što mene kao srpkinju zabrinjava, što suštinski ovaj Parlament nikada se nije opredelio u stvari za teritorijalni integritet Kosova.

Ovde se radi evo danima dok se pregovara sa Beogradom u smislu odlaženja institucija države Srbije paralelno se radi na uspostavljanje institucionalnih veza sa Albanijom. Pa mi bre ne možemo da dišemo. Svakog dana dolazi po neki predstavnik institucija Albanija. Da je ministar odbrane i razgovara sa zajedničkom bezbednosnom projektu, pa onda dolazi gospodin Rama, kao ministar, kao premijer razgovara se o ekonomskom jedinstvu, o obrazovnom jedinstvu, o medijskom jedinstvu, da li sa jedne strane podizanje tenzija prema severu suštinski radite na projekat koji treba da promoviše jedan panalbanski projekat. Čak imate iste probleme! U smislu da, da, i jedni i drugi, i Tirana i Priština, usvaja zakone ili menja krivični ...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Čak, svi imate zajednički problem, a to je sve masovni odlazak Albanaca kao podrška ratu u Siriji, pridruživanje ograncima Alkaide.

KRYETARI: Deputete,

Asnjë krahësim që e bëre, nuk qëndron. Politika e Kosovës është shumë humanitare, shumë integruese me të gjitha komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë e në mënyrë të veçantë me komunitetin serb. Bile, edhe ky Parlament po ta jep fjalën sa herë gati po e kërkon dhe ti asnjëherë nuk po e respekton atë që është Kushtetutë, me të cilën ke ardhur në këtë Parlament.

Dhe, ne jemi të interesuar të kemi bashkëpunim tepër të ngushtë me Republikën e Shqipërisë, se shqiptarë jemi. Nuk jemi kundër bashkëpunimit me Serbinë, po Serbia duhet ta ndryshojë qasjen ndaj Kosovës dhe ndaj qytetarëve serbë në Kosovë.

Zëvendëskryeministre, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputete Trajković,
Ju dëgjova me vëmendje, observimet e juaja, edhe pse në pjesën kur folët për integritetin territorial të shtetit të Kosovës, që e keni bërë edhe publike, si përkrahje e kam çmuar gjithmonë, pjesa tjetër e diskutimit tuaj nuk ishte realist, sepse normale është kur ndërhysh ish-okupatori në punët e brendshme të shtetit tjetër, normalisht që ndodhin, siç ndodhin polemikat tona, sepse është frika nga mospërsëritja e ndërhyrjeve dhe frika, sepse ishte një gjenocid, jo vetëm dhjetëvjeçar, po njëqindvjeçar kundër shqiptarëve.

Prandaj, këto vijnë nga shqetësimet se çfarë, a po ndodh me të vërtetë integrimi i serbëve të veriut në institucionet e Kosovës, a ka dalë Serbia përfundimisht nga ndikimet dhe ndërhyrjet në pjesën veriore të shtetit tonë?

Prandaj, ju kisha lutur, shihini në kontekstin pozitiv, të fqinjësisë së mirë dhe të standardeve evropiane të mosndërhyrjes se një shteti në shtetin tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe pse na nxore punë, zëvendëskryeministre!
Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

I kemi gjithsej 16 pyetje parlamentare. Po fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

Kryeministri nuk është këtu. Deputete, a dëshiron ta parashtrosh pyetjen? Fjalën deputetes.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Siç edhe jeni në dijeni, familjet e veprimtarëve të Lëvizjes së Kosovës për Liri, Pavarësi dhe Demokraci të Kosovës, të vrarë gjatë luftës dhe pasluftës, si Ahmet Krasniqi, Enver Maloku, Xhemajl Mustafa, Tahir Zemaj, Shaban Manaj, Ukë Bytyçi, Ismet Rraci, Smajl Hajdari, e të tjerë, nuk gëzojnë asnjë përkujdesje institucionale.

Edhe përkundër asaj se këto familje dy herë ju kanë drejtuar me kërkesë për zgjedhjen e statutit të tyre, ato asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje nga ana e juaj. Duke pasur për bazë angazhimin jetësor të këtyre veprimtarëve të shquar të kombit, konsideroj se Qeveria e Republikës së Kosovës është dashur të trajtojë kërkesën e tyre.

Andaj, kërkoj nga ana e juaj, zoti kryeministër, që të më njoftoni se si i keni marrë veprimet për zgjedhjen e statutit për këtë kategori të veprimtarëve të kombit?

Unë besoj, se edhe këta qeveritarë këtu që janë do t'ia përcjellin këtë mesazh, pra kryeministrit, por do të kishte qenë mirë ta dëgjonte edhe zonja Edita Tahiri e jo me dalë jashtë. Edhe derisa kjo zonjë këtu e përmend, thotë: “Kosovë e Metohi”, zonja në fjalë, pra Edita Tahiri nuk ia tërheq vërejtjen. Kjo duhet me ia tërheq vërejtjen pra si

zëvendëskryeministër, e jo kjo sa herë që thotë, thotë: “Kosovë Metohi”. Kjo le ta dijë se s’ka “Kosovë Metohi”, por është shtet i Republikës së Kosovës edhe është duke jetuar në Republikën e Kosovës, pra në shtetin e Kosovës.

KRYETARI: Zëvendëskryeministrja nuk e drejton Parlamentin, deputete. Vazhdojmë. Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Ferid Agani.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Pyetja ime është e përsëritur edhe njëherë, meqenëse ministri i Shëndetësisë nuk ishte herën e kaluar dhe unë jam i interesuar të di, konkretisht mbi çështjen e burgosjes së mjekut dhe mjekëve në këtë rast zotit Shpend Elezi, i cili burgoset në mënyrë shumë të turpshme dhe i cili turpërohet, duke tejkaluar të gjitha procedurat nga Prokuroria.

Dhe, konkretisht pyetja shtrohet: Ne kemi miratuar Ligjin e Odës së Profesionistëve Mjekësorë këtu në Parlament dhe sa është respektuar ai ligj?

Nëse nuk është respektuar, ne duhet ta tërheqim ligjin dhe të vazhdojmë për interesa personale të tjerët të merren me mjekët në mënyrë të papërgjegjshme dhe duke i shkelur edhe vetë Prokuroria dhe drejtësia, të drejtat e njeriut, të drejtat e profesionistëve mjekësorë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Muja,

Faleminderit për ngritjen e shqetësimit përkitazi me këtë rast, i cili për fat të keq nuk ka qenë i izoluar. Në periudhën e pasluftës kemi pasur raste disa herë, kur në procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka pasur shkelje të qarta procedurale, me të cilat është shkelur rëndë dinjteti i profesionistëve shëndetësorë. Dhe, në emër të një publiciteti medial kemi shkaktuar humbje serioze të besimit të qytetarëve në shëndetësinë e vendit dhe denigrimin etik dhe moral të personalitetit të profesionistëve shëndetësorë.

Ministria e Shëndetësisë ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë e përkushtuar për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të vendit dhe evitimin e gabimeve profesionale të profesionistëve shëndetësorë. Kemi qenë, do të jemi në vazhdim për ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies gjatë ushtrimit të profesionit mjekësor.

Duhet t’i mbështesim organet e drejtësisë në vazhdimësi në ushtrimin e detyrave të tyre ligjore, mirëpo njëkohësisht do të angazhohemi fuqimisht për mbrojtjen e dinjtetit të profesionistëve shëndetësorë dhe nuk do të lejojmë nëpërkëmbjen e dinjtetit të tyre, nëpërkëmbjen e personaliteteve, profesionistëve të cilët me dekadat e tyre kanë qenë shërbim të shëndetit të qytetarëve.

Konkretisht, në rastin e doktorit të nderuar Shpend Elezi, ish-prodekanit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, Ministria e Shëndetësisë, konkretisht Bordi etik dhe profesional i kësaj Ministrie, i cili në mënyrë të rregullt merret me këtë problematikë në 3 vitet e fundit, nuk e ka pasur asnjë parashtresë as nga qytetarët as nga ndonjë organ juridik, i cili do të kërkonte mendim profesional përkitazi me rastin konkret.

Ne duam të jemi në shërbim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë, por njëkohësisht edhe do të kërkojmë me vendosmëri që situatat e tilla të mos përsëriten më asnjëherë. Në këtë drejtim unë kam pasur edhe bisedë të ndarë me drejtorin e Policisë së Kosovës përkitazi me këtë rast dhe mund t'ju përcjelli edhe shqetësimin e tij dhe gatishmërinë e tij që situatat e tilla në të ardhmen të mos përsëriten asnjëherë.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

SHAIP MUJA: Po, zoti kryetar. Unë mendoj që zoti ministër në këtë rast është shkelur ligji i Odës së Mjekëve dhe kërkoj që meqë kryesuesja e Odës së Mjekëve nuk është në gjendje ta mbrojë ligjin, atëherë duhet të shkarkohet zonja Zulfije Hundozi e cila bën një reagim shumë formal e cila nuk merr asnjë përgjegjësi për ta mbrojtur ligjin. Ndërsa, burgosjet spektakulare me polici dhe me kamera për mua kanë një interesim për ata të cilët janë të interesuar ta rrënojnë shëndetësinë dhe të sjellin grupe të ndryshme të interesit për nevoja personale. Dhe, nëse ju nuk e ngreni çështjen te ministri i Drejtësisë për të parë edhe tejkalimin e kompetencave, qoftë nga prokurori, qoftë nga gjykatësi hetues, në këtë shtet nuk vlejné ligjet, por vlejné vetëm muskujt. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ti e din që kryesuesja e Odës duhet të punojë me ligj. Ligjin tjetërkush e mbron. Ministër e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet,

Oda e Mjekëve të Kosovës është institucion i themeluar në pajtim me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, është një institucion i cili është në fazën e tranzicionit të kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë në Odën e Mjekëve të Kosovës. Ende shumë kompetenca të Odës së Mjekëve të Kosovës, qëndrojnë në Ministrinë e Shëndetësisë. Oda e Mjekëve të Kosovës është kah i ndërton kapacitetet e saja dhe mendoj që në këtë rast nuk duhet zhvendosur vëmendjen në atë drejtim, por duhet kërkuar me të drejtë që ajo t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e saj ligjore.

Dhe, në këtë drejtim Ministria e Shëndetësisë do ta mbështesë Odën e Mjekëve të Kosovës, që sa më shpejt t'i marrë këto kompetenca dhe t'i ushtrojë në plotni. Ata e kanë bërë, Oda e ka bërë një reagim. Mendoj se ka qenë reagim përmbajtjesor, i qartë dhe i drejtuar qytetarëve të vendit, që në rastet kur ka shkelje, gabime profesionale t'i drejtohet Odës së Mjekëve të Kosovës, sepse i ka të gjitha organet në funksion për t'i adresuar çështjet në fjalë dhe nuk ka nevojë që menjëherë të adresohen problemet në nivelin e organeve të drejtësisë.

E përndryshe, po ju them vetëm një të dhënë, në vitin 2013 në Republikën Federale të Gjermanisë, kanë ndodhur 19 mijë vdekje për shkak të gabimeve të mjekëve, gabime që

kanë qenë të evitueshme. Prandaj unë apeloj edhe te të gjitha subjektet juridike që janë pjesë e procedurave të ndryshme ligjore në relacion me profesionistët shëndetësorë që të kenë kujdes në rastin e ekzekutimit të këtyre procedurave dhe të kuptojnë se ushtrimi i profesionit mjekësor është tejet kompleks dhe kërkon nivele të njohurive të cilat shumëkush në proceset juridike nuk i ka. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhafer Tahiri, pyetje për ministrin.

(Ndërhyrje)

Ti s'mundesh, se nuk është debat ky. Unë sugjeroja atë që kam të drejtë ta sugjeroj kush punon me ligj dhe kush e mbron ligjin. Është e përcaktuar me Kushtetutë. Lexo Kushtetutën.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Xhafer Tahiri nuk është këtu. Vazhdojmë.

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Minsitri s'është këtu. Deputete, doni ta bëni pyetjen? Fjalën e ka Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë pyetjen e kam parashtruar në seancën e kaluar, mirëpo që dy seanca ministri nuk është i pranishëm, po shpresoj se së paku me shkrim do ta marr përgjigjen nga ai. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Me datën 12 mars në Stacionin policor në Zubin-Potok, në mënyrë të dhunshme kanë hyrë persona me maska dhe kanë bërë lirim të Slobodan Sovërliqit, i cili fillimisht ishte arrestuar nga Policia e Kosovës për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë.

Më pas është vërtetuar se ndaj të njëjtit ekziston një urdhër arrest për përfshirjen e tij në aktivitete të veprave penale kundër personelit nën mbrojtjen ndërkombëtare dhe dëmtim të pronës së luajtshme.

Në lidhje me këtë është suspenduar zëvendëskomandanti i Policisë në Zubin-Potok Jugosllav Bugovac, mirëpo i njëjti pritet të kthehet në detyrë pasi që është hequr masa e suspendimit.

Pyetja për ministrin është: Pse i është ndërprerë masa e suspendimit kur ai ka qenë përgjegjës për sigurinë e të arrestuarit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Gashi,

Rreth rastit të 12 marsit kur një grup i personave me maska kanë hyrë dhunshëm në Stacionin policor në Zubin-Potok, janë ndërmarrë masa të nevojshme të hetimeve nga agjencitë për zbatim të ligjit në përfshirje edhe të EULEX-it.

Hetimet e ndërmarra janë orientuar në dy drejtime. Në një anë Policia e Kosovës në bashkëpunim me Policinë e EULEX-it, janë duke hetuar përfshirjen e personave me maskë që kanë hyrë dhunshëm në Stacionin Policor në Zubin-Potok. Hetimet janë duke u zhvilluar dhe presim rezultatet për zbardhjen e këtij rasti dhe t'i sjellin këta persona të përfshirë në këto vepra penale para drejtësisë.

Në anën tjetër, Inspektorati Policor dhe EULEX-i janë duke i hetuar zyrtarët e Policisë së Kosovës të cilët kanë qenë në shërbim në rastin e arrestimit të Slobodan Sovërliqit, më 12 mars si dhe ushtruesin e detyrës së zëvendëskomandantit të stacionit policor në Zubin-Potok në lidhje me këtë incident.

Masa e suspendimit është ndërprerë pasi që hetimet preliminare kanë treguar se kthimi i tij në punë nuk mund t'i pengojë hetimet të cilat zhvillojnë IPK-ja dhe EULEX-i dhe janë duke vazhduar.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

ALBANA GASHI: Po, zoti kryetar!

Ministër, mua më intereson të di se kush e ka dhënë urdhrin fillimisht për suspendimin e tij dhe kush e ka dhënë urdhrin po ashtu për ndërprerjen e masës së suspendimit, sepse, me sa kemi ne informacione, kryetarët e katër komunave veriore e kanë marrë këtë vendim. A mund të na jepni sqarime, ju lutem?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Është e vërtetë që ata kanë protestuar dhe protestojnë shpeshherë ose nuk e dinë ose s'duan ta dinë çka janë kompetencat e tyre që ata nuk mund të përzihen në këto punë, mirëpo hetimet i bën Inspektorati Policor i Kosovës, bashkë me EULEX-in në këtë rast, dhe natyrisht se gjatë hetimeve është konstatuar se kjo përgjegjësi nuk është e vetëm një individi dhe janë duke u zhvilluar hetimet edhe më tutje dhe rezultatet do t'i kemi.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Deputete, e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Refuzimi i rritjes së pagave nga deputetët, domethënë nga Parlamenti, Qeveria dhe Presidenca, ka qenë iniciativë e mirë të cilën e kemi përkrahur të gjithë. Tash 5.5 milionë nga këto paga janë dedikuar për trajtim të fëmijëve me leukemi dhe sëmundje të tjera.

Kur do të mund të përfitojnë apo të aplikojnë për trajtim këto kategori? Çdo ditë kemi shumë raste që kërkojnë ndihmë e disa janë në gjendje urgjente që nëse nuk intervenohet, do t'u kushtojë me jetë. Apo nëse kaloni këmbë nëpër sheshin Nëna Terezë, mund të shihni plot pika ku njerëzit kërkojnë ndihmë për raste të sëmundjeve të rënda, a është momenti që këto raste të trajtohen në institucione shëndetësore?

Meqenëse është i pranishëm ministri i Shëndetësisë, ndoshta do të mund të na përgjigjet.

KRYETARI: Ministri Agani e ka fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara, zonja deputete!

Ministria e Shëndetësisë është në procedurë për pranimin e aplikacioneve menjëherë nga ana e të gjithë fëmijëve të cilët lëngojnë nga leukemia dhe nga sëmundja e kancerit. Ne jemi në procedura brenda Qeverisë për alokimin e mjeteve të duhura në kodin buxhetor 716 për trajtimin jashtë institucioneve publike shëndetësore, kështu që në këtë drejtim i gjithë ai buxhet është në dispozicion menjëherë të fëmijëve në nevojë.

KRYETARI: Deputete, a po do pyetje shtesë apo po e vazhdon pyetjen tjetër?

Mirë, pra urdhëro pyetjen shtesë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Thashë që ka raste shumë me emergjente, sepse çdo pacient duke dashur çdo familjar ...duke dashur t'u ndihmojë familjarëve të tyre, veç në Qendrën Klinike kemi shumë raste të rënda, që nëse nuk intervenohet me urgjencë do t'u kushtojë me jetë.

A ka mundësi që këto raste të kenë përparësi dhe një tjetër si të informohen që ato pika qëndrimi në sheshin Nënë Terezë a të largohen prej rruge në mënyrë që t'u kumtohet se ndihmë për ato raste të sëmundjeve duhet të kërkojnë në institucione shëndetësore, tash në Ministrinë e Shëndetësisë dhe jo nëpër rrugë.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,

Mendoj se informimi më i mirë i këtyre fëmijëve, familjeve të tyre iu vjen nga mjekët, të cilët i trajtojnë dhe që janë të kyçur në proceset e trajtimit të tyre. Kjo informatë ka shkuar në Repartin Hemato-Onkologjisë Pediatrike, të gjitha familjet janë të informuara. Dje kemi pasur takim me mjekët e këtij reparti dhe të jeni të bindur se sa i përket familjeve informata është e plotë.

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Shumë familjarë të personave të zhdukur apo të viktimave civile janë të preokupuar, sepse në disa raste, për shkak të pamundësisë së ekzaminimit të kufomave të

karbonizuara, edhe pse këta persona janë të identifikuar, kanë varreza dhe ka dëshmitarë që janë vrarë, janë kategorizuar në kategorinë e personave të zhdukur.

Cila është mundësia ligjore që këta persona të kategorizohen në kategorinë e viktimave civile?

E kam thënë në një seancë më parë, kemi shumë raste, e një ndër rastet janë familja Muçolli, Çaraku, Elshani nga Pokleku i Vjetër i Drenasit, që gjithsej janë 53 kufoma.

Familjarët kërkojnë drejtësi, kërkojnë që familjarët e tyre të jenë me status të viktimave civile e jo të pagjeturve, sepse dëshirojnë ta shfrytëzojnë mundësinë që të ngrisin akuzë për ata që i kanë kryer këto krime.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Lumnije Morina, pyetje për ministrin Bernard Nikaj. Ministri s'është këtu.

LUMNIJE MORINA: Po, kryetar, po e shoh që nuk është ministri, por megjithatë pyetjen duhet ta bëj publike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i ka autorizuar dy laboratorë për testimin e derivateve të naftës deri më 28 janar 2014. Sipas udhëzimit administrativ 07/2012 për vazhdimin e autorizimit për laboratorët e autorizuar kërkohet që së paku 30 ditë para datës së skadimit të autorizimit të bëhet kërkesa për vazhdimin e autorizimit.

Konform udhëzimit administrativ 07/2012, laboratorët e kanë bërë kërkesën. Laboratori 'Sera Lab' sh.p.k. e ka bërë kërkesën më 27.12.2013. Kërkesat janë shqyrtuar dhe janë vlerësuar nga komisioni prej 5 anëtarësh, i cili e ka dhënë vlerësimin dhe rekomandimin pozitiv për nënshkrimin e autorizimit nga ministri zoti Bernard Nikaj, para datës 28 janar 2014, për të dy laboratorët e autorizuar të derivateve të naftës në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të autorizimit.

Laboratori 'Sera Lab' sh.p.k. nuk ka marrë përgjigje, ndërsa laboratori 'Kosova Lab' është autorizuar. Pyetja për ministrin ka qenë nëse laboratori 'Sera Lab' sh.p.k. i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret që kërkohen për autorizim dhe vazhdim të autorizimit, atëherë edhe çfarë kushti u dashka të plotësohet nga ky laborator për t'u autorizuar?

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Zoti ministër,

Duke u bazuar në Ligjin për personat me aftësi të kufizuara, edhe personat me pengesa në dëgjim e gëzojnë të drejtën e pensionit të aftësisë së kufizuar.

Por, zoti ministër, këta persona kohën e fundit ankohen se kanë probleme me pensionet e tyre. Domethënë disa nga ata nuk i marrin pensionet. A mund të na sqaroni pse po ndodh kjo?

KRYETARI: Ministër, Rashiq!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospode narodnih poslanici,

Poštovana poslanice,

Sa odredbama Zakona broj 2003/23, to je Zakon za penzije sa ograničenim sposobnostima, čime se reguliše i ova kategorija, reguliše se šema penzija o ograničenim sposobnosti za građane uzrasta sa 18. do 65. godina, koji su trajno potpuno sa ograničenim sposobnostima i nesposobnosti za bilo koji posao bez obzira na status radnog odnosa.

Ministarstvo kao organ sprovođenja tog istog zakona 2003/23 za penzija lica sa ograničenim sposobnostima na Kosovu, nakon stupanja na snagu, je izdao sve potrebne podzakonske akte, koje su bile utvrđene ovim zakonom i sprovedene zakonske odredbe koje su i danas na snazi.

Jedan od kriterijumima za utvrđivanje ograničenu sposobnost tretira se članom 3. ovog istog zakona, koji kaže da se zakon se ne bavi i ne određuje sve zaposlenosti lica koja su zaposlena, kao što su profesionalni bolesti, ili povrede na radnom mestu.

Prema Zakonu 2003/23, procenu nesposobnih vrši lekarska komisija, i u zavisi od dijagnoze bolesti, određuje se pregled ili polna procena od strane lekarske komisije posle perioda 1. 3. do 5 godina, ili do samo do 65. godina starosti, kada će preći na starosnu penziju, gde mogu da postoje slučajevi koja posle 1., 3. ili 5. godina, može biti sposoban za rad, a lekarska komisija u okviru Ministarstva je osnovana sa svim učesnicima odgovarajućih oblasti, koji su profesionalni i nezavisni u svom radu. Da sažetak iz ovoga napravim, ljudi koji su bilo koji način unutar benifita za osobe sa ograničenim sposobnostima se proveravaju i individualno.

Ne postoji grupa, u ovom slučaju gluvih, koja bi tretirala bila posebno. To je komisija koja svakog od aplikanata tretira jedno po jedno. Prema tome, nikakvih posebnih izdvajanja određene interesnih grupe nije bilo. Mi smo više puta i rekli - Komisija za ljudska prava, pošto smo kroz dopise bile takve neke primedbe, kao čuli smo da ima neki zavrznosti gluvih, da ima manje njih sada u šemi, ili u listi. Mi smo dva puta tražili pojašnjene, pre svega da nam kažu informacije, dakle o svim, i naravno da nam daju i imena ljudi. I šta je najbitnije na kraju, ukoliko bilo ko, na bilo koji način smatra da su njihova prava osporena...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Edhe gjysmë minute!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Faleminderit, zoti kryetar!

...tako da svaka lica individualaca, koji smatraju da su njihova prava oštećena ili osporena u ovom slučaju, imaju pravo da se žale na drugostepenoj komisiji gde je naravno, kao što sam rekao, ukoliko ima bilo koji individualac, koji ispunjava uslove, a po pregledom komisije nije utvrđeno, apsolutno smo spremni da još jednom pregledamo i da ta ista doktorska komisija utvrdi pravo činjenično stanje. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit ministër për sqarimet!

Por, siç janë ankuar te komisioni, disa nga këta persona kanë kontaktuar edhe me mua dhe, siç duket, është një numër i madh i tyre që përnjëherë u janë ndërprerë këto pensione. Andaj, ju falënderoj për sqarimet, por ju kisha lutur që të bashkëpunoni me komisionin dhe të shihni ju personalisht se mos ka ndonjë problem më të madh këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Bilo ko, bilo koja grupacije, bilo koji individualac, koji na bilo koji način smatra da ima pravo da dobije te dve beneficije, sad javno i pozivam da apliciraju na drugostepenu komisiju, jer drugostepena komisija samo može da utvrdi ono što je prvostepena odlučila, ili da koriguje ukoliko prvostepena donela pogrešnu odluku. Prema tome, pozivam sve, bilo grupu, ili bilo svakog individualaca da još jednom se obrate nama, i naravno ime i prezime, zbog toga je najbitnije za dopunska komisija radi svoj posao. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Vjollca Krasniqi, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ministër, Krasniqi,

Ju gjatë mandatit tuaj, përkatësisht në vitin 2012, keni premtuar se gjatë mandatit të udhëheqjes suaj do të ndërtohen gjashtë fusha ndihmëse të futbollit me bashkëfinancim me Komisionin Evropian.

Pyetja ime për ju është: A është realizuar ndërtimi i ndonjëres prej tyre dhe nëse po, ku i keni ndërtuar ato?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Krasniqi,

Ju falënderoj për interesimin tuaj për angazhimet e Qeverisë dhe të partnerëve tanë në përmirësimin e infrastrukturës sportive, veçanërisht të asaj të futbollit.

Më vjen keq që para disa vitesh as që kishim rast të flisnim për zhvillime kaq të mëdha në sportin e Kosovës.

Më lejoni të filloj me atë që e përbën lajmin më të rëndësishëm, e që është gëzuar gjithë komuniteti sportiv, para së gjithash Federata e Futbollit e Kosovës, ku edhe ju personalisht jenë pjesë e organit ekzekutiv. Është pra vendimi për ndërtimin e stadiumit kombëtar të futbollit këtu në Prishtinë.

Është një projekt gjigant, që do të rezultojë me stadiumin më modern në Ballkan. Ky është një projekt multimilionësh dhe stadiumi parashihet ta ketë një kapacitet prej 25 mijë deri në 30 mijë ulëse dhe me gjithë infrastrukturën përcjellëse sipas standardeve më të larta të FIFA-s se UEFA-s.

Për këtë projekt kemi pasur konsulta të vazhdueshme me FFK-në dhe ata do të jenë partner kryesor në gjithë procesin e ndërtimit të stadiumit. MKRS-ja ka filluar konsultimet me Komunën e Prishtinës dhe shpresojmë se shumë shpejt do të kemi edhe vendim për lokacionin e ndërtimit të stadiumit të ri.

Natyrisht ka edhe shumë projekte tjera që kanë përfunduar dhe të tjera që do të nisin, por meqë keni pyetur për gjashtë stadione ndihmëse të futbollit, më lejoni të ju informoj se këto projekte shumë të rëndësishme financohen, implementohen dhe mbikëqyren nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Ndërsa si iniciues të projektit jemi ne partner në këtë proces, bashkë edhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe me Federatën e Futbollit të Kosovës, që ka qenë pjesë e procesit nga hapat e parë.

Konform pyetjes suaj, dje kemi kërkuar informacionet më të fundit nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë rreth ecurisë së punimeve në ndërtimin e gjashtë stadioneve ndihmëse dhe e kam kënaqësinë të ju informoj, si vijon:

Stadiumet janë duke u ndërtuar sipas kriterëve të FIFA-s dhe do të shtrohen me bar artificial. Ato do t'i kenë zhveshtoret e nevojshme, infrastrukturën përcjellëse, si dhe hapësirat për parkingje. Në Ferizaj, stadiumi është në ndërtim e sipër dhe pritet të përfundojë në fund të muajit gusht të këtij viti. Aty po investohen 726 000 euro.

Kaq janë investuar edhe për stadiumet e tjera që po ndërtohen në Gjiçan, në Mitrovicë, në Pejë dhe në Drenas. Edhe këtu planifikohet që punimet të përfundojnë në fund të muajit gusht të këtij viti.

Ndërkaq në Gjakovë stadiumi pritet të jetë i gatshëm në fundin e muajit qershor të këtij viti dhe aty janë investuar rreth 350 000 euro.

Pra, në total, është një investim prej rreth 4 milionë eurosh dhe sipas Zyrës së BE-së në Kosovë si implementuese e projektit, punimet në gjashtë stadione pritet të përfundojnë para fundit të stinës së verës.

Po ashtu, ju informoj se edhe dy stadiume të ngjashme do të nisin së ndërtuari këtë vit, në Prishtinë dhe në Prizren, por kësaj here me buxhetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ne po presim edhe përgjigjet finale në këto dy komuna për ndarjen e lokacioneve të nevojshme.

Edhe në këtë rast, Federata e Futbollit e Kosovës do të jetë partner kryesor në ecurinë e punimeve. Andaj, jam i sigurt se edhe prej aty ju do të mund të merrni informata të dorës së parë. Faleminderit!

KRETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

VJOLLCA KRASNIQI: Po, gjithsesi!

Unë, ministër, nuk ju bëra pyetje çfarë keni premtuar gjatë kësaj fushate që e keni nisur që sa kohë. Nuk ju pyeta çka do të ndërtoni dhe çfarë stadiumi, sepse e kemi dëgjuar kryeministrin.

Unë jua bëra pyetjen shumë të qartë dhe konkrete: Sa terrene të tilla, që ju i keni premtuar, sepse kur premtoni doni t'i merrni meritat ju, ndërsa kur nuk finalizohen projektet, e lini fajin te Komisioni Evropian apo BE-ja që nuk i ka implementuar projektet. Pyetja ime ishte e qartë: Sa projekte të tilla janë finalizuar dhe janë të gatshme për shfrytëzim?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Në fakt ju e ndërruat pyetjen, se pyetja që e shtruat para pak minutash ishte a kanë filluar të ndërtohen dhe ku po ndërtohen. Dhe unë jua dhashë përgjigjen në gjuhën shqipe, nëse e keni më mirë jua jap në gjuhën angleze prej Zyrës së BE-së drejtpërdrejt.

Si do qoftë, unë ju falënderoj ju personalisht, si anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, për gjithë mbështetjen që na e keni dhënë në krejt proceset e përbashkëta në ndërtimin e infrastrukturës së re, renovimin e infrastrukturës ekzistuese, në ndërkombëtarizimin e sportit, veçanërisht të futbollit të Kosovës. Dhe, unë besoj që edhe në të ardhmen do të jemi partner, siç kemi qenë në gjithë këta hapa dhe pa dyshim që sporti, siç ju kam thënë edhe një herë tjetër, duhet të jetë jashtë fushatave politike, e veçanërisht atyre partiake. Kështu që ju ftoj, siç kemi bashkëpunuar deri më tash, në cilësinë tuaj si anëtare e FFK-së, ta vazhdojmë bashkëpunimin për të mirën e futbollistëve të Kosovës dhe për të mirën e sportit kosovar, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, tash nuk bën! Kur ta kryejmë këtë pikë, mund të bësh pyetje në emër të grupit. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Agani,

Më 16.3.2013 është inauguruar Reparti i Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Për renovimin dhe pajisjen e repartit ka ndihmuar edhe Qeveria italiane. Me hapjen e këtij reparti është menduar se pacientët kosovarë më nuk do të kenë nevojë të shkojnë jashtë Kosovës për t'i marrë shërbimet kardiokirurgjike, në spitalet apo klinikat private këtu, sepse është menduar që pjesa më e madhe e shërbimeve dhe e sëmundjeve kardiokirurgjike do të mund të trajtohen në Kosovë, në Qendrën Klinike Universitare, në Klinikën e Kardiokirurgjisë, e cila i ka dy salla të operacionit, tetë shtretër të terapisë intensive dhe 18 shtretër për akomodimin e pacientëve.

I nderuar ministër, këtë çështje e kam ngritur para tri javësh, mirëpo mungesa juaj këtu ka bërë që të mos ketë përgjigje dhe ditëve të fundit kemi pasur edhe shqetësimet e disa mjekëve në disa media vendore këtu.

Pyetja ime është: Sa është vlera e investimeve në Klinikën e Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare? Sa është numri i pacientëve të operuar prej datës së inaugurimit deri më sot?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputeti Haxhiu,

Është e saktë se kardiokirurgjia publike e filloi punën në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për herë të parë në periudhën e pasluftës në mënyrë të organizuar më 16 mars 2013. Prej atij momenti janë zhvilluar aktivitete sistematike në ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës teknologjike, kapaciteteve njerëzore të nevojshme për ta filluar këtë shërbim që paraqet majën e shëndetësisë në çdo shtet.

Projekti i themelimit të kardiokirurgjisë publike ka qenë projekt tepër ambicioz në rrethanat e mundësive financiare të shtetit. Kemi qenë të vetëdijshëm për këto kufizime, por siç e thatë edhe vetë kemi arritur që ta aktivizojmë projektin e donacionit të Qeverisë italiane, i cili ka qenë i lejuar qysh në vitin 2007 dhe ka qenë i stopuar për vite të tëra. E kemi aktivizuar, e kemi vënë në funksion dhe me këtë kemi filluar ngritjen e kapaciteteve të këtij shërbimi, duke punësuar për herë të parë 18 punëtorë, një kardiokirurg dhe më pastaj edhe dy kardiokirurgë të tjerë, të cilët, ditët e fundit, siç e përmendët edhe vetë, për shkak të vështirësive në funksionim brenda repartit, arsyeve të tyre personale, që unë nuk i kam të njohura personalisht se nuk jam i njoftuar zyrtarisht, e kanë lëshuar shërbimin. Por, ku punon kardiokirurgu dhe ku ofrohen shërbime kardiokirurgjie në muajin e fundit vetëm katër intervenime janë kryer dhe atë në bashkëpunim me drejtorët e klinikave më eminente kardiokirurgjie të rajonit të Qendrës Klinike Universitare të Lubjanës dhe të spitalit 'San Donato' në Milano.

Përgjigjja konkrete në pyetjen tuaj: Gjithsej janë investuar 130 mijë euro dhe atë 30 mijë nga Ministria e Shëndetësisë për material harxhues për 30 operacione dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës 100 mijë euro. Nga projekti italian i cili është në vlerë 1,7 milion euro janë shpenzuar 350 mijë euro. Janë kryer 31 intervenime kardiokirurgjike, në vlerë të përafërt prej rreth 250 mijë euro. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit ministër për një pjesë të informatës!

I nderuar ministër,

Pagesa të cilën Ministria e Shëndetësisë e ka bërë për pacientë të cilën janë referuar për trajtim jashtë vendit, pas inaugurimit të Klinikës së Kardiokirurgjisë, është shkelje ligjore. Do të ishte e njëjtë, ashtu sikur kur është inauguruar klinika apo Reparti i Laparaskopisë në Qendrën Klinike Universitare dhe pastaj të referoheshin pacientët për diku tjetër. Uroj që në këtë klinikë të kryhen operacione, jo nga katër në muaj, mirëpo të kryhen të gjitha ato çka janë. Mirëpo, nuk lejohet që pas këtij investimi kapital, pacientët të referohen në klinika private dhe pagesat dhe mbulesat për këtë t'i bëjë Ministria e Shëndetësisë.

Njëkohësisht është bërë një investim milionësh në Qendrën Klinike Universitare dhe me gjithë këtë investim milionësh, pacientët janë referuar për shërim...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar, zoti deputet!

Kjo është një perspektivë shumë e ngushtë e shikimit të problemit. Besoj se duhet t'i ktheheni edhe një herë pak esencës së shërbimit kardiokirurgjik. Nuk është shërbimi kardiokirurgjik sikur shërbimet tjera shëndetësore. Për këtë nevojitet ngritje e vazhdueshme e kapaciteteve teknologjike, njerëzore. Ka qenë guxim i madh edhe i Ministrisë, por edhe ekspertëve profesionalë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës që t'i hyjnë këtij projekti. Është tentuar me vite të tëra, nuk është arritur.

Në qoftë se fillohet me shërbim, i cili do t'i ndërtojë kapacitetet e tij në mënyrë graduale, në këtë moment i kemi katër specialistë të kardiokirurgjisë, jemi në procesin e pajisjes së shërbimit kardiokirurgjik me sallën hibrid të intervenimeve kirurgjike ndër më bashkëkohoret në Evropë. Është duke u ndërtuar rrjeti i bashkëpunimit me spitalin 'San Donato' dhe spitalet e tjera në Evropë dhe në Republikën e Turqisë. Dhe, paralelisht me ngritjen e kapaciteteve ne do të kemi njerëz të sëmurë që gjithmonë do të kenë nevojë për trajtime jashtë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Është absurde të mendohet se Qendra Klinike Universitare e Kosovës i ka të gjitha mundësitë për t'i trajtuar të gjitha rastet.

Natyrisht ne jemi në shërbim të qytetarëve të vendit dhe fondi për trajtimin jashtë institucioneve publike shëndetësore i shërben mu këtij qëllimi. Prandaj, referimi jashtë

Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nuk bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, por bëhet nga konsiliumet e mjekëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Pyetja e dytë ka të bëjë me trajtimet jashtë vendit.

I nderuar ministër,

Edhe ju e dini që për shërbimet të cilat ofrohen në Kosovë, në institucionet publike nuk lejohet me ligj që të referohen për trajtim jashtë vendit. Për të gjitha ato shërbime, të cilat pacientët mund t'i marrin në Qendrën Klinike Universitare nuk lejohet trajtimi, domethënë mbulesa e shpenzimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe kjo ka të bëjë edhe me pyetjen paraprake. Domethënë nuk lejohet që për ato shërbime kardiokirurgjike, të cilat ofrohen në Qendrën Klinike Universitare, të paguajë Ministria e Shëndetësisë.

Më 1.7.2013, Ministria e Shëndetësisë e ka nxjerrë udhëzimin administrativ për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike. Ky udhëzim kishte për qëllim zbatimin e programit për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Ministria e Shëndetësisë, sipas mundësive, ose nëse do trajtimin mjekësor të qytetarëve të Kosovës për sëmundjet dhe çrregullimet shëndetësore, të cilat nuk mund të trajtohen në institucionet shëndetësore publike, sipas këtij udhëzimi, me nenin 5, për rastet emergjente, kur në bazë të raportit të Komisionit konsiliar dhe fletëreferimit nga institucioni publik shëndetësor, vlerësohet se është rrezikuar jeta e qytetarit, Ministria e Shëndetësisë ose në mungesë, ministri i Shëndetësisë, ose zëvendësministri mundëson fillimin e trajtimit jashtë institucionit publik shëndetësor para përfundimit të procedurës administrative të paraparë me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.

I nderuar ministër,

Pyetja është: Sa është numri i rasteve emergjente të trajtuara prej nënshkrimit të këtij udhëzimi administrativ? Përse raste emergjente nuk trajtohen sipas këtij udhëzimi, por mbeten nganjëherë edhe në zyrën tuaj me muaj të tërë, edhe pse janë raste emergjente. Ndodh shpesh që palët enden nga njëra zyrë në zyrën tjetër, por ma marrë përgjigje.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar, zoti deputet!

Unë ju thashë edhe më parë, edhe një herë po jua përsëris, asnjë rast nuk referohet nga Ministria e Shëndetësisë në institucionet jashtë sektorit publik pa mendim konsullar të mjekëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Asnjëherë s'ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë, sepse ky është institucioni i nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor. Prandaj, kjo është çështje e qartë.

Sa i përket përgjigjes në pyetjen konkrete: Rastet emergjente asnjëherë nuk janë trajtuar me programin për trajtimin jashtë institucioneve publike shëndetësore deri në vitin 2012.

Unë kam qenë iniciator i asaj që këto fonde të jenë në dispozicion edhe të qytetarëve që janë në gjendje emergjente dhe në rrezik jete. Dhe, me udhëzimin administrativ 02/2012 e kam mundësuar një situatë, në një rast të tillë, e kam mundësuar këtë zgjidhje, e cila ka qenë në shërbim të drejtpërdrejtë të 166 qytetarëve, sipas atij udhëzimi administrativ.

Në vitin 2013, konkretisht më 1 korrik, e kam ndryshuar dhe plotësuar këtë udhëzim administrativ me udhëzimin e ri 10/2013, në bazë të të cilit janë trajtuar 164 raste. Dhe, ky ka qenë njëri prej programeve më efikase efektive drejtpërdrejt në shërbim të qytetarëve të vendit me rastet emergjente, atëherë kur Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka qenë në gjendje që t'i ofrojë këto shërbime.

Asnjëherë nuk ka ndodhur që rastet emergjente të trajtohen në kundërshtim me udhëzimin administrativ 10/2013.

Në vazhdimësi jemi duke e azhuruar procesin, duke i shpejtuar procedurat dhe mund të ju informojë që para dy ditësh, me procedimin e 42 lëndëve të fundit për pagesë ne nuk e kemi asnjë lëndë e cila pret për ekzekutim në Ministrinë e Shëndetësisë sa u përket lëndëve që kanë të bëjnë me raste emergjente. Asnjë!

Do të thotë, ky program është në shërbim të plotë të qytetarëve të vendit, natyrisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për shëndetësi, konkretisht nenit 61, i cili e përcakton se cila kategori e qytetarëve janë të liruar nga bashkëpagesat gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore, i kemi disa ndryshime, të cilat janë inkorporuar në udhëzimin administrativ.

E të mos e harrojmë edhe faktin se në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka filluar të punojë Shërbimi i Kardiologjisë Invazive dhe shumë raste që përpara janë drejtuar jashtë QKUK-së, tani i drejtojmë vetëm pas mendimit konsiliar dhe atë jo vetëm pas mendimit konsiliar, por edhe arsyeshmërisë së verifikuar nga Drejtoria e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për këto indikacione urgjente, që është prapë obligim...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Edhe ju, edhe unë e dimë që ka me dhjetëra raste, të cilat janë në pritje të nënshkrimit tuaj.

Në bazë të këtij udhëzimi që ju e keni nxjerrë, uroj ministër që t'i respektoni mendimet konsiliare të Komisionit konsiliar të mjekëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe kur ekspertët shëndetësorë konstatojnë që është një rast emergjent dhe duhet një trajtim më emergjent, që ato pastaj të mos shkojnë në komisione tjera për trajtim jashtë vendit, për arsye se ato mbeten me muaj të tërë duke u trajtuar dhe rastet emergjente nuk presin. Uroj që vërtet asnjë rast emergjent të mos jetë duke pritur në zyrën tuaj për

nënshkrim dhe ju kur të ktheheni prej këtu në zyrën tuaj e dini që nuk është ashtu siç thatë.

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI FERID AGANI: Zoti deputet!

Ju keni pak problem në vlerësimin e asaj që po e them. Nuk e di, ose nuk po më dëgjoni, ose nuk po më kuptoni, ose e keni ndonjë ngarkesë në ndërdije që po ju problematizon në atë aspekt.

Por, dua të ju them edhe një herë: asnjë lëndë emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë nuk është duke pritur për nënshkrim nga unë, në mënyrë të sigurt. Por, të jeni të bindur edhe për atë se ne nuk jemi zbatues të verbër të mendimeve të konsiliumeve të mjekëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në ndërkohë, kemi zhvilluar kapacitete për trajtimin e rasteve kardiokirurgjike, të kardiologjisë invazive, të ortopedisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Sot kemi raste kur thuhet të udhëzohet urgjent pas orës 15:00. Deri në orën 15:00 punon shërbimi në QKUK, pas orës 15:00 nuk punon. Kjo është e palejueshme. Unë kam kërkuar që Drejtoria e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës t'i analizojë indikacionet për trajtime emergjente jashtë QKUK-së dhe këtu është përgjegjësia jonë për shpenzimin e parasë publike, gjithmonë e baraspeshuar me interesin e qytetarëve për trajtim emergjent.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Glauk Konjufca, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

GLAUK KONJUFCA: Unë desha ta pyes kryeministrin lidhur me një mori takimesh që i ka realizuar me kryeministrin e Serbisë, Ivica Daçiq, dhe gjatë gjithë atyre takimeve desha të di se sa herë saktësisht dhe konkretisht është ngritur çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Nëse është ngritur si çështje, cilat janë rezultatet konkrete deri tash dhe çka kanë përfituar konkretisht shqiptarët e asaj ane prej negociatave që janë bërë ndërmjet dy kryeministrave?

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Faton Topali, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

FATON TOPALLI: A e presim kryeministrin derisa të vijë, meqë është këtu, sigurisht ka shkuar në banjë?

KRYETARI: Jo, ne nuk mund të presim, se koha ecën.

FATON TOPALLI: Mirë, a ta shtroj pyetjen për zotin Agani?

KRYETARI: Po mirë, bëje pyetjen për zotin Agani.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar zoti Agani,

Një numër i fëmijëve në Kosovë, për shkak të ngecjes në rritje, ka nevojë për ta përdorur hormonin e rritjes. Ky hormon, i cili nuk gjendet në shitje të lirë, është siguruar në spitalin e pediatriisë dhe bën pjesë në listën e barnave që paguhet nga shteti. Trajtimi mujor për një fëmijë apo të rinj kushton së paku 600 euro në muaj, ndoshta edhe më shumë, dhe zgjat së paku 5 deri në 6 vjet.

Pra, është fjala për një bar shumë të shtrenjtë, të cilin prindërit nuk e përballojnë dot. Prej nëntorit të vitit 2013 është ndërprerë furnizimi, pastaj është sjellë një sasi e vogël, ndërsa prej dhjetorit të vitit 2013 nuk ka pasur furnizim. Pyetja për ju është: A është duke e vënë në dispozicion Ministria e Shëndetësisë hormonin e rritjes dhe nëse po, ku?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit për pyetjen, zotëri deputet!

Po, Ministria e Shëndetësisë e ka dhënë në shfrytëzim të plotë të fëmijëve që kanë nevojë për hormonin e rritjes. E ka vënë në shfrytëzim të plotë hormonin e ‘somotropinit’. Këto preparat prej para dy ditësh e kanë në dispozicion të plotë në Klinikën e Pediatriisë. Vonesat në furnizim kanë qenë çështje e ristrukturimit të skemës, furnizimit të institucioneve shëndetësore me produkte medicinale.

Ju e dini se prej këtij viti, përgjegjësia për furnizim me barna dhe material shpenzues ka rënë mbi institucionet shëndetësore. Atyre u është flokuar buxheti i plotë dhe në procedurat ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe institucioneve shëndetësore ka pasur vonesa në urdhër-blerje që kanë reflektuar edhe në këtë vonesë, të cilën e përmendët, por të jemi të bindur se tash e tutje këto çështje do të jenë shumë më të qarta, më transparente, sepse ndërmjet Klinikës së Pediatriisë, në rastin konkret, dhe operatorit ekonomik furnizues, me të cilin Ministria e Shëndetësisë ka kontratë, nuk do të ketë më ndërmjetësues.

Pra, bëhet fjalë për një komunikim të drejtpërdrejtë, i cili do të sigurojë furnizim të plotë dhe të rregullt të këtyre fëmijëve me këtë preparat.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Ajo që është pak e habitshme është që këto barna janë siguruar dy orë pas shtruarjes së pyetjes parlamentare, nuk e di a ka të bëjë kjo me fushatën apo jo, por pyetja konkrete është që zoti Ferid Murati ka ofruar 1 milion copë të barit të këtillë, i cili është refuzuar për shkak që është thënë se ai e ka një afat vetëm një vit, domethënë i skadon afati. Ky i fundit i ka dorëzuar pastaj këto barna në Maqedoni. A keni ndonjë arsyetim për këtë çështje?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Natyrisht se kam shpjegim, arsyetim nuk ka nevojë, por kam shpjegim të situatës. Fillimisht të jeni të bindur se furnizimi është realizuar qysh para dy ditësh në bazë të komunikimit të rregullt që unë kam me prindërit e këtyre fëmijëve, të komunikimit edhe me e-mail, edhe drejtpërdrejt, dhe ata e kanë ngritur këtë shqetësim te unë, sepse e dinë që mund të mbërrijnë te unë shpejt dhe të kenë përgjigje sa më adekuate dhe duke iu falënderuar këtyre veprimeve, kemi arritur ta tejkalojmë këtë çështje dhe për këtë i kemi edhe korrespondencat, po të jeni të interesuar, mund t'i shihni.

Pra, asnjëherë nuk bëhet fjalë për fushatë kur është në pyetje jeta e qytetarëve, veçanërisht e fëmijëve. Në rastin konkret, Ministria e Shëndetësisë do ta pranojë një donacion nga kompania "Fajzer". Unë e dëgjova për herë të parë nga ju se ky ka qenë donacion i nobelistit tonë, në qoftë se është fjala për Ferid Muratin, por kompania "Fajzer" ka ofruar donacion në vlerë prej rreth 350 000 euro të hormonit 'somatropinës', me afat të kadencës deri në fund të këtij viti të një pjese të vogël të atij donacioni, por pjesa më e madhe ka skadencë edhe në vitin tjetër dhe unë kam insistuar personalisht që ky donacion të realizohet në plotësi dhe procedurat për realizimin e tij janë në vijim e sipër. Nuk kam informatë se ka ardhur deri te ndonjë ndërprerje në atë proces. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime për ministrin është pak a shumë e njëjtë me deputeten Mustafa. Ka të bëjë me përjashtimin nga skema pensionale e personave të shurdhër. Mirëpo, në përgjigjen që i dha deputetes, ministri tha që është larguar një numër. Sikur ai numër të ishte i vogël, unë po i them ministrit që numri i personave të larguar nga skema pensionale është 500 - 700 dhe deri me tani numri i përfituesve ka qenë diku rreth 1 500.

Pra, një numër prej 500 personave, edhe 200 së shpejti do të largohen nga skema pensionale me arsyetimin që ata nuk janë persona me aftësi të kufizuara në njëfarë mënyre. Pyetja për ministrin është: Çka do të ndërmerrni ju si ministri, duke pasur parasysh se me të drejtat ndërkombëtare, e kam fjalën me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, po ashtu edhe me Ligjin për personat me aftësi të kufizuara, këta persona kanë të drejtë për qasje në skemat pensionale.

KRYETARI: Ministër Rashiq, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Nisam rekao da je jedna grupacija isključena, nego sam rekao da je doktorska komisija apsolutno nezavisna. Svaki od individualaca koje aplicira, aplicira kao individualac, nema određena grupa gluvih koje aplicira na kolektivan način.

Mi nemamo zakon specifično o gluvima, imamo Zakon o osobama sa ograničenim sposobnostima, i rekao sam da svako koji je identifikovan, u ovom slučaju vi ste rekli da

je 500 njih identifikovano, od toga 300 skinuto sa liste, ja vas molim, pošto već imate listu, da nam listu prosledite, i jedno što mogu da vam garantujem - da ćemo odmah, po hitnom postupku, zakazati dodatnu dopunsku komisiju, odnosno drugostepenu koja može da potvrdi dali su oni, kao što ste vi rekli sklonili sa liste, šta je mogu da kažem da apsolutno nije tako, nego dali je doktorska komisija utvrdila njihovo stanje, da li ispunjavaju uslove, ili ne.

I kao što sam malo pre rekao, imate tri vrsta rešenja za sve osobe sa ograničenim sposobnostima, to su na godinu, tri i pet godina. Svaki odbijenih ima pravo da se žali u drugostepenom komisiju, i ta drugostepena nezavisna doktorska komisija utvrđuje njihovo stanje.

Ministarstvo za rad, osim infrastrukture organizovanje nezavisne komisije i njihovog plaćanja, nema nikakve indikacije, nema nikakve namere da jednu određenu grupu sklanja sa liste beneficije. Hvala!

KRYETARI: Deputete, keni pyetje shtesë?

ALBANA GASHI: Ministër, nuk thashë që e keni përjashtuar një grup të caktuar, por thashë një numër të madh të personave me aftësi të kufizuara. Këta persona, këta 500 që tashmë janë larguar nga lista, edhe 200 tash priten shpejt të largohen, janë persona të cilët që nga viti 2004 deri në viti 2014, pra në këtë vit kanë përfituar prej skemës pensionale.

Pra, përderisa këta persona për 10 vjet me radhë kanë përfituar nga skema pensionale për shkak të aftësisë së kufizuar, tani kjo skemë u është ndërprerë, pra ky pension u është ndërprerë. Nëse këtyre personave u është kthyer dëgjimi, ju lutem na tregoni, sepse ky është një lajm i mirë, është për të festuar. Mirëpo, nuk është problemi vetëm te ministria e juaj, te Ligji për personat e verbër. Ju e dini që një vit borxh ju keni pagat të personave të verbër. Po ashtu, çdo ditë po i largoni njerëzit nga skemat pensinale.

A mund të na tregoni cili është problemi, pse nuk po funksionon kjo ministri?

KRYETARI: Vazhdo, ministër!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: To su ipak tri pitanja, ja ću kod ovog prvog. Doktorska komisija je nezavisna koja ispituje svaki slučaj pojedinačno. Rekao sam da ima tri vrste rešenja, na godinu, na tri, na pet godine. Kada istekne, na primer rešenje na godinu dana, osoba je dužna da opet prijavi, da opet ode na Doktorsku komisiju, i ukoliko je njeno stanje, stanje osobe promenjeno, onda se naravno i rešenje menja, da više određena osoba nema pravo zbog toga što je zdrava.

Još jednom ponavljam, Doktorska komisija je apsolutno nezavisna, i oni utvrđuju stanje pacijenata. Ne utvrđuje Ministarstvo, ili bilo koji drugi organ. Što se tiče Zakona o slepima, više puta sam rekao da ćemo mi zbog sve ove slučajeve koje dođu u ovoj godini, da ih na vreme isplatimo ili kompenziramo, onih koji budu bili prijavljenih već do kraja prošle godine, njih ćemo retroaktivno isplatiti u ovoj godini, i rekao sam da zbog tih

organizovanja i skidanja sa liste iz jedne kategorije u drugu, trebalo je malo više tehničkog vremena, ali će i to biti obavljeno kao što sam i ranije pričao.

Za socijalu, podsećam da smo mi decentralizovani i spiskove, ljude, individualci, i porodice, na socijalnim šemama i socijalnoj pomoći, utvrđuje Opština. Mi samo plaćamo i monitorišemo. Prema tome, ukoliko je neko skinut sa socijalne, on može samo da ne ispunjava uslove. Ništa drugo, sa strane Ministarstva ne možemo da utvrđujemo, a dokumentaciju i utvrđivanje da li ispunjavaju uslove ili ne, radi Opština, mi samo radimo monitoring. Hvala!

KRYETARI: Këtu dhe përfundon edhe koha për pyetje parlamentare. Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare, botohen në Buletinin e Kuvendit.

Të pranishëm janë 91 deputetë, 111 prania elektronike. Fjalën e ka kërkuar deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje kolegë dhe kolege,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe në konsultim dhe marrëveshje me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kërkoj shmangie nga procedurat e rendit të ditës. Pra, kërkoj që në rendin e ditës sot në seancë të futet Ligji për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me procedurë të rregullt, e ka kryer punën e vet, e ka kryer dëgjimin publik me të interesuarit, pra ka nxjerrë dhe i ka shqyrtuar amendamentet e arritura në komision dhe pastaj me procedurë të përsheptuar i ka dërguar këto në komisionet e përhershme dhe jam e sigurt që këto komisione e kanë kryer deri tani punën e vet.

Kërkoj që ky ligj të vihet sot në rendin e ditës dhe Parlamenti të deklarohet se pajtohet me këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

Unë jam i obliguar t'ju njoftoj që të gjitha veprimet që janë bërë me këtë ligj deri më tani, janë bërë duke e suspenduar Rregulloren e Kuvendit. Materiale nuk kemi. Kërkesa do të duhej të bëhej me shkrim. Veç po ju njoftoj që të gjitha procedurat me këtë ligj janë anashkaluar dhe nuk e di vërtet a do të duhej për një javë kohë të bëhen gjithë këto anashkalime. Edhe komisioni nuk e di nëse ka votuar me shmangie, por rregulla 64 e mbledhjes së komisioneve, pika 4, nuk po e lexoj krejt, por atë që duhet, me rendin e ditës, anëtarët e komisionit të njoftohen jo më vonë se 4 ditë pune para se të mbahet mbledhja.

Rendi i ditës mund të ndryshojë vetëm me vendim të komisionit. E keni rregullën 56. Edhe për këtë sot, ne asnjë material nuk e kemi. Bile edhe kërkesa do të duhej të ishte me shkrim. Nuk është. Edhe Ligji për zgjedhje, që e kemi në pikën e katërt rendit të ditës,

nuk i plotëson kushtet me Rregullore që sot të hyjë në Kuvend. Edhe këtu duhet ta bëjmë shmangien. Prandaj, duhet ta dimë që i kemi dy pika të rendit të ditës për të cilat ne duhet të bëjmë shmangie, e shmangia bëhet me 2/3 e deputetëve të pranishëm. E thashë këtë për t'ju njoftuar edhe ju dhe të gjithë ata që na dëgjojnë se ky ligj, në të gjitha procedurat, ka shkuar në mënyrën e përshpejtuar pa u bazuar në rregullat për të cilat jemi marrë vesh si Kuvend.

Atëherë shkojmë me deklaratimet. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ishte për ta futur në rend dite Ligjin për veteranët e luftës. Urdhëroni për anashkalim, secili grup le ta prezantojë qëndrimin e vet. Unë e thashë atë që me Rregullore çka është imja, por kërkoj nga ju nëse doni të prononcoheni si grupe parlamentar.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke shprehur besimin në atë se për shkak të rëndësisë që ka vetë projektligji, mendojmë që serioziteti nuk përkon me punën dhe gatishmërinë e grupeve parlamentare për ta rregulluar këtë çështje, e cila është edhe imediate, edhe është shumë e nevojshme.

Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka paraqitur amendamentet e saj, të cilat nuk janë shqyrtuar në Komisionin FunkSIONAL për arsye të procedurave që ju i përmendët dhe për shkak të anashkalimit të afateve sipas Rregullores së Kuvendit. E dyta, pajtohemi plotësisht që materiali i pasjellë do të krijojë konfuzion në vendimet e deputetëve për miratimin e amendamenteve të paraqitura, andaj unë e thërras Komisionin FunkSIONAL që ta shqyrtojë këtë çështje jo ad hoc, jo në mënyrë të përshpejtuar në bazë të agjendave politike, por për ta zgjidhur një çështje e cila është e rëndësisë dhe kërkohet në mënyrë permanente nga luftëtarët e lirisë dhe nga të gjitha subjektet politike.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Faton Topalli e ka kërkuar fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Ky ligj ka ardhur me shpejtësinë ‘turbo’ gjatë ditëve të fundit, edhe pse kanë kaluar 15 vjet prej se ekziston një kërkesë e tillë për të qenë një ligj i tillë. Partia Demokratike e Kosovës, respektivisht kryeministri, e sjell këtë ligj për arsye se i nevojitet për fushatë dhe...

KRYETARI: Merru me ligjin, mos u merr me fushatë!

FATON TOPALLI: Jo, dakord! Veç ta përfundoj, të lutem!

Në qoftë se ligji është vonuar 15 vjet, mendoj se nuk luan kurrfarë rëndësie në qoftë se shtyhet për javën e ardhshme për arsye se është fjala për një ligj shumë të rëndësishëm, prandaj edhe një javë më shumë, apo një javë më pak, nuk luan ndonjë rol, kështu që ne jemi për atë që ligji të vijë me procedurë të rregullt javën e ardhshme dhe të mund të

bëhen edhe ndryshimet, të cilat ne do të dëshironim t'i bënim për arsye se me shpejtësinë që ka ardhur ka qenë e pamundshme për të punuar seriozisht në ligj.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Fillimisht për ta eliminuar çdo keqkuptim të mundshëm, duhet thënë se ne e përkrahim kalimin e këtij ligji. Kemi bërë shmangie edhe më herët, po bëjmë edhe tani. Mirëpo, kësaj pune duhet shtuar diçka edhe të ju them që derisa janë ofruar zgjedhjet, nuk u ka rënë ndërmend, ama bash hiç, për këtë ligj. Po t'u kishte rënë ndërmend më herët do të kishte hyrë në procedura të rregullta. Po t'i kishte rënë ndërmend Qeverisë më herët, ky ligj do të kishte hyrë në procedura të rregullta, por as që kanë menduar hiç për këtë punë.

Nuk jam duke e kërkuar veteranët këtë ligj tani, ka ligje që janë duke e kërkuar. Është duke u përmendur 15-vjetëshi. Jo, nuk janë 15 vjet. Me Kornizë Kushtetuese nuk kemi mundur ta bëjmë këtë punë, por me Kushtetutën e Kosovës po. Domethënë diku nja 6 vjet askujt hiç nuk i ka rënë ndërmend, derisa erdhi puna të përdoret edhe një herë për fushatë.

A e dini ç'është kultura bizantine për të marrë dhe për të dhënë? Fillimisht, të të merren krejt çka ke, e atëherë ato tuat të t'i japë nga pak e ngaak dhe me të fut borxh, të të thotë unë po të bëj nder. Kjo është ajo kulturë.

Edhe një herë po ju them, ne po - do ta votojmë këtë projektligj, mirëpo është me të vërtetë brutale kjo mënyrë e punës për t'i torturuar për një kohë të gjatë dhe kur vjen puna t'u merret diçka, me atë që e meritojnë, të futen borxh njerëzit. Kjo është goxha bizantine. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi "6+" e përkrah që të hyjë në rend dite ky ligj. Edhe në emër të komisionit si kryetar dua të sqaroj se ndoshta i kemi shkelur ose i kemi anashkaluar procedurat e Rregullores së Kuvendit, por dua të them që komisioni i ka shqyrtuar të gjitha amendamentet të cilat kanë ardhur nga grupet dhe deputetët. Ashtu i kemi votuar të gjitha amendamentet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët,

Duke e marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji, besoj se shmangia nga Rregullorja e Kuvendit, në rast se janë të pajtimit të gjithë që të hyjë në rend dite ky projektligj me amendamente dhe të shohim që të përfundojë një herë kjo çështje për gjithmonë.

KRYETAR: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne e dimë të gjithë se ky ligj vërtet është stërgjatur. Pengesat i dimë po ashtu të gjithë, se nuk kanë qenë të institucioneve dhe të vullnetit tonë. Vullneti ka qenë në vazhdimësi që të vijë ky ligj dhe kësaj kategorie shumë meritore t'i bëhet zgjidhje, megjithatë deri më tash kanë qenë pengesat të cilat i dimë të gjithë jo tonat. Tash kur janë evituar të gjitha këto pengesa dhe nuk kemi asnjë pengesë tjetër, është siguruar edhe buxheti për këtë kategori.

Ne plotësisht e përkrahim për sot, meqë kemi vënë ligje me shmangie edhe më të parëndësishme dhe i kemi tejkaluar. Një javë ditë për këtë kategori është shumë të pritët, sepse mjaft kanë pritur 15 vjet. Edhe unë po pajtohem se kanë pritur 15 vjet. Janë pjekur kushtet është tepër edhe një ditë për të pritur, prandaj ne kemi mundësi është në duar tona dhe unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve që të votojmë për shmangie, të fusim rend dite dhe ta aprovojmë këtë, sepse ka kaluar nëpër të gjitha komisionet e mundshme. Unë kërkoj që të hidhet në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Po, po e qesim në votim veç kur të vjen koha, por po ju them kështu ne nuk i kemi qitur ligjet, ligjet i kanë qitur partitë politike, grupet parlamentare dhe komisionet.

Ata e bëjnë punën për të ardhur çështjet në Kuvend. Fjalën e ka kërkuar Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit për Legjislacion ky ligj nuk është trajtuar në komision, mirëpo nëse seanca vendos, mundet të bëjë shmangie. Faleminderit! Vetëm sa për njoftim.

KRYETARI: Që në fillim iu tregova që realisht ky ligj mund të hyjë në rend ditës si pikë e fundit e rendit të ditës me shmangie, dhe ju e dini që shmangia bëhet me 2/3 e deputetëve të pranishëm.

Të pranishëm i kemi 108 deputetë, me prani fizike, 114 prania elektronike.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

U tha edhe më herët, ne dëshirojmë nja 5 minuta një konsultim ta bëjmë para se të shkohet në votim për shmangie.

KRYETARI: Mirë! Pesë minuta, ose më mirë shkojmë 10 minuta pushim dhe pastaj rikthehemi në seancë.

(Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.)

(Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Ka kaluar koha për pauzë, ju lutem zini vendet tuaja. Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismet Beqiri, kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Duke e pasur parasysh rëndësinë e ligjit, ne si Grup Parlamentar para se të shkohet në votim, duke u bazuar më herët edhe në fjalët dhe premtimet e vet kryeministrit, këtu që të gjithë ata që e kanë veshur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të trajtohen barabartë dhe ajo duhet të thuhet në mënyrë shprehimisht këtu në projektligj, pa ekuivokë dhe duhet të figurojë ashtu siç i kemi propozuar amendamentet.

Kërkesa e Grupit tonë Parlamentar është që Grupi Parlamentar i PDK-së ose kryeministri në emër të tyre, të deklarohej i përkrahin apo jo amendamentet e Grupit Parlamentar të LDK-së. Nëse i përkrahin, ne do të votojmë për shmangie, nëse nuk i përkrahin, grupi ynë parlamentar do të votojë kundër shmangies dhe pastaj po që se po paragjykoj, ne do ta themi më tutje qëndrimin tonë nëse e fusim në rend të ditës. Kaq! Është kërkesa jonë.

KRYETARI: Urdhëro kryeministër, pasi po kërkon kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

Zoti Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,

E kam theksuar jo njëherë, por shpeshherë dhe qëndroj mbrapa 100% deklaratës sime që përkon me realitetin e luftës çlirimtare të Kosovës. E para ajo çka dëshiroj të theksoj është se veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i përkasin të gjitha partive politike, janë vlerë e qytetarisë, janë vlerë e shtetit të Kosovës, e shoqërisë kosovare, janë krenaria e Kosovës.

Asnjë parti politike nuk është pronare e atyre vlerave dhe asaj lufte. Ligji, të cilin e kemi sot në duart tona, në Kuvend e ka kaluar leximin e parë, ky ligj i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është ligji që është punuar nga shoqatat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ligj i harmonizuar plotësisht me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, ligj ky i harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar, tash në fund. Prandaj, qëllimi i këtij ligji është shumë i qartë, përcaktimi i të drejtave në beneficionet e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me angazhimin, sakrificën e çmuar në luftën çlirimtare të Kosovës ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.

Gjithashtu, beneficione do të gëzojnë edhe familjarët e tyre. Ritheksoj edhe sot para të gjithëve, për mua çlirimtarë janë çdo të gjithë qytetarët e Kosovës, çdo qytetar i Kosovës që ka dhënë edhe një kontribut më të vogël për lirinë e vendit dhe duhet të ndihet mirë me kontributin e tij.

Tjetër, askush, askujt nuk mund t'ia mohojë edhe vetëm një minutë nëse ka bartur uniformën e UÇK-së, atë kontribut. Pra, vazhdoj të këmbëngul fuqishëm se duhet të respektohet kontributi i çdo luftëtari të UÇK-së, në çdo periudhë kohore dhe çdo luftëtar me emblemë të UÇK-së ka qenë luftëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, askush nuk do të mund t'ia mohojë dhe as unë personalisht nuk do të lejoj si propozues i këtij ligji, si o Qeveria tash të mohohet diçka e tillë. Prandaj, ju siguroj dhe garantoj zoti Beqiri, ritheksoj edhe njëherë ky ligj është ligji që është shkruar prej shoqatave të luftës, prej Shoqatës së Veteranëve të Luftës, në harmoni të plotë me Zyrën e Kryeministrit, me iniciativën time është bërë, kam punuar kohë të gjatë, gjithashtu është dashur që të punohet kohë të gjatë, të harmonizohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e kemi edhe pëlqimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, tash është gjithçka në rregull, mendoj që gjithçka është e qartë. Faleminderit, shumë! Dhe, ju ftoj...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Po lëvizim gradualisht drejt një rikonceptimi të kësaj idesë së shmangies, fillimisht ideja për shmangie dhe kundërshtimi ishte parimor, pra për shkak se nuk i ka kaluar procedurat që duhet të kalohen domosdoshmërisht në Kuvend.

Ne mendojmë që këto procedura duhet të përfillen edhe për shkak se i jep Kuvendit më shumë mundësi për ta përmirësuar ligjin. Pra, natyrisht që nuk jemi kundër ligjit, mirëpo e kemi thënë edhe në lexim të parë e po e themi edhe tash, ligji ka shumë hapësirë për përmirësime, për ta bërë më të mirë dhe më të zbatueshëm për veteranët, pra për ata për të cilët po flasim dhe ky ligj fatkeqësisht nuk i plotëson të gjitha ato interesa dhe kërkesa të veteranëve.

Po lëvizja “Vetëvendosje” është kategorikisht kundër këtij konceptimi të ri të shmangies. Pra këtu filluam të dëgjojmë se si po bëhet një lloj pazari me veteranët në atë se amendamentet e kujt dhe si do të votohen ato dhe këto po e kushtëzojnë votën për shmangie. Prandaj, ne nuk do të marrim pjesë në këtë votim për shmangie, sepse nuk duam të marrim pjesë në këtë pazar i cili është jashtëzakonisht i pandershëm me veteranët që po bëhet këtu për interesa politike.

KRYETARI: Ju lutem, Rregullorja parasheh shmangien si procedurë. Nëse votojnë 2/3 e deputetëve të pranishëm, unë s'po bëj asgjë tjetër, po e zbatoj Rregulloren dhe me qëllim u tregova në fillim se gjitha procedurat deri më tani janë shpejtuar, por vendimi është i Kuvendit dhe këtë ne duhet të shkojmë në procedurën e votimit.

Ismet, se më duket pate replikë, pastaj kryeministri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Unë kërkoja nga kryeministri jo për punë pazaresh, por për punë të përmbushjes së obligimit ndaj gjithë atyre që kanë luftuar dhe amendamentet tona që i kemi propozuar e bëjnë këtë, as nuk e rrit zoti kryeministër fondin siç e thoni e ju, sepse nëse përfshihen të gjithë, nuk ke problem as me Fondin Monetar që po e përmend, as me të tjerët.

Ajo që është e rëndësishme, ne po ju pyesim qartë: kënd e pengon që të figurojnë amendamentet tona, të përkrahen që shkruhen në mënyrë të qartë që e përkrahin të gjithë ata ose gjithë ata i përkrahin që ka luftuar dhe ju e dini fort mirë që kanë luftuar nën emblemën e UÇK-së, por që disa kanë qenë nën Ministrinë e Mbrojtjes, të tjerët kanë qenë nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm.

Unë zoti kryeministër, kërkoj nga ju edhe njëherë që ta thoni në mënyrë shprehimore është e drejtë e jona, sepse ju po zotoheni se do të përkrahni të gjithë ata që kanë luftuar dhe asgjë më tepër nuk ka në amendamentet tona se të përkrahen të gjithë ata që kanë luftuar dhe janë shumë në mënyrë shprehimore të theksuara.

Dhe, kryetar unë e di që s'kemi hyrë në rendit të ditës, po nëse më lejon vetëm po e lexoj të parin amendament që të tjerët janë derivate, nëse më lejon.

KRYETARI: Ju lutem, jemi te shmangia e ligjit, te amendamentet kur vjen në rendin e ditës, flasim për amendamente.

ISMET BEQIRI: Ok-ej!

KRYETARI: Njëherë të merremi vesh me u shmang, tani te amendamentet kur shkojmë atje, bisedojmë për amendamente, kjo është procedura, urdhëro kryeministër.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Fillimisht dëshiroj ta sqaroj shefin e Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes" sa i përket përmirësimit të ligjit.

Edhe njëherë e theksoj, Ligji për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është ligj që u punua prej Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në harmoni të plotë me Zyrën e Kryeministrit, me iniciativën time, tash ka mbulesë financiare dhe është i harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Pra, është ligj i vullnetit të veteranëve të luftës dhe nuk është ligj i imponuar, por çdo ide është e mirëseardhur për të plotësuar, natyrisht duke mos i cenuar të drejtat dhe interesat e veteranëve për çka nuk dyshoj në asnjë rrethanë.

Në anën tjetër, rezistenca jonë e qytetarëve të Kosovës, e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi, nuk ka filluar në vitin '90, as '98, as '99, ka përfunduar në qershor të '99-tës.

Ka filluar që nga paslufta e Dytë Botërore me simbolin e rezistencës Adem Demaçi, me Lëvizjen e tij për Bashkim, '68 për Republikë, '74 një avancim, '81 përsëri Lëvizja Studentore për Republikë, për të vazhduar tutje me rezistencën civile të udhëhequr nga

presidenti Rugova, për të vazhduar dhe kulmuar me rezistencën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për të larguar Serbinë nga Kosova.

Prandaj, të gjitha këto e kanë plotësuar njëra-tjetrën për të ardhur deri te çlirimi i vendit dhe historia jonë e çlirimit nuk mund të jetë e shkëputur prej njëra-tjetrës, do të thotë viteve, kohëve dhe kjo i fyen njerëzit edhe veteranët e lëvizjes për liri, pavarësi edhe për çlirimin e Kosovës.

Pra, e ritheksoj edhe njëherë do të respektohet dhe qëndroj jetësisht, jo politikisht, po jetësisht qëndroj pas zotimit tim. Nuk do t'i mohohen asnjë luftëtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të drejtat e tij dhe beneficionet, në anën tjetër, as edhe për një minutë nëse ka bartur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tjetër, realisht duhet të flasim me realitetin e zhvillimeve, të gjithë njerëzit që kanë luftuar me armë në dorë kundër ushtrisë dhe policisë serbe, kanë bartur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo është e përcaktuar shumë qartë se të gjithë do t'i gëzojnë të drejtat dhe beneficionet e tyre.

Tjetër, pavarësisht prej dhe nuk dëshiroj të kthehem në të kaluarën, pavarësisht prej opinioneve të ndryshme, ne në atë kohë, si drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së, zoti Bukoshi, si kryeministër i Qeverisë së Kosovës, në atë kohë, jemi takuar dhe kemi arritur unifikimin që të gjithë luftëtarët e lirisë të luftojnë me emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë nuk kam takuar në Kosovë ndonjë ushtar me ndonjë emblemë tjetër vetëm me emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, gjithçka është e përcaktuar në ligj është e harmonizuar, është respektuar realiteti i luftës dhe të drejtat e tyre do t'i gëzojnë të gjithë, pa asnjë dallim politik. Ky është ligj për interesat e veteranëve të luftës, jo për interesa politike në asnjë rrethanë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj që diskutimet janë harxhuar. Jo, nuk ka, mendoj që është procedura e votimit, nuk kemi debat.

Kemi shmangie. Vazhdojmë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Për praninë votojmë së pari. Për praninë në mënyrë elektronike kanë votuar 93 deputetë, prezenca fizike është 110. Do të thotë po mungojnë goxha shumë.

Ju lutem, ne po miratojmë ligj, këtë ta keni parasysh. Dhe, të merremi vesh, jemi duke futur në agjendë me procedurë të shmangies një ligj, diskutimet vijnë kur të diskutojmë për ligjin.

Unë e kam treguar shumë mirë, nuk kam nevojë ta përsëris më. Por, vendimi është i seancës, nuk është imi, unë votoj për atë që voton seanca.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash me 2/3 mund ta shmangim ligjin.

62 kanë votuar për, 31 kundër, 2 abstenime, që do të thotë nuk i ka përmbushur 2/3.

Është dashur të jenë 64, për dy vota nuk ka kaluar.

Vazhdojmë! Duhet të votojmë edhe për pikën e katërt të rendit të ditës me shmangie. Nuk i ka plotësuar 10 ditë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash. Votojmë për shmangien e Ligjit për zgjedhjet.

Me 73 vota për, 21 kundër, 2 abstenime, Ligji për zgjedhjet radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Është votuar, mbetet pika e fundit e rendit të ditës. Sipas Rregullores kur të shmanget diçka futet, pikë e fundit e rendit të ditës.

Kemi miratimin e procesverbalit nga seanca e mëparshme. Unë nuk përkthej.

Para deklarimit për miratim të procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 13, 14, 19 mars 2014, më lejoni të bëj një përmirësim të konstatimi lidhur me pikën 13, zgjedhja e Avokatit të Popullit.

Konkursi për Avokatin e Popullit duhet të përsëritet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit, përmirësohet me konstatimin: “vazhdon procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit”.

Do të thotë, kjo duhet të jetë përmirësim i procesverbalit.

Pyes nëse ka vërejtje tjera në procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 13, 14 e 19 dhe 20 mars 2014. Nëse nuk ka, atëherë konstatoj se me këtë ndryshim miratohet procesverbali.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

5. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Deputetë, pasi që votimi do të zgjasë, nëse hyjmë në procedurën e votimit, do të zgjasë me siguri bukur gjatë, a po e marrim pauzën tani e pastaj, pasi të kthehemi, a jeni dakord, a të fillojmë me votimin? Pra, fillojmë me votimin. Faleminderit!

(Debat në sallë.)

Votojmë herën e parë, e të dytën, nëse vonohemi dhe nuk e zgjedhim, bëjmë pauzë. Vazhdojmë.

Procedurat që i kemi kaluar në seancën e parë, ndoshta nuk kanë qenë krejt të qarta, por megjithatë edhe këtu mendoj që duhet ta marrë një vendim Kuvendi.

Në nenin 9 të Ligjit për Avokatin e Popullit, thuhet: “Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda 30 ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve”.

Ne realisht, kemi qenë në këtë pikë tamam me kohë. Ka krijuar konfuzion vazhdimi, por vazhdimi vlen nëse nuk realizohet kjo që u tha deri këtu. Vazhdimi i nenit thotë: “nëse ky afat nuk është arritur...”, ne e kemi arritur afatin. Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në secilën seancë plenare për 30 ditë të tjera.

Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet brenda 60 ditëve, komisioni përkatës i Kuvendit përsëri do të shpallë konkursin për Avokat të Popullit. Konsideroj që kjo pjesa tjetër, për votimin që kemi bërë ne është e panevojshme, sepse kemi qenë në afat.

E tash të shohim se çka thotë rregulla 9 e Rregullores së punës së Kuvendit.

Neni 9, pika 1, Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit për një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë zgjedhjeje.

2. Kandidati me më së paku vota hiqet nga lista e Kuvendi, voton prapë në rrethin tjetër, për dy kandidatët e mbetur, nëpërmjet fletëvotimit të fshehtë.

Dhe e treta, që edhe kjo ndoshta ka krijuar një konfuzion e s’do të duhej të krijonte konfuzion, nëse dy kandidatët marrin numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet derisa njëri prej kandidatëve fiton numrin më të madh të votave.

Unë konsideroj që votimi që është bërë atë ditë dhe përfundimi, nëse i kemi parasysh këto, është përfunduar. Por, pasi edhe nga shoqëria civile edhe tjetërkush... është bërë zhurma, ne nëse seanca vendos me ia nisë edhe njëherë prej fillimit votimin për Avokat të Popullit, mund ta bëjmë.

Unë kisha kërkuar deklarinimin e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është që mos të anashkalohet asnjëri prej kandidatëve, t'u krijohej një mundësi dhe ta ndjejnë veten që kanë trajtim të barabartë, të përsëritet votimi në tërësi. Pra, të shkojmë në votim për tre kandidatët.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Për të ndodhur kjo që u tha tash së fundi, duhet anuluar ajo që ka ndodhur herën e kaluar. Dhe, ajo nuk ka asnjë bazë ligjore, për t'u anuluar, çka do të thotë që ne jemi që të vazhdohej aty ku ka mbetur, me një kandidat, sepse kjo është ligjore. Ky Kuvend mund të vendosë edhe diçka tjetër, por kjo është ligjorja. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk pat asnjë kundërshtim në ndryshimin e procesverbalit. Në procesverbal bëmë korrigjimin, që vazhdon votimi dhe tash unë me qëllim i bëra shpjegimet, për shkak të... realisht, ndoshta konfuzionit që e kanë bërë në ligj. Por, nëse fillon votimi, fillon prej së parit, ose konsiderohet votimi i kryer dhe shpallet konkursi.

Urdhëro ,Visar! Në emër të Grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Këtu qartazi kemi të bëjmë me një situatë, ku duhet ta vazhdojmë votimin. Dhe, nëse vazhdohej votimi, vazhdon aty ku ka mbetur. Nuk mund të vazhdojmë pra, nuk kemi nevojë ta ripërsërisim votimin, përveç nëse ka pas ndonjë vërejtje, ndonjë parregullsi në procesin e kaluar të votimit, gjë që nuk kam dëgjuar që ka argumentuar ndokush. Edhe, ne nuk kemi tash kurrfarë të drejte, as baze, që si seancë për ta hedhur poshtë një votim, që e kemi bërë vetë para një jave, por duhet ta vazhdojmë sipas dispozitave ligjore, ta vazhdojmë votimin aty ku kemi mbetur. Dhe, pastaj të nxjerrim një përfundim krahasuar me ato vota që nxirren.

KRYETARI: Ardian e ke fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po shihet që ne kemi një diskrepancë, ose një dallim në mes të Rregullores së punës dhe Kushtetutës.

Në Kushtetutë nuk thotë që hyn në rrethin e dytë ose të tretë ai që merr vota më së shumti zgjidhet, po është taksative, duhet shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të gjithë deputetëve, që do të thotë 61 vota, me sa po kuptojmë ne.

Edhe kjo na qet në pozitë goxha problematike. Nëse do të kishte provizion të qartë, që thotë në rrethin e fundit, ai që merr më së shumti vota zgjidhet dhe prapë jo në bazë të Rregullores së punës, po në bazë të Kushtetutës, se Avokati i Popullit është kategori

kushtetuese, është institucion i rregulluar me Kushtetutë, atëherë ne do ta kishim pasur Avokatin e Popullit sot.

Mirëpo, unë po e vërej që po na ndodh një gabim në vazhdimësi. Nuk mundet Kuvendi ta interpretojë ligjin. Mundet vetëm Rregulloren, as ligjin as Kushtetutën nuk mundet për ta interpretuar Kuvendi. Duhet të këtë njerëz profesionistë që e bëjnë një gjë të tillë, duhet të jetë Zyra Ligjore e cila na sjell neve një opinion ligjor dhe na tregon se qysh të veprojmë.

Shikoni, në momentin kur flasin deputetët e shumica prej nesh nuk jemi as juristë edhe sikur të ishim, me funksionin që e kemi, nuk e kemi të drejtën e interpretimit të këtyre procedurave. Ne kishim për të dalë prej problemit, por ne nuk e kemi marrë një opinion zyrtar të Zyrës Ligjore ose të një organi i cili është i thirrur ta bëjë këtë interpretim, në mënyrë që Kuvendi të di qysh të veprojë.

Edhe njëherë po ju them, nuk është kjo mangësi e Kuvendit, kjo nuk domethënë që Kuvendi nuk po din ose diçka tjetër. Asnjë Kuvend normal në demokraci në botë, nuk i bën interpretimet vetë, po janë institucionet, të cilat e bëjnë interpretimin. Ne tash këtu, po provojmë secili prej një këndi për ta bërë një interpretim të ligjit. Ky është gabim.

Edhe unë mendoj se kështu ne gjithmonë do të jemi në lajthitje. Ne duhet t'i kemi prej zyrave tona që marrin rrogë, që janë të specializuar t' i bëjnë interpretimet, duhet t'i kemi të shkruara në letër cila është procedura. Nuk bën të fajësohet Kuvendi pse po gabon në procedura. Nuk bën, se ne jemi deputetë dhe ne me votën tonë nuk e shkelim ligjin, përdërisa i kërkohet vota deputetit për, kundër ose abstenim, nuk ka qysh ta shkelë ligjin as Kushtetutën deputeti, në momentin që diçka qitet në votim.

Kështu që, po më duket që një hallkë nuk po funksionon si duhet dhe ne duhet pasur atë hallkë në gjendje të na tregoj cila është procedura. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re dhe kryetarja e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve, Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Nëse ju kujtohet, në seancën e kaluar, pata propozuar me vazhdimin e votimit të kandidatit të tretë, sipas Rregullores nenit 9.4, mirëpo nga ana e kryesuesit mu pat marrë fjala. Sidoqoftë, dua që... e kam pasur me të drejtë. Do të thotë, ne mendojmë se duhet të vazhdohet me pikën 9.4 të Rregullores.

Është një mospërputhje...

KRYETARI: Deputete, nuk është... ju lutem lexojeni Rregulloren, në cilat raste vazhdohet votimi.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Vetëm një moment. Unë dëshiroj ta them mendimin, të cilin e kemi, pastaj seanca le të vazhdojë, le të votohet në seancë.

Realisht, Rregullorja dhe ligji nuk janë në përputhje. Neni 9, pika 5 e Rregullores dhe neni 9 pika 2 e Ligjit nuk janë në përputhje. Mirëpo, tani le të vendosë seanca se çka... a do të votohet një kandidat apo do t'ia fillojmë prej fillimit?

KRYETARI: Shikoni, Rregullorja është shumë e qartë. Pika 2 thotë, kandidati me më së paku vota hiqet nga lista e Kuvendi, voton prapë rrethin tjetër për dy kandidatët e mbetur nëpërmjet fletëvotimit.

Pika e tretë është shumë hipotetike. Jo, unë nuk e lexoj katërshin tash, se katërshi lidhet me treshin. Ju lutem, nuk lidhet me dyshin. Treshi thotë, nëse kandidatët... shkojmë te treshi, votimi tjetër që kandidatët kanë vota të barabarta.

Prandaj, ajo është një pikë hipotetike. Ne jemi te pika e dytë dhe asnjë kandidat nuk ka ardhur në vota të barabarta dhe kryesuesi, mendoj që me të drejtë e ka mbyllur votimin dhe ka thënë shpallet... po, ne e votuam atë në procesverbal, ne mund të shkojmë ta përsërisim votimin përsëri, jo pse votimi atë ditë nuk ka qenë në rregull. Kaq.

Atëherë, neve na duhet një pauzë. A po... edhe formojmë Komisionin para se të shkojmë.

Partia Demokratike kë e propozon për anëtar të Komisionit?

ADEM GRABOVCI: Partia Demokratike e propozon Blerta Deliun.

KRYETARI: Faleminderit! Lidhja Demokratike, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë zonjën Rita Hajzeraj.

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”.

VISAR YMERI: Nga “Vetëvendosja” anëtare e Komisionit do të jetë deputetja Albana Gashi.

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca, kush po e merr fjalën?

DAUT HARADINAJ: Ne e propozojmë Kymete Bajraktarin.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejenja.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Nga Koalicioni për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”-i Myfera Shinik... Enis Kervan

ENIS KERVAN: Rasim Demiri.

KRYETARI: SLS-ja nuk janë këtu. Atëherë...

(Ndërprerje e incizimit.)

...A po shkojmë në pauzë, a po marrim veç 15 minuta, a si po ia bëjmë? Mirë, shkojmë në pauzë deri në orën 14:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po fillojmë me leximin e... jo, jo, i ftoj deputetët që të përgatiten për votim. Sipas radhës i pari Adem Grabovci. Zoti Grabovci, je i pari në votim.

Afërdita Berisha-Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylaj, Nait Hasani, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj,

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Eqrem Kryeziu, Ethem Arifi (s'është), Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni, Hashim Dëshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Millosavleviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviq, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqu, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti, Xhavit Haliti.

BLERTA DELIU-KODRA: Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Adriana Hoxhiq, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari,

Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Adrijana Hoxhiq, Adrijana Hoxhiq, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, E pavlefshme, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Adrijana Hoxhiq, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit.

BLERTA DELIU-KODRA: Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numrit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 27 mars 2014, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 84 deputetë, i pavlefshëm është një fletëvotim.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Adriana Hoxhiq i ka fituar gjithsej 5 vota,
2. Hilmi Jashari i ka fituar 41 vota,
3. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 37 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9.1 të Ligjit numër 03/L-195 për Avokatin e Popullit dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se në rundin e dytë të votimit hyjnë kandidatët: Hilmi Jashari dhe Gjyljeta Mushkolaj.

KRYETARI: Administrata e shpërndan materialin.

Të nderuar deputetë,

Unë nuk po ju sugjeroj, por po ju njoftoj: e kemi edhe një votim. Votimi i tretë mund të zhvillohet me kusht vetëm nëse votat janë të barabarta. Unë shqip po flas, nëse votat nuk janë të barabarta nuk zgjidhet Avokati i Popullit, por shpallet konkursi.

Ju njoftoj, që të mos lodheni. Rregulloren e Kuvendit e interpretoj unë, kush ka vërejtje pastaj pas këtij votimi është Gjykata Kushtetuese, e dërgoni ankesën atje.

Fillojmë, e keni materialin:

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu,

Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinković, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Ismet Beqiri...,

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu,

(Ndërrprerje nga regjia.)

Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Haljilji, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Milosavljeviq, Petar Miletiq, Rada Trajković, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanović, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todorović, Sreten Ivanović, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqu, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajazitit dhe Xhavit Haliti.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Kryetarja e Komisionit e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, e pavlefshme, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi

Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, e pavlefshme, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj, Gjyljeta Mushkolaj, Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj

KRYETARI: Kryetarja e Komisionit i jep rezultatet.

BLERTA DELIU-KODRA: Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 27 mars 2014, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 86 deputetë, kurse të pavlefshme janë dy fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Hilmi Jashari i ka fituar gjithsej 43 vota
2. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 41 vota

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

Ju njoftoj që votimi në seancën e shkuar ka qenë krejt në rregull dhe përfundimi është bërë në rregull. Me kohë ndoshta nuk jemi konsultuar sa duhet, por nga të gjitha konsultimet del se asnjëri nga kandidatët nuk i merr votat e duhura, kështu që ky votim është përfunduar. Kuvendit i mbetet ta rishpallë konkursin për Avokatin e Popullit. Votimi nuk mund të përsëritet për faktin që unë e tregova pse, kush ka pasur veshë! Votimin do ta ripërsëritim ose përsëritim sikur pika 3, do të thotë të 2 kandidatët t'i kishin votat e barabarta, e nuk i kanë votat e barabarta, nuk ka fituar asnjëri, kështu që këtu mbyllet votimi. Pas 30 ditësh shpallet konkursi për Avokatin e Popullit.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeminstren zonjën Edita Tahiri që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

EDITA TAHIRI: Faleminderit i nderuar, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në këtë seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës e paraqes para jush Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, i cili është miratuar nga Qeveria me vendimin nr. 13/162, më 27 dhjetor 2013. Është sot para jush

dhe elaborimi i arsyeshmërisë është si vijon: nxjerrja e këtij projektligji ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale, si dhe krahasimin dhe zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve kadastrale, origjinale të marra me dhunë në Kosovë nga Serbia para qershorit të vitit 1999, dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private, për pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në përcaktimin, funksionimin dhe organizimin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikimin të Pronës, ku synohet të mundësohet pranimi, krahasimi dhe verifikimi i dokumenteve kadastrale të marra nga Kosova me dhunë nga pushteti i Serbisë para qershorit të vitit '99, si dhe lehtësohet vazhdimi i mandatit aktual të Agjencisë Kosovare për Pronën si zgjidhje e kërkesave pronësore, zbatimi i vendimeve, administrimi i pronave dhe zbatimi i skemës së qirasë deri në përfundimin e tij.

Me këtë projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shqyrtuar një sërë opsionesh të mundshme. Opsioni i rekomanduar është nxjerrja e ligjit të ri me qëllim të kthimit të dokumentacionit kadastral.

Për krijimin e një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si rezultat i marrëveshjes nga dialogu teknik i arritur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin dhe garantimin e Bashkimit Evropian, që rrjedhimisht nënkupton kthimin e dokumenteve kadastrale në Kosovës, të marra në vitin 1999, si dhe konkretizimin e disa normave juridike.

Projektligji në fjalë i rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe funksionimin dhe organizimin e një bordi mbikëqyrës të agjencisë, sekretarisë ekzekutive, Komisionit për kërkesa pronësore dhe Komisionit për verifikim dhe vendosje për pronat.

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

E kisha nderin që sot t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate dhe sa më shpejt të fillojmë me kthimin e dokumentacionit kadastral në Kosovë dhe që kjo agjenci të bëjë verifikimin dhe krahasimin e gjithë dokumentacionit, i cili për vite të tëra ka shkaktuar probleme të mëdha në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit, e do fjalën? Nëse jo, nënkryetari. Fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar zëvendëskryeministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Agjencinë Kosova për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe i rekomandon Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e tij. Njëkohësisht, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ne do ta aprovojmë në parim dhe jemi të gatshëm që ndryshimet e nevojshme, dilemat që janë ngritur rreth kushtetutshmërisë ndërmjet dy leximeve të shqyrtohen dhe të aprovohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

E dimë gjithë që ky projektligj ka kaluar, ka një të kaluar ta quajmë ashtu historike të refuzimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili është karakterizuesi, është në kundërshtim me normat e Kushtetutës.

Ndryshimet nuk kanë ndodhur në përmbajtje as tash siç ka ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, unë mendoj dhe e theksoj apo më mirë ta them ta përsëriti jo transparenca gjatë bisedimeve që ka ndodhur e konkretisht për këtë marrëveshje për librat kadastral, sigurisht që reflekton edhe në këtë projektligj.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka abstenuar në komision për këto arsye dhe ka të bëjë edhe me nenin 6, paragrafin 2 të këtij projektligji, mendoj që duhet të rishikohet. Por, nëse neve nuk kemi një pasqyrë reale të asaj marrëveshje dhe e cila duhet të inkorporohet në këtë projektligj, mendoj që prapë Kuvendi duhet ta refuzojë si i tillë ashtu siç është paraqitur edhe në këtë për lexim të parë.

Neve sot do ta votojmë për, për t'i jap mundësinë që këto ndryshime t'i bëjmë në komisionin funksional, përndryshe edhe në lexim të dytë nëse nuk arrijmë t'i bëjmë ndryshimet do ta votojmë kundër këtij projektligji.

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë fillimisht po e lexoj një përgjegjësi të Komisionit për Legjislacion e që në këtë rast, si dhe disa raste të mëparshme nuk e ka kryer punën siç duhet. Pra, si kompetencë e Komisionit për Legjislacion është që shqyrton projektligjet në aspektin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Ndërsa, draftligji që na është sjellë nga Qeveria është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pra, ky projektligj për ne si subjekt politik sërish është i papranueshëm për faktin se paraqet tendencën ligjore që Agjencia aktuale e Pronës të vazhdojë autoritetin duke

ndërruar kështu vetëm akronimin formal të saj. Këtij agjencioni do t'i shtohen atributet të cilat i mungonin KPA-së. Pra, ajo është verifikimi në bazë të krahasimit të dokumenteve poseduese me të dhënat në dokumentet kadastrale, origjinale siç e thotë projektligji e që në realitet janë kopje të dokumenteve kadastrale të marra nga Serbia.

Përderisa KPA-ja ishte themeluar me arsyetimin se është duke i shërbyer shkarkimit të lëndëve gjyqësore dhe se ka për qëllim vetëm të ndihmojë sistemin gjyqësor në aspektin e shqyrtimit të lëndëve specifike pronësore, ajo luajti një lojë duale sa i përket sistemit gjyqësor.

Kjo tendencë është e shprehur edhe me këtë projektligj, andaj për ne është i papranueshëm që të mirëmbahet një organ paragjyqësor, siç është në këtë rast Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Për ekskluzivitetin e kompetencës së kësaj agjencie më së mirë flet paragrafi 3, i nenit 4 të Projektligjit kur themelon kompetencën ekskluzive mbi çështjet e ndërlidhura dhe të specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni. Varësinë dhe cenimin e sovranitetit ekzekutiv të institucioneve të Republikës së Kosovës edhe njëherë e vërteton dispozita e paragrafit 2, të nenit 6 ku emërimi i dy anëtarëve bëhet nga kryeministri pas konsultimit me PSBE-në, pra Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian.

Për ta tërhequr një parantezë me këtë, kemi shembullin e emërimit të shefit të AKI-së, ku atë e emëron kryeministri pas konsultimeve me Presidenten e Republikës së Kosovës. Sipas kësaj shihet një ngjashmëri e përzierjes së kompetencave ekzekutive të një shteti sovran. Për ta argumentuar vazhdimësinë e KPA-së dhe transformimin në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, është pikërisht neni 8, i cili përshkruan funksionin e Komisionit për Kërkesa Pronësore, është tipike për funksionin e KPA-së. Edhe këtu për nga përbërja e këtij organi, shihet prapë vazhdimësi dhe cenim i sovranitetit ekzekutiv të organeve vendore, pra me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk i ndërprehet mandati anëtarit ndërkombëtar, por konfirmon ushtrimin e kompetencave deri në mbarimin e plotë të mandatit të tij.

Dhe, rëndësia e këtij projektligji është se përfshin një organ të veçantë të quajtur Komision për Verifikim dhe Vendosje për Prona. Dhe, në nenin 9 paragrafi 1, është specifikuar se tre nga pesë anëtarët e këtij komisioni do të emërohen nga PSBE-ja, gjë që e vërteton që të gjithë anëtarët që i kemi potencuar, pra edhe më parë lidhur me cenimin e sovranitetit ekzekutiv.

Arsyetimi i koncentruar në atë se këtë e bën PSBE-ja duke marrë parasysh interesat e komuniteteve, përgjigja për këtë është se Kuvendi i Kosovës ka garantuar edhe më shumë se sa që duhet për të gjitha komunitetet se të gjitha janë të përfaqësuar në Kuvend. Pse atëherë i duhet PSBE-ja që t'i propozojë këta anëtarë?

Pra, edhe njëherë po e them që ky projektligj është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i ftoj deputetët që mos ta votojnë të njëjtin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Me siguri se Kosovës i duhet një zgjidhje e mëtutjeshme për çështjen në fjalë, do të thotë për Agjencinë Kosovare të Pronës.

Ne do ta votojmë në parim këtë projektligj, por definitivisht mendojmë se gjatë punës për lexim të dytë duhet që të bëhen disa përmirësime, për shkak se me të vërtetë janë disa elemente, të cilat janë totalisht të panevojshme dhe dalin përtej asaj që ne mund ta quajmë sot “nevojë” që të merremi me këtë temë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë të nderuar,

Po, nuk ka dyshim që ky projektligj padyshim që ka mjaftë dilema, ngase dimë që në të kaluarën jemi ballafaquar me të gjitha ato çështje mjaftë të ndjeshme sa i përket pronës dhe dokumenteve kadastrale.

Ne si grup parlamentar në parim e mbështesim në lexim të parë dhe puna kryesore mbet padyshim në komision dhe aty do të ishte mirë që të vlerësohet kushtetutshmëria e këtij projektligji dhe të gjitha ato dilema që kanë të bëjnë të sqarohen sa më mirë, kështu që ne e mbështesim në parim.

KRYESUESI: Grupet parlamentare kanë dhënë mendimet e tyre. Radha është e deputetëve. Fjalën e ka zoti Tahiri.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Natyrisht që në linjë edhe me qëndrimin e Grupit Parlamentar, megjithatë nuk mund të kalojmë në këtë lexim të parë pa i spikatur disa nga problemet shumë themelore që i ka ky ligj edhe në mënyrën se si është draftuar, por edhe vetë koncepti i ligjit.

Unë mendoj personalisht që problemet pronësore janë nga problemet më të rënda që qytetarët e Kosovës kanë pasur në lidhje me gëzimin e të drejtës së tyre pronësore, prandaj ky ligj për mendimin tim vetëm sa do të komplikojë këtë proces edhe ashtu tejet të komplikuar në Republikën e Kosovës dhe do të ketë probleme shtesë për sa i takon çështjeve pronësore.

Pra, unë e kundërshtoj vetë konceptin e këtij ligji që domethënë çështjet dhe kontestet pronësore të zgjidhen nga një organ administrativ i këtij lloji, sepse vetë KPA-ja është dëshmuar si e pasuksesshme në zgjidhjen e problemeve pronësore. Problemet pronësore,

çdo kontest në lidhje me pronësinë, duhet t'i referohet gjykatave dhe ne duhet ta forcojmë sistemin gjyqësor, gjykatat e Republikës së Kosovës dhe ato të merren me zgjidhjen e çdo kontesti pronësor dhe jo organe administrative, politike sikur që do të jetë Agjencioni që do të themelohet me këtë ligj të merret me zgjidhjen e këtyre kontesteve.

Gjykatat kanë kapacitet, gjyqtarët kanë kapacitet dhe integritet që t'i zgjidhin, adresojnë çdo kontest në lidhje me pronën. Përveç kësaj, më lejoni të tërheq vëmendjen te neni 27, i draftligjit, i cili thotë: "shtojcat 1,2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L- 079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale vazhdojnë të jenë në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Pastaj, neni 29, kur flet për shfuqizimet thotë: " pas hyrjes në fuqi ky ligj shfuqizon Ligjin nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50". Pra, neni 27 lë në fuqi atë rregullore, atë ligj, ndërkohë neni 29, paragrafi 1 e shfuqizon krejtësisht atë. Dhe është një zbrazëti e madhe e ligjore.

Unë mendoj që në këtë ligj dhe kjo le të mbetet e shënuar në procesverbal për procesin e amandamentimit për komisionet funksionale, sepse ky ligj këtu duhet të parashihet një dispozitë që e obligon Qeverinë e Kosovës që të nxjerrë aktet nënligjore në periudhën 15 ditësh sa është koha e "vacatio legis" ose "pushimit të ligjit" derisa ligji të hyjë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Është e palogjikshme që një nen lë në fuqi pjesë të caktuara të legjislacionit të kaluar, neni tjetër shfuqizon krejt atë legjislacion.

Do të jetë një konfuzion total për sa i takon zbatueshmërisë ose dispozitave ligjore që janë të zbatueshme për këto çështje. Për këto arsye unë nuk do ta përkrahi, domethënë vota ime do të jetë abstenim për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Radha është e përfaqësueses se Qeverisë, zonjës Tahiri, zëvendëskryeministre.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Po filloj prej çështjes së instancës së fundit, më lejoni t'ju them që Marrëveshja e Brukselit për kadastra e thotë qartë që instanca e fundit e cila vendos për këto vendime është Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Pra, Komisioni për Verifikim që është në këtë projektligj është vetëm instanca e parë, prandaj një prej argumenteve se ligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është fakti se Gjykata Supreme është pra instanca e fundit e marrjes së vendimeve.

E dyta, Marrëveshja për kadastra, si edhe gjithë marrëveshjet tjera janë në ueb-faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kështu që transparenca është e plotë për qasje dhe analiza.

Po ashtu, Marrëveshja për kadastra parasheh kthimin e origjinaleve të skanuara dhe jo kopjeve dhe më tutje më lejoni t'ju them që roli i Bashkimit Evropian në këtë agjencion i ka dy dimensione: Bashkimi Evropian do të jetë në rolin e dëshmitarit për të parë se dokumentet që kthehen nga Serbia a janë të besueshme dhe origjinale apo janë të manipuluar?

Kështu që një palë e tretë e cila është aty gjatë verifikimit mendoj se është e dobishme edhe për ne, sepse është fjala për Bashkimin Evropian i cili kërkon nga Kosova si shtet aspirant që të ketë dokumentacionin dhe sistemin kadastral plotësisht sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Tutje më lejoni t'ju them se për sa i takon shqyrtimeve të mëtejme është fjala për leximin e parë dhe sigurisht do të jetë procesi i shqyrtimit dhe amandamentimit, ndërsa sa i takon sovranitetit për ata që në një mënyrë e kuptojnë çka do të thotë kur një shtet kërkon të bëhet anëtarë e Bashkimit Evropian. Në planin e sovranitetit kjo i bie që shteti është i gatshëm që disa nga kompetencat e veta të sovranitetit t' i ndajë me Bashkimin Evropian.

Ne një ditë do të marrim vendim, sepse ne jemi shtet aspirant, do të marrim vendim për anëtarësim normal duhet edhe BE-ja me marrë vendimin të na anëtarësoj, atë moment ne kemi ndarë sovranitetin e shtetit tonë me Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 67 deputetë. Ius regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, për t'u deklaruar me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Votojmë tash!

Faleminderit! Me 44 vota për, 5 abstenime, 14 kundër, konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës. Ngarkohet komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e 7 të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Po veç e kemi edhe Ligjin për reformën zgjedhore.

(Ndërhyrje)

A jeni dakord një votim formal po e kalojmë? Atëherë, sipas propozimit të zotit Hamiti dhe mbështetjes nga të gjithë deputetët kalojmë në pikën e 11 për ta bërë shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional Bujqësi, ai ka shkuar më duket. A është dikush që flet në emër të tij? Jo. Atëherë, s'dëshiron ta marrë fjalën. Në projektligj janë propozuar tri amendamente. Vazhdojmë me votimin.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 63 deputetë, votojmë tash.

Nuk kanë votuar të gjithë deputetët. E përsëris votimin për vëmendjen tuaj, votojmë tani!

Ju lus që të votoni për ose kundër. Okej. Atëherë, 60 vota me elektronik... po s'kanë kartelë jo është e pranueshme. Në rregull, dy me pa kartelë, me 62 vota për, po mendoj se këta po thonë që ... jo ata s'kanë kartelë dhe këtu është puna.

(Ndërhyrje)

Zoti Kuleta s'ka kartelë edhe zoti Selimi s'kanë kartelë, unë mendoj që s'ka nevojë për ta komplikuar çështjen. Janë 62 vota për. Konstatoj se Kuvendi me 62 vota për miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

I kthehem pikës së shtatë është:

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit kanë shqyrtuar Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim.

Radha është e kryetares së Komisionit Funkcional, zonjës Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zonja Hadërgjonaj e keni fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Në bazë të nenit 120 dhe nenit 121 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, Organi Shqyrtues

i Prokurimit deri në fund të muajit shkurt të vitit pasues kalendarik është i obliguar t'i dorëzojë një raport Kuvendit mbi mbarëvajtjen e procedurave të përcaktuara për shqyrtimin e Prokurimit, informacionet dhe të dhënat sipas llojeve të procedurave dhe aktiviteteve përkatëse të Prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka dërguar Raportin vjetor për vitin 2013 në Kuvend, i cili raport në mungesë të kryetarit dhe anëtarëve të bordit, të cilëve ju ka skaduar afati – mandati, është nënshkruar nga kryesuesi i sekretarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më datën 12.3.2014 pasi që ka diskutuar Raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013, në mungesë të kryetarit dhe anëtarëve të bordit për ta arsyetuar dhe dhënë sqarimet për përmbajtjen e raportit i rekomandon Kuvendit, që ta shqyrtojë dhe të vendosë për raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013.

Nga raporti i këtij institucioni të pavarur shohim se gjatë vitit 2013 janë pranuar 468 ankesa nga të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik i ka trajtuar vetëm 254 ankesa, çka do të thotë se 215 ankesa kanë mbetur të pashqyrtuara në mungesë të bordit, nga data 1.8.2013 deri më datën 31.12.2013 të gjitha ankesat, të cilat janë pranuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik janë shqyrtuar nga ekspertët shqyrtues meqë rast janë dhënë rekomandimet për këto ankesa, mirëpo kanë mbetur ashtu, sepse nuk kanë pasur mundësi të merret vendim më tutje nga bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka pasur një buxhet prej 304 mijë e 375 eurove, çka do të thotë se ka pasur një rritje prej 5,4% tek pozicioni i pagave dhe mëditje dhe nga këto mjete, të cilat i ka pasur në dispozicion i ka shpenzuar 261 mijë e 680 euro, çka do të thotë ka shpenzuar vetëm 71% të buxhetit.

Po ashtu, ky institucion i pavarur ka realizuar të hyra diku prej 56 mijë eurove, ku 20 mijë euro të hyra janë realizuar nga gjobat, kurse 36 mijë euro të hyra janë realizuar nga depozitat si rezultat i marrjes së vendimit për konfiskim.

Gjatë vitit 2013 nuk është ushtruar asnjë padi ndaj vendimeve të panelit shqyrtues për Gjykatën Themelore, pra në Departamentit për Çështje Administrative, kurse gjatë vitit 2013 Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktuese konform nenit 92, pika 2 të Ligjit të Prokurimit Publik, ka marrë vendim që një operator ekonomik të futet në listën e zezë që është “Euro Trade” SH.P.K. pasi që ky operator ekonomik ka ofruar dokumente, të cilat nuk kanë pasqyruar realitetin me ofertën që ka paraqitur.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar raportin, kurse Kuvendit i mbetet të marrë vendim rreth këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe do ta mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Cili në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen që e ka shqyrtuar raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka diskutuar krejt diçka tjetër.

Ne, si anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk e kemi shqyrtuar, në fakt, kemi diskutuar rreth raportit, se ky raport nuk është i aprovuar nga Bordi i drejtorëve, bord i cili ka munguar për komplet gjysmën e dytë të vitit 2013.

Andaj, propozimet e disa anëtarëve kanë qenë që raporti të mos i rekomandohet fare seancës, për shkak se nuk i plotëson kushtet elementare për t'u shqyrtuar në seancë. Mandej me propozim të kryetares së Komisionit kemi mbetur që këtë propozim, që raporti të mos shqyrtohet fare, ta hedhim në seancë dhe seanca le të vendosë.

Por sidoqoftë, nëse fjalët ndërrohen dhe vendoset që raporti sot të shqyrtohet, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është kundër këtij raporti, sepse edhe nëse shqyrtohet vetëm pjesa e gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, ne kemi vërejtje të shumta.

Kjo agjenci fare nuk po kontribuon në implementimin e drejtë të ligjit. Në fakt, krejt çka ka bërë gjatë krejt mandatit të tij dhe sigurisht se do të vazhdojë, sepse kemi pothuajse të njëjtën strukturë të njerëzve, po kontribuon në rritjen e korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Këto ditë kemi marrë raportin vjetor të punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ajo që i bie në sy lexuesit është broshura e shtypur me ngjyra, e lidhur bukur në shumicën e 84 faqeve të saj, gjysma e zbraztë.

Pra, kemi një raport me shumë ngjyra, me pak fjalë, me pak vlerësime dhe me shumë shpenzime. Kjo tregon që OSHP si institucion i pavarur nuk ia var as shtetit as taksapaguesit sa i përket shpenzimeve.

Nëse gjatë shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, ekonomikiteti dhe efikasiteti kanë qenë shkeljet më të shpeshta, OSHP nuk mund të krenohet se vet ka pasur një sjellje më ndryshe.

Fakti që Bordi i OSHP-së i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, që nga gushi i vitit të kaluar ka funksionuar vetëm me një anëtar, flet për një situatë të palakmueshme në OSHP, por edhe për plogështinë e Kuvendit për ta ndryshuar këtë situatë.

Raporti i paraqitur para Kuvendit është shumë i përgjithshëm, flet më shumë për dukuri, por nuk jep të dhëna konkrete, të cilat do të mundësonin për ta kuptuar mirë situatën.

Sa për ilustrim po theksoj, tërheqjen e 29 ankesave. Në dokumentin që kemi para nesh nuk shpjegohen arsyet e tërheqjes së ankesave, a janë tërhequr për shkak të presionit, kërcënimeve, për shkak të marrëveshjeve mes operatorëve ekonomikë apo për shkaqe të tjera.

Raporti flet për një transparencë të lartë në OSHP, por kjo nuk reflekton me të dhënat që ofron OSHP-ja, edhe pse 38% e shpenzimeve të OSHP-së kanë shkuar për paga dhe mëditje, në asnjërën prej rubrikave nuk është shënuar numri i punonjësve në këtë institucion.

Ajo që bie në sy në raport janë shërbimet kontraktuese, janë shpenzuar 25 mijë euro për shërbime intelektuale dhe këshillëdhënëse. Raporti nuk precizon kujt i janë dhënë, pse i janë dhënë dhe a kërkohen këto shërbime në mungesë të stafit profesional të OSHP-së? Shpenzimet e komunikimit të ndara në dy rubrika kapin vlerën enorme prej 9 346 eurosh. Lexuesi pa të keq mund të konkludojë se në OSHP punohet vetëm përmes telefonit.

Për karburante për vetura janë shpenzuar 6 189 euro, ndërsa për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre 7 156 euro. Raporti nuk precizon numrin e veturave për të kuptuar pse janë shpenzuar 13 345 euro për riparim, mirëmbajtje dhe karburante.

Shuma prej 7 156 eurosh për riparim dhe mirëmbajtje lë përshtypje që punonjësit e OSHP-së përdorin kryesisht “Golf-1”, gjë që unë nuk e besoj.

Vështirë për t’u kuptuar është edhe shuma për mirëmbajtjen e ndërtesave prej 5 400 eurosh, ndërsa vetë qiraja kushton vetëm 1 182 euro. Sipas raportit të buxhetit të OSHP-së është vjedhur rryma dhe uji, pasi që për kategori janë shpenzuar 0.00 euro.

Për të mos e zgjatur më shumë, pjesa e raportit për buxhetin e OSHP-së ka mungesa të dhënash, por flet edhe për shpenzime të larta dhe të paarsyetuara nga OSHP-ja.

Kërkojmë që raporti të mos miratohet, ai duhet të plotësohet me të dhëna të sakta, si për punën, ashtu edhe për shpenzimet e OSHP-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Kolegë deputetë,

Ne, Komisioni për Buxhet dhe Financa e kemi shqyrtuar në mungesë të bordit, të cilin të ishim të pranishëm, por të them të drejtën nuk kishim çka të shqyrtojmë, për arsye se nuk mund të bënim ndonjë pyetje konkrete ose rreth raportit.

Prandaj si komision kemi vendosur që t'i drejtohem seancës, mirëpo të them realisht për grupin e Aleancës është e papranueshme, për arsye se në mungesë të bordit, në mungesë të shqyrtimit vetë bordit të shumë ankesave dhe mos funksionalizimit të një fushe shumë me rëndësi, për ne është i papranueshëm ky raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne si grup parlamentar do të abstenojmë në këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Nëse e analizojmë raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit vërejmë se ky organ nuk ka arritur të kryejë punën e vet kryesore, pra t'i shqyrtojë ankesat që i kanë dorëzuar operatorët ekonomikë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, për shkak se ky organ ka qenë jofunksional, për shkak se bordi i këtij organi nuk ka qenë funksional për një kohë të gjatë.

Prandaj, kur e kemi parasysh që ky organ nuk ka mundur të kryejë punën e tij kryesore, atëherë nuk mund të themi se ky raport i plotëson të gjitha kushtet edhe për t'u shqyrtuar në Kuvend. Mirëpo, ky raport nuk i ka plotësuar kushtet të shqyrtohet as në komision, për shkak se kur e kemi parasysh faktin se raporti ka të dhëna të pakta dhe i ka vetëm disa shifra që tregon se sa raporte janë shqyrtuar, sa nuk janë shqyrtuar, nuk ofron ndonjë të dhënë tjetër.

Përkundër kësaj ne nuk kemi pasur asnjë informatë, as në Komisionin për Buxhet dhe Financa, që të marrim informatat të mëtutjeshme, për shkak se nuk ka pasur se kush të raportojë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Çështja tjetër, kur jemi te tërheqja e ankesave nga operatorët ekonomikë, janë 29 sosh prej tyre dhe në asnjë rresht të këtij raporti nuk shpjegohet, se pse këta 29 operatorë ekonomikë i kanë tërhequr ankesat, kur e kemi parasysh se këta operatorë ekonomikë i kanë paguar 500 euro për një ankesë.

Pra, ka ndodhur diçka, sepse ashtu kot nuk do t'i kishin tërhequr, apo nuk do të kishin bërë ankesë fare.

Pastaj, në këtë raport është dashur që të përfshihen edhe shkeljet e Ligjit të prokurimit, që ne kur e kemi monitoruar Ligjin për prokurimin publik kemi hasur disa nene që janë shkelur të Ligjit të prokurimit publik e këto janë, është shkelur neni 6 ekonomikiteti dhe efikasiteti, pastaj është shkelur neni 7 barazia në trajnim, jo diskriminimi, ka shkelje të nenit 10, mjetet për promovimin e transparencës, pastaj neni 27, dosja e tenderit, neni 28 specifikimet teknike, neni 59 ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Pastaj, ka shkelje të nenit 60 kriteret për dhënien e kontratës.

Të gjitha këto shkelje dhe të gjitha këto ankesa që janë bërë tregojnë për një shkallë të lartë të korrupsionit. Duke pasur parasysh se diku 50% e buxhetit shpenzohet për prokurim publik, është shqetësues fakti që nuk e kemi një raport të detajuar të shpenzimeve sa i përket projekteve kapitale.

Pra, ne zakonisht e kemi kërkuar një raport të detajuar të shpenzimeve kapitale nga Qeveria, të shohim se si janë shpenzuar ato më detajisht, mirëpo asnjëherë nuk e kemi marrë një raport të tillë.

Është shqetësues fakti, se në Kosovë kur flitet për korrupsionin është bërë normë që të pranohet si i tillë, me arsyetimin se nuk kemi fuqi ta luftojmë atë. Ka marrë tashmë përmasa shumë të mëdha, sepse vetë institucionet, më konkretisht qeveritarët që është dashur ta luftojnë atë, janë bërë pjesë e kësaj.

Nëse është kështu dhe nëse e pranon këtë si të tillë, atëherë zgjidhja është e lehtë, ta heqim Qeverinë dhe në këtë rast i largojmë të dyja së bashku, pasi që janë bërë kaq të pandashme njëra nga tjetra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjalën e ka kërkuar prapë zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë vetëm desha t'i bëj me dije edhe njëherë deputetët e nderuar, të cilët janë të pranishëm këtu, se raporti është shqyrtuar në Komisionin për Buxhet dhe financa.

Rekomandimi, i cili është pasqyruar këtu për t'u shqyrtuar është rekomandim i shumicës së anëtarëve të Komisionit, që kanë votuar që të vijë një rekomandim i tillë dhe jo i kryetares së Komisionit, kurse atë çka e kanë aprovuar shumica e anëtarëve të Komisionit në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa e kam nënshkruar unë si kryetare.

KRYESUESI: Zonja Bajrami, dy herë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues! Dy herë, dy herë, sa herë të ketë nevojë.

Nuk është e vërtetë, më vjen shumë keq, kryetare, jemi këtu anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk e di sa mundesh me e quajt shqyrtim leximin e një pjese të raportit. Nuk kemi pasur kujt t'i bëjmë pyetje, sepse asnjë anëtar i bordit nuk ka qenë i pranishëm, në fakt, bordi edhe nuk ka qenë i formuar.

Kemi marrë vendim me shumicë në Komision, që të paraqesin në seancë problemin që raporti nuk është i aprovuar prej bordit dhe seanca të vendosë që a do të shkojë në shqyrtimin e tij apo jo? Kjo është ajo çka ka vendosur Komisioni dhe kjo ka qenë javën e kaluar. Besoj, që nuk ka pas mundësi për të harruar dikush. Faleminderit!

KRYESUESI: Albana e ka fjalën edhe në herë, pastaj po shkojmë, a do Ramiz edhe ti?

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë e mbështes komplet deklaratën e parafolëses, pra ne në Komision nuk jemi marrë, nuk e kemi shqyrtuar raportin, konkretisht të Organit Shqyrtues të Prokurimit, sepse s'kemi pasur as çka të shqyrtojmë në mungesën e përfaqësuesit, aty, pra kemi vendosur që seanca të vendosë a do ta shqyrtojnë apo jo këtë raport, pasi që ky nuk është aprovuar as në Bordin e ASHP-së e as në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

KRYESUESI: Zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Është diç jo e kuptueshme kur dihet se vetë Kuvendi ka qenë në njohuri që nuk e kemi pasur Organin Shqyrtues të Prokurimit të kompletuar, ndërsa raporti është sjell dhe ky është raporti i vitit 2013. Unë mund t'ju kuptoj që s'ka pasur kujt t'i drejtohet komisioni, mirëpo në komision sipas të gjitha gjasave janë të gjitha subjektet politike dhe është dashur të jepet konkluzion, a të shqyrtohet raporti pa bord a mos të shqyrtohet hiç, të mos vjen në seancë plenare.

Komisioni si Komision FunkSIONAL duhet t'i japë rekomandimet e fundit. Në rast se ne duam të shqyrtojmë raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pa bord dhe i kemi të dhënat këtu çka janë të dhëna dhe siç shihet, këtu ka mungesë të shumë çështjeve për arsye të mungesës së bordit, atëherë është e drejtë e Kuvendit të japë vendimin çka më tutje me këtë raport të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

KRYESUESI: Zonja Hadërgjonaj e kërkoje fjalën, apo e tërhoqe? Të gjithë e morën nga dy herë, merre edhe ti si kryetare.

SAFETE HADËRGJONAJ: Zoti nënkryetar,

Unë edhe në fjalën time kur e mora në fillim, e theksova që ne kemi shqyrtuar raportin në mungesë të bordit dhe theksova që raporti na ka ardhur i nënshkruar nga sekretari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, nuk e kemi pasur bordin. Sikur të kishte qenë bordi aty, ne kishim dhënë rekomandim për miratim, ose mosmiratim të raportit.

Ne kemi dhënë rekomandim, e kemi shqyrtuar raportin, kemi diskutuar për raportin dhe rekomandimi i shumicës së anëtarëve të komisionit ka qenë që raporti të vijë në seancë

plenare dhe seanca plenare ta shqyrtojë dhe të marrë vendim në lidhje me këtë raport. Nuk është raporti i parë që po shqyrtohet në Kuvendin e Kosovës, që nuk ka bord, nuk ka pasur bord. Kemi shqyrtuar edhe raporte të tjera, të cilat nuk ka qenë bordi funksional me vite të tëra dhe ne raportet e tyre i kemi shqyrtuar, ndonjëherë i kemi miratuar, ndonjëherë s'i kemi miratuar, mirëpo në Kuvend i kemi shqyrtuar.

Dhe, do të shkojë në mënyrë të njëjtë, siç ka shkuar edhe herëve të tjera. Prandaj, s'kemi çka ta bëjmë çështje këtë çështje që s'është për t'u bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka më diskutime. Keni pasur kohë të mendoni, nga dy herë ua dhashë fjalën, tash të fjaloseni mes vete s'ka nevojë, nuk ka edhe kuorum, 52 deputetë janë, s'kemi si votojmë. E lëmë kur të bëhet kuorumi të votojmë për ose kundër.

Vazhdojmë me pikën 8, se kjo nga 2 minuta, 1 minutë diskutim nuk...

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funksional, zonjën Stafete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Në bazë të nenit 87 paragrafi 2.13 të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka për obligim t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për çdo vit për aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë.

Kështu që, ky komision rregullativ i prokurimit publik me kohë ka dorëzuar raportin e punës dhe raportin financiar, të cilin e ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 12.3.2014 dhe ka vlerësuar se raporti është në pajtim me Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe raporti financiar i përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë raport në prezencë të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, përkatësisht kryetarit të këtij Komisioni, ku ka raportuar për punën e këtij institucioni të pavarur.

Nga raporti, por edhe nga raportimi i kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. shohim se e tërë vlera që është bërë e shpenzimeve të cilat janë bërë përmes prokurimeve publike, kanë qenë diku 12,72% të bruto produktit vendor.

Nga raporti vërehet se është rritur përdorimi i procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara, që është 87,86% dhe kështu që vërehet që na viti në vit ka ardhur duke u rritur procedura e hapur e prokurimit.

Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë është zvogëluar në krahasim me vitet e kaluara, ku në vitin 2013 është përdorur vetëm 0,02%. Gjithashtu, me pjesëmarrjen e procedurës së negociuar, pas publikimit të njoftimit të kontratës është 5,60%, që do të thotë se është zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë 10%, ndërsa në vitin 2011 ka qenë 6,21%.

Nga raporti dhe nga raportimi i kryetarit të këtij organi rregullativ, vërejmë se janë monitoruar 32 autoritete kontraktuese, gjithsej sa janë planifikuar nga ky institucion dhe janë theksuar të gjitha ato nene, ku më së shumti janë vërejtur se janë bërë shkelje të procedurave gjatë prokurimit.

Po ashtu, janë bërë edhe katër monitorime të tjera me kërkesën e autoriteteve kontraktuese.

Ky institucion e ka shpenzuar buxhetin diku 90% dhe nga raporti vërejmë se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në raportin për aktivitete të Prokurimit Publik, në përgjithësi ka prezantuar informacionet duke respektuar kushtet formale të përcaktuara me Ligjin e prokurimit publik, më saktësisht nenin 87.

Janë analizuar të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë ndodhur në vitin 2013, në bazë të kontratave publike të dërguara nga autoritetet kontraktuese, janë bërë monitorimet dhe interpretimet ligjore të neneve të Ligjit të prokurimit publik dhe autoriteteve kontraktuese apo të operatorëve ekonomikë, për të rritur vetëdijen e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë mbi legjislacionin e prokurimit publik, si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e përcaktuara me këtë legjislacion, siç e parasheh ligji.

Në bazë të asaj, që është përcaktuar dhe kërkuar edhe nga Komisioni Evropian, raporte të cilat i kemi pasur, është kërkuar që të ketë po ashtu trajnime dhe përgatitje të stafit. Po ashtu, nga raporti vërejmë se edhe kjo çështje ka qenë shumë e trajtuar nga ana e këtij organi rregullativ të prokurimit publik.

Deputetët anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa iu kanë drejtuar me disa pyetje Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Në të gjitha pyetjet janë marrë sqarimet e duhura nga kryetari i Komisionit, kështu që në përfundim me shumicë votash është përkrahur ky raport dhe rekomandojmë që seanca plenare sot ta miratojë raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë raport të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013 dhe në bazë të diskutimit të cilin e ceki kryetarja e Komisionit për Buxhet e Financa, Grupi Parlamentar do të jetë pro këtij raporti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në fakt nuk është ndonjë institucion, i cili ka pasur ndonjë ndikim të madh në fushën e rregullimit të prokurimit publik, në përgjithësi në Kosovë.

KRPP-ja sipas Ligjit të prokurimit publik e ka përgjegjësinë kryesore për zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të rregullave të prokurimit.

Ky institucion mund të themi, që relativisht e ka kryer punën për të cilën është i thirrur edhe pse gjatë gjithë kohës është ankuar, përfaqësuesit e këtij institucioni se kanë kapacitete të kufizuara. E në fakt, u përmend që sipas raportit, KRPP-ja ka bërë gjithsej gjatë vitit 2013, 32 monitorime, po ajo që nuk u theksua dhe që vlen të dihet për deputetët dhe publikun, është se në çdo të dytin prokurim që është bërë monitorimi, janë gjetur shkelje.

Sikur, KRPP-ja të kishte kapacitete të mjaftueshme, sigurisht që do të ndikonte shumë në ruajtjen e Buxhetit të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës për të satën herë shpreh shqetësimin e saj se raportet e institucioneve të pavarura na diskutohen ndaras me raportet e auditorit. E keni parasysh, ne tash kemi filluar me cikël të shqyrtimit të raporteve dhe shqyrtojmë raportet, të cilat i kanë shkruar vetë këto institucione dhe askush nuk pret që këto të tregojnë për shkeljet që i kanë bërë ose për mungesën në performansën e tyre.

Ne shpresojmë shumë që në legjislacionin e ardhshëm kjo të rregullohet. Ne kemi edhe raporte të auditorit, të cilat në këtë legjislaturë i ka shqyrtuar komplet një komision tjetër dhe nuk ka pasur fije bashkëpunimi në mes të komisioneve funksionale dhe Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, i cili ka shqyrtuar raportet e auditorit.

Andaj, unë mendoj që nëse duam ta përcjellim punën e institucioneve të pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit, ne duhet që këto raporte t'i shqyrtojmë në të njëjtën kohë ose eventualisht të presim derisa të dorëzohen raportet e auditorit dhe të shohim saktësinë e të dhënave që janë paraqitur në raportet nga institucionet përkatëse.

Ne, duke marrë parasysh atë çka është shkruar në raport, i themi po këtij raporti kësaj here, por shpresojmë shumë që kjo gjë të mos përsëritet në të ardhmen, do të thotë të kemi një rregullim dhe të kemi një shqyrtim të raporteve në të njëjtën kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

U cek edhe nga parafolësja, pra problemi kryesor i këtij organi, domethënë, Komisionit Rregullativ të Prokurimit, është mungesa e kapaciteteve për të bërë monitorime të shumta dhe sigurisht që në 34 monitorime, që i kanë bërë kanë gjetur shkelje në procesin e prokurimit dhe, kjo tregon se në çfarë gjendje është prokurimi në Kosovë.

Kur flasim për prokurimin publik në Kosovë është e pamundur të mos na shkojë mendja te korrupsioni dhe mungesa e transparencës.

Kur e kemi parasysh faktin se 50% e buxhetit shpenzohet në procesin e prokurimit, është për të ardhur keq se si asnjëherë nuk e kemi pasur një raport të detajuar nga Qeveria, që të na tregojë se si janë shpenzuar paratë publike.

Kur flasim për mungesën e transparencës, katër agjenci brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, është vërtetuar se blejnë produkte të njëjta me çmime të ndryshme. Problem tjetër, është çmimi jo normalisht i ultë, si rezultat i kësaj blihen produkte që nuk hyjnë në përdorim.

Nëpër institucione publike blihen produkte, vetëm sa për të thënë se janë pajisur me mjete të nevojshme, por në të vërtetë, në shumicën e rasteve ato nuk futen në përdorim për shkak të kualitetit të dobët. Në këtë rast po dëmtohen dy herë qytetarët. Në radhë të parë për arsye se nuk po ofrohen shërbime të mira si pasojë e mungesës së mjeteve të nevojshme dhe e dyta për shkak se po dëmtohet buxheti i qytetarëve të vendit.

Duke i pasur parasysh këto rrethana për shkak të parregullsive të shumta në dhënien e tenderit, ka ankesa të shumta nga operatorët ekonomikë. Ne nuk mund të flasim për një prokurim të mirëfilltë, nuk mund të flasim për drejtësi në këtë proces për derisa vazhdon të kemi një Qeveri të padrejtë që është në shërbim të vetes e jo të qytetarëve.

Do të ishte mirë të kemi një raport të detajuar ku tregon se sa është përqindja e pjesëmarrjes së prodhuesve vendorë në procesin e prokurimit për shkak se ne nuk e dimë këtë.

Në seancën e fundit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka dorëzuar një amendament dhe është për të ardhur keq se si nuk kaloi një amendament i tillë që i favorizon prodhuesit vendorë në rast të procesit të prokurimit. Pra do të kishte qenë mirë që ne ta kemi një raport ku dikush na tregonte se sa është përqindja e prodhuesve vendorë që unë besoj se është e ulët dhe mendoj se kjo është keq. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!
Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës e ka shqyrtuar këtë raport dhe për të mos i përsëritur kolegët e këtij komisioni, mund të them lirisht që për Grupin e Aleancës problemi më i madh është që të rritet kapaciteti në këtë organ për arsye se duhet në praktikë të shohë zbatimin e kontratave. Dhe, nëse rriten kapacitetet e këtij organi me qëllim që të bëhet shikimi i mirëfilltë i zbatimit të secilës kontratë, atëherë me siguri do të kishim një perceptim më të mirë për prokurimin publik, për arsye se më tepër se gjysma e buxhetit harxhohet në këtë formë, prandaj është e metë shumë e madhe e të gjitha institucioneve me qëllim që të këtë organ, të jetë shumë funksional që ky organ të mos ketë mungesë të kuadrove dhe që ky organ me të vërtetë të bëhen kontrole më të shumta se sa që ka bërë në zbatimin e këtyre kontratave për arsye se ka një shkëputje mes njësisë, kërkesës dhe zbatimit. Këto janë problemet më të mëdha në prokurim dhe gjithashtu tek çmimi më i favorshëm ekonomik, gjithmonë çmimi më i favorshëm ekonomik nuk kuptohet çmimi më i ulët ekonomik, për arsye se nëse flitet për një lloj malli, mund të ketë mall me kualitet të lartë dhe të ulët. Prandaj gjëja që e thamë ne që është më i favorshëm ekonomik nuk do të thotë që të jetë më i lirë, por t'i plotësojë edhe kriteret tjera.

Prandaj mu me këto kritere po luhet, mu me këto kritere po keqmenaxhohet paraja publike dhe mu me këto kritere mandej prokurimi publik dhe kontratat nuk po janë të suksesshme dhe po e kemi këtë gjendje çfarë e kemi. Prandaj për Grupin e Aleancës është shumë shqetësuese që ky trup të jetë shumë funksional dhe të ketë një kontroll më të rreptë, sidomos në zbatimin e këtyre kontratave, sepse është detyra e tyre për t'i monitoruar dhe detyra e tyre për të parë se a po përfilllet ligji i prokurimit publik? Faleminderit.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi ynë Parlamentar e kemi shqyrtuar raportin dhe të njëjtin e përkrahim.

KRYETARI: Tani nuk kemi në emër të grupeve. “6+” nuk është lajmëruar. I kemi dy deputetë të lajmëruar. Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Mendoj se çështja e avancimit të prokurimit publik është një nga çështjet më të rëndësishme me të cilat duhet të merret Kuvendi shumë seriozisht. Në qoftë se prokurimi publik përfshin 15% të bruto produktit vendor dhe mbi 55% të investimeve të tërësishme, domethënë publike dhe private, do të thotë se mënyra se si zhvillohet prokurimi publik dhe mënyra se si përdoret paraja publike ka ndikim jetik në nivelin e rritjes ekonomike dhe në atmosferën e biznesit, mjedisin biznesor dhe në realizimin e konkurrencës fer.

Fakti se ne kemi një rënie të ritmit të rritjes ekonomike tri katër vjetët e fundit, fakti se investimet në sektorin privat janë duke u zvogëluar dhe fakti se edhe investimet e jashtme janë duke u zvogëluar tregon qartë se ne kemi probleme të theksuara me mjedisin

biznesor dhe se një mori e këtyre problemeve janë të ndërlidhura pikërisht me cilësinë, rregullsinë e prokurimit publik.

Auditori i Përgjithshëm në vazhdimësi tregon për problemet e shumta që kanë të bëjnë me specifikimet, që kanë të bëjnë me mbulimin e prokurimit me fonde të caktuara dhe me monitorimin. Ne e kemi raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik këtu i cili është një raport mund të them më i mirë se sa i disa organeve tjera, megjithatë edhe ky raport tregon për probleme serioze.

Ky organ ka rol kryesor që të rrisë kapacitetet e atyre që duhet ta zbatojnë prokurimin publik, të kujdeset për aprovimin e rregulloreve që e përmirësojnë prokurimin publik dhe të monitorojë.

Fatkeqësisht, ky organ nuk ka arritur që të kompletohet dhe të aftësohet që të bëjë monitorimin dhe pikërisht këtu janë problemet më të mëdha, sepse mungesa e monitorimit lidhur me zbatimin kontratave dhe lidhur me procedurat iu ka hapur rrugën shumë keqmenaxhimeve në fushën e prokurimit publik.

Këto keqmenaxhime kanë të bëjnë prej specifikimit të keq të kërkesave drejtuar ofertuesve, specifikim i cili krijon mundësi për manipulime në fazat e ndryshme të procesit të prokurimit, pastaj problemet janë me zbatimin e kontratave kur nuk shkohet, nuk ka garanci se kontrata që është bërë në bazë të një specifikimi dhe do të zbatohet deri në fund, me sasinë, cilësinë dhe standardet me të cilat është bërë specifikimi.

Dhe në qoftë se nuk kemi monitorim atëherë ne mund të dështojmë në përdorimin e mirë të parasë publike, respektivisht që paraja publike të mos arrijë qëllimet për të cilat edhe është zotuar. Dhe, vetë fakti se ne kemi probleme të shumta në këtë fushë tregon se është një çështje thelbësore e këtij Kuvendi, që të sigurojë një monitorim më të kualifikuar, më të rregullt dhe më sistematik të zbatimit të prokurimit, sepse me prokurimin, domethënë, rregullatorët ne i kemi pak a shumë të mbërthyer dhe të ndikuar politikisht, gjyqet nuk merren shumë me prokurimin dhe problemet e prokurimit, nëse edhe Kuvendi edhe Qeveria nuk nxjerrën mbi interesat e ngushta politike, atëherë nuk është çudi që ne kemi probleme të mëdha me harxhimin e parasë publike gjatë prokurimit publik dhe kemi perceptim në rritje mbi korrupsionin.

Ka shumë probleme në këtë fushë, sepse krahas me aftësimin e organeve po perfeksionohen edhe ata që u bishtnojnë organeve nëpërmjet prokurimit publik. Tash kemi dukurinë edhe të firmave që janë të ndërlidhura me grupe të caktuara të interesave të ngushta politike dhe ekonomike dhe të cilat e dominojnë procesin e prokurimit faktikisht.

Nuk është çudi që një studim rishtas që është bërë ka treguar se mbi 70% të firmave në Kosovë ose private, për firma private po flas, ose kanë rënie në punën e tyre ose kanë ngecje, stagnim, vetëm 23% kanë rritje dhe kanë rritje ato firma që marrin kontrata në prokurim publik.

Kjo është për brengosje dhe mendoj se ne nuk duhet të kalojmë kaq lehtësisht vetëm duke i trajtuar këto raporte vetëm si raporte teknike, sa mbledhje janë mbajtur, sa ankesa janë bërë, sa janë aprovuar, sa s'janë aprovuar, këto janë çështje teknike. Ne duhet të lëshohemi thellë në problemin e prokurimit publik dhe duhet të vëmë rregull, nëse duam që 55% të investimeve të japin efektet e tyre, nëse duam që 15% e produktit vendor, e vlerës së re që krijohet në Kosovë të shfrytëzohet mirë.

Prandaj Kuvendi mendoj se duhet ta vë në spikamë çështjen e kësaj. Nuk është çështja vetëm i kemi përmirësuar ligjet, është fakt që po i përmirësojmë ligjet, ka ende mungesë në ligje, por zbatimi i ligjeve, monitorimi i ligjeve, mënyra qysh e trajtojmë ne këtë punë dhe raportet qysh i trajtojmë, janë larg asaj që duhet të ketë përgjegjësi një qeveri, komisionet e Kuvendit dhe të gjithë aktorët që janë të interesuar. Sepse, fundi i fundit në qoftë se vazhdon kjo situatë ne patjetër duhet të shohim që ajo pasuri që krijohet pa meritë dhe me bishtnimin e procesit të prokurimit duhet një ditë t'i kthehet shoqërisë patjetër dhe duhet të shohim ligjet për konfiskimin e pasurisë që krijohet me parregullsi në procesin e prokurimit dhe në proceset tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Myzejene Selmani e ka fjalën, kryetare e Grupit Koalicionit për Kosovë të Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se sot diskutojmë raportin e prokurimit publik në Kosovë dhe duke marrë parasysh të gjitha raportet të cilat dalin, flasin për anën jo pozitive të raportit të prokurimit publik në Kosovë, atëherë unë këtu nuk shoh një interesim shumë të madh të deputetëve të cilët duan të diskutojnë lidhur me çështjen e prokurimit publik në Kosovë.

Në rast se e shohim raportin si të tillë, u përmend edhe nga profesori Muhamet Mustafa, më shumë mund të themi se është një raport i çështjes teknike kah dhe si janë shkuar këto kontrata. Në rast se e shohim në efekt çështjen e kontratave si shkon çështja e dhënies së kontratave, monitorimit të tyre, zbatimi i kontratës, procedurat e dhënies, atëherë më nuk mund të flasim për një raport teknik me shifra, por duhet të flasim për një raport tjetër ku pas raportit të auditimit, i cili duhet të vijë diku kah shtatori i këtij viti, atëherë mund të shohim se KRPP-ja dhe OSHP-ja a kanë qenë viza vi me ligjin apo në këto kontrata ka pasur diçka tjetër?

Presim shumë shpejt, ndoshta edhe nga vetë Qeveria duke marrë parasysh se këto raporte nuk të japin konotacion pozitiv as në organizata ndërkombëtare e as në zhvillimin më të madh të ekonomisë së Kosovës që ta sjellë një ligj të prokurimit publik të cilin e kërkojnë edhe organizatat e huaja ndërkombëtare që të shohim si po jepen këto kontrata, si po shkon zbatimi i kontratave, procedurat e dhënies së kontratave dhe besoj që pas miratimit të atij ligji që do të jetë prokurim publik online, atëherë do të shohim se a do të ketë mundësi të zbatimit të ligjit dhe sa do të ketë mundësi Auditori i Përgjithshëm të nxjerrë rekomandimet se si po zbatohet paraja publike në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. I kemi edhe 3 pika të rendit të ditës. Nëse doni e lëmë nesër, nëse doni vazhdojmë.

(Ndërhyrje: Vazhdojmë!)

Unë po marr vendim vetë, sepse s'kemi të votojmë. Po nëse jeni dakord, e kishim ndërprerë, vazhdojmë nesër në orën 10:00.

A jeni dakord?

Faleminderit! Vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

E premte, 28 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,
Meqenëse nuk paska kuorum për t'i votuar raportet që i kemi kaluar, po vazhdojmë me pikës së nëntë të raporteve dhe kur të bëhet kuorumi i votojmë. Janë vetëm 45 deputetë në sallë.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Komisioni për Integritet Evropian ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj raportuesen e Komisionit për Integritet Evropian, deputeten Deliu. Nuk qenka këtu.

Atëherë besoj që ju e keni lexuar raportin. I ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që, deri sa të vijë Blerta të na raportojë, a mund ta kalojmë në këtë pikë tjetër? As zoti Konjufca nuk qenka!

Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare, ose me përfaqësuesit. Në emër të Grupit, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë kisha propozuar që seanca të shtyhet deri në orën 14:00, meqë e dimë rastin - është masakra e Izbicës, dhe mua më kanë paralajmëruar. Për korrektësi, më kanë paralajmëruar deputetët që do të jenë atje. Arsye nuk po dua t'i cek, por është masakra e Izbicës dhe ata kanë shkuar atje. Prandaj, në orën 14:00 kthehen, unë kisha kërkuar mirëkuptim që ta shtyjmë deri atëherë, pastaj startojmë dhe jemi të gjithë dhe do të kemi kuorum.

KRYESUESI: Jo! Ne e kemi pikën 10, pasi erdhi Glauku. Mund të fillojmë ta shqyrtojmë, meqenëse nuk është Blerta. Ato që mund t'i shqyrtojmë, po i ndërrojmë, se edhe ashtu është larg ta lëmë për në orën 14:00, e kemi edhe Ligjin për zgjedhje. Tjetër gjë është në qoftë se ka problem te ligji, po raportet edhe votimet mund t'i kalojmë.

Atëherë vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës dhe po e presim Blertën në qoftë se vjen, ose e rregullojmë administrativisht.

E kalojmë pikën e nëntë dhe unë besoj që Suzan Novobërdaliu, pasi ta marrë materialin, mund ta paraqesë raportin në emër të Komisionit për Integritet Evropian.

Fillojmë me pikën dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile

Deputeti Glauk Konjufca dhe grupi i deputetëve nënshkrues e kanë prezantuar për miratim projektdeklaratën për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile.

Fjala është e deputetit Glauk Konjufca, në emër të Grupit të deputetëve nënshkrues në cilësinë e propozuesit të çështjes.

Zoti Konjufca, nënkryetar i Kuvendit, e keni fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Për të avancuar bashkëpunimin ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne na nevojitet një dokument, i cili do t'i përmbante parimet bazë të angazhimit të Shoqërisë Civile në relacion me institucionin të cilin e përfaqësojmë.

Në projektdeklaratën e bashkangjitur, Kuvendi zotohet që në mënyrë aktive të lidhet me Shoqërinë Civile, të përkrahë zhvillimin e këtij sektori si një tërësi dhe t'u ofrojë një qasje transparente në punën e komisioneve të veta organizatave dhe institucioneve të Shoqërisë Civile.

Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile është rekomanduar gjithashtu edhe nga Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2013, si dhe nga projekti i binjakëzimit.

Pas konsultimit me më tepër se 70 organizata të Shoqërisë Civile nga mbarë Kosova, ne kemi arritur ta zhvillojmë një projekt-dokument që gëzon mbështetje të fortë nga sektori i Shoqërisë Civile në Kosovë.

Në pranverën e vitit 2013, ne e kemi krijuar një grup të përbashkët punues me përfaqësues të organizatave të Shoqërisë Civile për të diskutuar për mënyrat e rritjes së

bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile në vendin tonë.

E kemi realizuar një vizitë pune në Parlamentin e Letonisë, ku jemi njoftuar me modelin e tyre të bashkëpunimit me Shoqërinë Civile, si dhe e kemi hartuar propozimin e deklaratës mbi partneritetin ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile, duke i konsultuar organizatat e Shoqërisë Civile nëpër tryeza të rrumbullakëta në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe me një konferencë qendrore në Prishtinë.

Ne mendojmë se ky propozim përfundimtar i deklaratës pasqyron interesin më të mirë të Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në Kosovë për bashkëpunim më intensiv në të ardhmen.

Ne konfirmojmë se miratimi i deklaratës së bashkangjitur nuk e obligon Kuvendin e Kosovës t'i përkrahë financiarisht organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë, por që ta krijojë legjislacionin, i cili prodhon mekanizma, të cilët duhet ta rregullojnë këtë fushë, meqenëse kjo fushë është e parregulluar në Kosovë deri tash.

Sa i përket deklaratës konkrete, ajo i përmban dhjetë pika dhe këto janë:

- Kuvendi angazhohet të rrisë pjesëmarrjen e publikut në hartimin, shqyrtimin dhe zbatimin e legjislacionit në Kuvendin e Kosovës,
- Kuvendi zotohet të avancojë bashkëpunimin ndërmjet institucionit tonë dhe Shoqërisë Civile nëpërmjet bashkëpunimit të rregullt, rritjes së shkëmbimit të informatave dhe zhvillimit të aktiviteteve në projekte të përbashkëta,
- Kuvendi e mbështet vullnetarizmin dhe aktivizimin qytetar për promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë,
- Kuvendi angazhohet ta zhvillojë një kornizë të favorshme ligjore dhe financiare, e nevojshme për zhvillimin dhe forcimin e Shoqërisë Civile në Kosovë.

Për t'i arritur këto, Kuvendi i Kosovës vendos që:

- T'i zhvillojë dhe zbatojë procedurat e nevojshme që garantojnë konsultim të publikut, përfshirë Shoqërinë Civile në punët e Kuvendit,
- Inicimin dhe shqyrtimin e legjislacionit, si dhe proceset e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij legjislacioni,
- Të krijojë projekte dhe aktivitete të përbashkëta me Shoqërinë Civile për të promovuar pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Kosovës, pra në formë të fushatave, të vetëdijesimit dhe të përfshirjes.
- Të bashkëpunojë ngushtë me Shoqërinë Civile për zgjidhjen e çështjeve lidhur me rregullimin e financimit të aktivitetit të Shoqërisë Civile për ta mbështetur zhvillimin e një sektori të fuqishëm dhe të pavarur të Shoqërisë Civile në Kosovë.
- Të organizojë të paktën një herë në vit një konferencë së bashku me Shoqërinë Civile, me qëllim të diskutimit të çështjeve strategjike të rëndësishme për zhvillimin e vendit, si dhe për të adresuar çështje të rëndësishme, të cilat lidhen me funksionimin e sektorit të Shoqërisë Civile, si dhe

- Të themelohet një grup në Kuvend i Shoqërisë Civile, i përbërë nga deputetë dhe stafi i Kuvendit, si dhe përfaqësues të ndryshëm të Shoqërisë Civile për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj deklarate.

Dhe, në fund, rregullisht ta vlerësojë bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me diskutimet. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar zoti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit nënkryetar dhe kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi shqyrtuar këtë iniciativë dhe shpesh, nuk është hera e parë, edhe herë të tjera i kemi pasur zili Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” për këtë iniciativë që e kanë marrë dhe ne e kemi pasur një diskutim, por na e kanë marrë përpara dhe ne natyrisht që tash e mbështetim gjithsesi dhe bashkëpunimi, bashkërendimi dhe koordinimi me 17 organizata joqeveritare është një lajm i mirë për Shoqërinë Civile, për shoqërinë e Kosovës në përgjithësi, edhe për modelin tonë të ndërtimit të shoqërisë së emancipuar.

Modeli i konsultuar letones i bashkëpunimit me Shoqërinë Civile është edhe kjo një nismë e mirë dhe një konsulencë e vlerësuar, sepse jo veç bashkëpunimi dhe kontraktimi i shoqërive civile letonese me Parlamentin dhe me institucionet letonese, por modeli emancipues i shoqërisë letonese është vlerësuar nga ne, dhe çka do që ne na përshtatet, na hyn në funksion, do të duhej ta merrnim nga shoqëria letonese. Hartimi, shqyrtimi dhe shkëmbimi i informatave me Shoqërinë Civile, por edhe tryeza, siç është paraparë një herë në vit, unë mendoj se është pak dhe do të propozojmë në emër të grupit dy takime, dy tryeza në vit me Shoqërinë Civile që t’i kemi bashkërisht dhe, natyrisht, të hartojmë, të shqyrtojmë, të vlerësojmë gjithçka që na vjen si ide nga Shoqëria Civile, krejt çka i begaton institucionet tona.

Tani për veten time dhe për Grupin Parlamentar është vlerësuar kjo iniciativë dhe mbështetet jashtëzakonisht me një vullnet të plotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar miratimin e deklaratës mbi partneritetin ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile. Njëkohësisht e kemi dhënë kontributin, unë si deputet i Grupit Parlamentar. Kemi marrë pjesë në hartimin e kësaj deklarate dhe njëkohësisht në pjesëmarrjen e takimit që është mbajtur ndërmjet Shoqërisë Civile, ku në mesin e 70 organizatave të shoqërisë civile, të cilat kanë mbajtur disa tryeza të rrumbullakëta për ta hartuar këtë deklaratë dhe, konsideroj se nëse kërkohet se ku është transparenca ndërmjet Shoqërisë Civile dhe një institucioni në nivel të vendit, atëherë

konsideroj që Kuvendi i Republikës së Kosovës është shumë transparent për vetë faktin që ka krijuar transparencë me praninë e Shoqërisë Civile edhe nëpër komisionet me të cilat ne hartojmë dhe shqyrtojmë ligje, e po ashtu edhe me praninë e tyre edhe në intervistat të cilat i mban Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe vlen të theksohet se intervistat e fundit të cilat kanë qenë për KPM-në, ku e pranishme në cilësinë e vëzhgimit ka qenë Shoqëria Civile.

Prandaj, konsideroj që Parlamenti i Kosovës i ka dhënë një mundësi të mirë Shoqërisë Civile që të jetë e pranishme në monitorimin edhe të ligjeve, por edhe të çështjeve tjera të cilat janë me rëndësi dhe miratimi i një deklarate të tillë për Grupin tonë Parlamentar, për LDK-në, në bazë të atyre 10 pikave, të cilat janë hartuar në bashkëpunim, duke marrë për bazë edhe përvojat e vendeve të regjionit dhe përvojat e vendeve edhe përtej regjionit, me të cilët u tha edhe nga parafolësit që kemi qenë të pranishëm dhe kemi vizituar disa vende të cilat e trajtojnë mirë Shoqërinë Civile dhe konsideroj se ndoshta institucionet tjera relevante, në këtë rast edhe Qeveria, po ashtu edhe institucionet si agjencitë e ndryshme, duhet të krijojnë hapësira më të mira për Shoqërinë Civile, në cilësinë e monitorimit, goftë të vendimeve, por njëkohësisht edhe të hartimeve të ligjeve që të jenë të pranishme.

Pra, atë që po e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta bëjnë edhe institucionet tjera, veçanërisht duhet ta bëjë edhe Qeveria e Kosovës, me të cilën, në bazë të krejt asaj që shihet deri më tani, do të thotë Shoqëria Civile nuk e ka një hapësirë të tillë në krahasim me atë që e ka krijuar Kuvendi i Republikës së Kosovës. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike në këtë rast e mbështet një deklaratë të tillë dhe i fton deputetët e Parlamentit të Kosovës që ta miratojnë këtë deklaratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Vetëvendosje” nuk është paraqitur, as AAK-ja. Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për të gjithë deputetë,

Duke marrë parasysh që në bazë të Rregullores së Kuvendit është bërë një kërkesë për miratimin e deklaratës mbi partneritetin ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile, unë do t'i bashkëngjitëm fjalimit të kolegut pak më parë, i cili tha se Kuvendi i Kosovës është në bashkëpunim shumë të mirë me Shoqërinë Civile dhe besoj që edhe në të ardhmen, Kuvendi i Kosovës, në bazë të Rregullores së vet dhe në bazë vullnetit të mirë të deputetëve dhe të Kryesisë së Kuvendit, do të jetë në viza-vijë me Shoqërinë Civile në të mirë të demokratizimit të shtetit të Kosovës dhe në të mirë të pjesëmarrjes së tyre në shumë çështje, të cilat do të jenë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Si Grup Parlamentar, Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje kësaj deklarate dhe besoj që në të ardhmen Shoqëria Civile mund të jetë ndoshta edhe më aktive në shumë çështje në të cilat ndoshta edhe opozita vetë nuk do të mund t'i theksojë, ndërsa Shoqëria Civile po. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk po flas në emër të grupit, por si deputet. Kam një sugjerim kështu që nga deputetët që janë lidhur në këtë drejtim me bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe këtë deklaratë, por i isha drejtuar edhe Shoqërisë Civile, meqë e dimë se është ajo duke e bërë një punë të mirë për demokratizimin në vend dhe ta vazhdojë këtë rrugë, por ndonjëherë po ndodhin disa probleme, për çka nuk mund të pajtohem me ta. Konkretisht unë si pjesëtar i komunitetit egjiptian shpeshherë vij në kundërshtim për shkak të disa parimeve. Shpeshherë ftohem jo si deputet i Kuvendit të Kosovës, por si një përfaqësues vetëm i një grupi etnik, ose i tri grupeve etnike: romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjve. Unë besoj që Shoqëria Civile nuk duhet të bëjë ndarje, nuk duhet të bënë getoizim, por nëse Shoqëria Civile dëshiron t'i zhvillojë të gjitha ato parime që duhen të ndodhin në demokratizim të vendit, atëherë duhet me të gjithë qytetarët e Kosovës...

Nëse bisedohet për një problem, bie fjala për shkollim, për analfabetizëm, atëherë këto probleme janë të krejt shoqërisë kosovare dhe Shoqëria Civile në këtë drejtim nuk mund të bëjë getoizim të disa komuniteteve, që vetëm me një komunitet të caktuar ose me një grup të caktuar. Shpeshherë del edhe me disa argumente dhe me disa elemente antikushetuese, sikur që është akronimi RAE, dhe nga ky vend unë i them Shoqërisë Civile që nuk ka komunitet RAE, por ka komunitete ashtu siç janë në Kushtetutën e Kosovës të përcaktuara me një nen të saktë - shqiptarë, serbë, turq, egjiptianë, romë dhe komunitete tjera.

Prandaj, shpeshherë, për përfitime edhe të veta personale të disa shoqërive civile bëjnë disa gabime që janë edhe antikushetuese, edhe antiligjore, prandaj si deputet besoj që bashkëpunimi do të ndodhë dhe duhet të ndodhë me Shoqërinë Civile dhe jemi të hapur, por të mos na sjellin më shumë dëm sesa dobi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti kryesues i seancës, zotni Haliti!

Ne e kemi përpara një deklaratë që propozohet të votohet nga Kuvendi, e që provon të krijojë partneritet në punët e veta me Shoqërinë Civile.

Është mirë të bëhet një deklaratë e tillë, meqenëse është një provë e gjithë këtyre legjislativave, e komunikimit dhe e bashkëpunimit të Kuvendit dhe Shoqërisë Civile.

Çështja është e hartimit të deklaratës. Paraprakisht, unë po j u them që unë do ta votoj këtë deklaratë, sepse s'ka kurrfarë arsye të mos votohet, veçse ajo që e paraqiti kolegu ynë Konjufca në emër të Grupit dhe të gjitha konsultimeve merrte parasysh një konsultim shumë të gjerë, edhe të grupeve, edhe të grupacioneve të Shoqërisë Civile dhe të Kuvendit.

Unë mendoj që deklarata është tepër ekstensive për shkak se më duket është e stërmunduar t'i japë rëndësi një problemi, duke u shkruar në variante. Po të merret teksti dhe të shikohet, për shembull pika e parë, është rimarrë pak e zgjeruar në pikën 5. Pika e katërt është pak e zgjeruar në pikën 6. Pika e shtatë faktikisht është pikë e tetë.

Domethënë, e kemi një tekst që do të mund të shkruhej me tri pika, se nuk do të thonë dhjetë kurrë më shumë se tri, nëse s'e kanë substancën, kështu që Kuvendi do të bashkëpunojë me Shoqërinë Civile për hartimin e ligjeve, për shqyrtim, për zbatim - krejt në rregull. Tjetra? Që do të hartojë, përpiqet të ketë legjislacion të vërtetë, të dobishëm, esencial, për statusin e Shoqërisë Civile dhe për financimin e saj, krejt kjo në rregull.

Që Kuvendi ta organizojë një tubim për të gjitha këto probleme që dalin një herë në vit, edhe kjo në rregull. Por, të krijojë organizime të tipit ekzekutiv për këto raporte, mua nuk më duket që thotë gjë puna e atij komisioni të shoqërisë e të Kuvendit, sepse po të funksionojnë këto tri pika, që i thashë se janë tri punkte të raporteve, faktikisht të tjerat krejt janë variacione.

Unë nuk do të vazhdoj më tutje, por po them - të gjitha këto probleme do të mund të dendësoheshin, të gjitha këto substanca të raporteve në tri-katër pika funksionalisht. Ky ishte qëndrimi im, si deputet. Unë do t'i votoj edhe në këtë formë, por po them pjesa tjetër është variacione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu-Kodra e ka fjalën!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Po e them që në fillim se vota ime do të shkojë pro kësaj deklaratë dhe e mirëpres miratimin e kësaj deklarate mbi partneritetin ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile për shkak se besoj që do të ndikojë në rritje të transparencës dhe të llogaridhënies, aq më tepër që një partneritet i tillë është kërkuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën në vitin 2013, në të cilin konsultimet dhe dëgjimet publike me Shoqërinë Civile dhe me ekspertë të pavarur për përgatitje të legjislacionit të ri kanë marrë edhe vlerësimet pozitive.

Kështu që në planin e veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit thuhet se ka hapa konkretë në hapjen e një pozite për zyrtarë për marrëdhënie me Shoqërinë Civile, si dhe në koordinim të donatorëve. Këtu është fjala për Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, kur jemi te ky partneritet po e përmend edhe strategjinë e Qeverisë dhe Planin e Veprimit mbi bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2013-2017, që është përgatitur me përfshirje të Shoqërisë Civile dhe është aprovuar nga Qeveria, e që për qëllim kryesor ka realizimin e konsultimeve publike me Shoqërinë Civile.

Pastaj po e përmend këtu edhe përfshirjen e Shoqërisë Civile në task-forcën për integrim evropian, në Këshillin Kombëtar për Integrim, si dhe përfshirjen e fundit të Shoqërisë Civile në Këshillin kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, të kryesuar nga Presidentja e vendit.

Mendoj se të gjithë këta mekanizma e bëjnë më të lehtë funksionimin e demokracisë, prandaj si të tillë e përkrah partneritetin ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Kuvendit të Kosovës dhe vota ime do të shkojë pro.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, nuk kemi as kuorum për të votuar. Kur të bëhet kuorumi, e votojmë.

I kthehem pikës së nëntë, meqë ka ardhur edhe Blerta si raportuese e Komisionit për Integritet Evropian, që është:

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Komisioni për Integritet Evropian e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zonjën Blerta Deliu-Kodra për arsyetimin e raportit me rekomandime.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ashtu siç u tha edhe më herët, Komisioni për Integritet Evropian, në pajtim me obligimet e parapara me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji komisioni ka realizuar disa vizita në institucionet përkatëse dhe qysh në fillim unë dua të bëj një falënderim për anëtarët e komisionit, të cilët e kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë gjatë monitorimit të Ligjit për ripranim.

Komisioni e ka hartuar raportin për të gjeturat faktike që u është dorëzuar të gjithë deputetëve dhe propozon disa rekomandime për institucionet që e kanë për obligim zbatimin e këtij ligji, siç vijon.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se ju i keni pasur në postë të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni për Integritet Evropian për zbatimin e Ligjit për ripranim dhe më lejoni t'i lexoj disa nga rekomandimet që ne i kemi nxjerrë si komision, e që kanë për qëllim funksionalizimin e ligjit për ripranim.

Koordinimi dhe bashkëpunimi më i mirë i aktiviteteve ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, të Administratës së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Arsimit, të Financave dhe palëve të tjera në këtë proces me qëllim të ri integritetit të qëndrueshëm të personave të riadhesuar.

Përsheptimi i procedimit të kërkesave për përafrim nga Fondi për ri integritet dhe menaxhim më i mirë i këtij fondi, organizimi i fushatave vetëdijesuese për të drejtat e të riadhesuarve, informimi i qytetarëve të riadhesuar nëpërmjet fushatave të vetëdijesimit lidhur me domosdoshmërinë e nënshkrimit të marrëveshjeve të ri pranimit ndërmjet Republikës së Kosovës, si dhe shteteve të tjera si një prej kushteve që buron edhe nga udhërrëfytyrja për liberalizimin e vizave.

Rekomandimi i pestë është që Zyra pritëse e ri pranimit të jetë më afër Zyrës së Policisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Të thjeshtohen procedurat e aplikimit dhe zgjatja e afatit për aplikim për të përfituar nga programi për ri integrim nga gjashtë muaj në një vit, të koordinohen bashkëpunimi më i madh ndërmjet Zyrës së ripranimit në Aeroport, si dhe zyrave komunale për kthim dhe komunitete në nivelin e vendit. Zyrtarët e zyrave komunale të kthimit dhe komunitetet të vizitojnë familjet e riatdhesuara në mënyrë që të regjistrohen në Fondin e programit për integrim.

Ministria e Punëve të Brendshme të kërkojë nga shtetet, nga të cilat, do të thotë, ri pranon shtetasit tanë, që rastet me sëmundje të rënda shëndetësore të mos riatdhesohen. Është ky rekomandim për shkak se ne kemi pasur një rast ku do të thotë një i riatdhesuar është kthyer në Kosovë në gjendje kome dhe ky ka dalë do të thotë si rekomandim që ligji të jetë i zbatueshëm.

Prandaj, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 11.3.2014 ka vendosur që Kuvendi do t’ia paraqesë për miratim raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e Ligjit për ri pranim.

Unë kërkoj nga deputetët që t’i japim një miratim do të thotë këtij monitorimi të zbatimit të Ligjit për ri pranim në mënyrë që të ndikojmë që ligji të jetë sa më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i PDK-së, po besoj Blerta ose Haliti u paraqit. E ka kryer Blerta. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së zonja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi punues i krijuar nga Komisioni për Integritet Evropianë përgjatë një viti e ka monitoruar zbatimin e Ligjit për ripranim, një ligj i cili lidhet drejtpërdrejt me procesin e liberalizimit të vizave.

Pasi është kusht i BE-së për këtë proces, ri pranimi i personave të larguar nga Kosova nuk është një proces i thjeshtë pasi ata duhet që përveç një deklarate të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës se i pranojnë, ajo duhet të marrë përsipër rehabilitimin e tyre dhe akomodimin e tyre në jetën e përditshme.

Gjatë këtij viti, grupi punues ka zhvilluar disa vizita në institucionet përkatëse, si dhe ka kontaktuar me persona të ri pranuar. Ashtu sikur është paraqitur në raport, janë parë disa mangësi në zbatimin e ligjit, edhe pse vetë ligji është i mirë dhe është i zbatueshëm. Pra, nuk ka nevojë të ndryshohet, por nevojitet të zbatohet dhe për këtë ka nevojë për vullnet.

Janë një sërë institucioneve që duhet t’i bashkërendojnë veprimet që ky ligj të funksionojë dhe grupi punues ka konstatuar se bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve nuk është shumë i mirë. Ministria e Brendshme është bartësja kryesore e procesit, por edhe

komunat kanë barrën e tyre. Fondi i ndarë nga Qeveria e Kosovës prej 5 milionësh për këtë problem ka filluar të përdoret për projekte, por jo gjithmonë në mënyrë efikase.

Çdo vit në Kosovë janë kthyer nga rreth 5 mijë persona, qytetarët e kthyer apo të ri pranuar përballen me një sërë problemesh, si ato të akomodimit deri tek papunësia e cila për hir të së vërtetës është një problem që e vuajnë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Grupi punues ka konstatuar se procedurat e ri pranimi vazhdojnë të mbeten të komplikuar për të kthyerit dhe po kështu kanë nevojë për një vetëdijesim më të lartë apo për një informim më dinamik.

Rastet kur të njëjtit qytetarë të rikthyer në vendet e BE-së kanë ndërmarrë sërish rrugën për të shkuar në ato vende dhe sërish janë rikthyer, nuk mungojnë. Siç e dini të gjithë, janë me mijëra qytetarë të Kosovës që po shkojnë në mënyrë të paligjshme në Evropë dhe qëndrojnë atje në kushte mjerane nëpër kampe.

Gjendja në fakt është alarmante, sepse sipas të dhënave të Euro statit 20 mijë e 245 persona kanë aplikuar për azil në vendet e Bashkimit Evropian, vetëm gjatë vitit 2013. Në fakt Kosova është renditur në mesin e 10 vendeve që më së shumti e kanë kërkuar azil krahas atyre vendeve që janë prekur nga lufta, si Siria, Afganistani, Iraku, Irani, Somalia, Nigeria, Bangladeshi etj.

Krahasuar me vitin 2012 ku numri i azilkërkuesve ishte rreth 10 mijë dhe në vitin 2011 rreth 9 mijë, në fakt kemi një dyfishim të numrit. Kjo situatë flet për gjendjen e rëndë që po jetojnë qytetarët e Kosovës, sepse me mijëra të rinj po ia mësyjnë Evropës, vendeve të Evropës, kërkojnë azil, shkojnë nëpërmjet rrugëve ilegale për shkak se këtu nuk gjejnë perspektivë.

Siç e thashë, procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën është i lidhur drejtpërdrejt me çështjen e ri pranimi, me çështjen e azilit, e kërkesave për azil, i cili sa më i lartë të jetë aq më shumë do të bëhet pengesë për procesin e liberalizimit të vizave.

Në fakt procesi i liberalizimit të vizave po duket se ka dështuar krejtësisht dhe për këtë fajtor kryesor është Qeveria. Për sa i përket raportit mund të them që ne e mbështesim këtë raport dhe të gjitha rekomandimet që burojnë prej tij dhe të gjitha rekomandimet janë të harmonizuara në grupin punues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, zonja Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Në raport është përshkruar puna e grupit punues, kemi dhënë rekomandimet e duhura, ne do ta përkrahim këtë raport dhe rekomandimet e paraqitura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Edhe vetë kohëve të fundit i jam bashkuar këtij grupi punues i cili e ka pasur nën mbikëqyrje zbatimin e Ligjit për ri pranim dhe në njërën prej vizitave që kemi pasur në Zyrën për ri pranim në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”

gjëja kryesore që më ka rënë në sy ka qenë që personat e ri pranuar mendoj që kanë qenë të painformuar sa duhet lidhur me procedurat e ri pranim, të drejtat e tyre se çka u takon atyre në Kosovë dhe mekanizmat e procedurat përmes të cilave duhet të arrihen këto të drejta dhe ato që atyre u takojnë.

Mirëpo, më duket ky një raport i përpiluar në mënyrë profesionale dhe që përshkruan saktësisht atë punë që e ka bërë ky grup dhe ajo që është më e rëndësishmja ka të bëjë me nëntë rekomandimet e listuara këtu, të cilat duhet t’i kenë parasysh institucionet kompetente në mënyrë që t’i realizojnë ato.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë do të përpiqem t’i shkëpus disa preokupime të mia që i fokuson Ligji për ri pranim.

Është një materie që trajton një pjesë të plagëve të shoqërisë tonë e cila lëngon ende nga pasojat e mëhershme. Dhe, këtu do të duhej të ishim jashtëzakonisht serioz në trajtimin e kësaj çështje që nga Komisioni këtu e deri te institucionet përkatëse, të cilat janë më relevancë dhe me kompetencë dhe pastaj deri edhe te shoqëria civile, të cilën e trajtuam më herët.

Edhe natyrisht se e trajtuam edhe temën e mëhershme të shoqërisë civile jashtëzakonisht mirë, në të cilën nuk desha të zgjerohem, sepse vërtet e shoh figurativisht si një figurë sokratiane e cila ligjëron, jep këshilla, sugjerime dhe natyrisht që e ka pastaj edhe trajtimin ndoshta jo pikërisht sikur që e kanë trajtuar këtë figurë në kohën e tij, por natyrisht në qoftë se do të mungojë një deklaratë dhe një marrëdhënie kontraktore siç e parashikuam, nuk do ta luajë funksionin e vet.

Ndërsa, në këtë temën tjetër tani edhe institucionet edhe shoqëria civile do të duhej të ishin më aktive dhe më të afërta me materien e këtij ligji, për arsye se shoqëria jonë ende nuk është në gjendje t’i akomodojë, t’i rikthejë, pavarësisht përpjekjeve tiranike që i bën Qeveria me ministrinë përkatëse dhe t’ju krijojë kushte të gjithë azilkërkuesve për ri pranim dhe riatdhesim, këtu.

Por, edhe shoqëritë evropiane duhet të kenë mirëkuptimin për tranzicionin, të cilin neve po e kalojmë dhe për një moment të mos marrin masa dhe hapa drastik dhe të shpejtë që t’i rikthejë këta njerëz të cilët janë në rrugëkryq të jetës dhe në hall të pazgjidhur, por edhe pa zgjedhje, sepse atje janë përcaktuar, kanë zgjedhur shoqërinë evropiane, shtetet përkatëse atje, natyrisht edhe ata ende nuk i kanë akomoduar dhe nuk i kanë pranuar për kohë të gjatë, iu kanë ofruar strehim të përkohshëm.

Por, kjo çështje dhe ky problem nuk do të duhej të ndikojë edhe në liberalizimin e vizave. Liberalizimi i vizave do të duhej të ndodhë sa më shpejtë, ai akt i mirëpritur dhe i shumëpritur, do ta pengojë pastaj edhe kërkimin e azilit. Pastaj, do të duhej të ndërrojë edhe procedura e azilit, në qoftë se do të lejohej edhe do të krijohen kushtet për liberalizimin e vizave, të ndalohet edhe procesi i azil kërkimit, absolutisht dhe pastaj shoqëria jonë, shoqëria do të ndeshej ndryshe me këtë problem.

Por, sidoqoftë unë për veten time edhe njëherë do të apeloja te institucionet përkatëse, te komisionet përkatëse që ky ligj le të bëhet, por në të njëjtën kohë të apelohej te shtetet përkatëse ku ka azil kërkues që t'i trajtojnë dhe edhe shoqëria civile, por edhe përfaqësuesit e institucioneve tona, t'i vizitojnë këta azil kërkues dhe të mos vazhdojë trajtimi i tyre siç përshkruhet në kushte të këqija, nëpër kampe, pa trajtim adekuat.

Dhe, nuk është asgjë keq që të insistohet absolutisht as nuk e nxit ikjen e njerëzve edhe trajtimi i tyre atje, nuk i josh të tjerët këtu që të shkojnë, por është në dinjitetin e të drejtave të tyre edhe në dinjitetin e nevojave të tyre për jetë të dinjitetshme që ata të trajtohen ashtu siç e meritojnë dhe siç kanë nevojë brenda 24-orëshit, jo të flenë rrugëve dhe jo të vuajnë për kafshatë buke. Të paktën në qoftë se s'mund t'u sigurohen kushte pune, t'u sigurohen kushte jetese adekuate me nevojat e tyre në nivel vendi ku ata janë paraqitur.

Unë për veten time nuk jam për t'i kthyer ata siç kam dëgjuar edhe siç kam parë iniciativa edhe vendime edhe qëndrime të shteteve përkatëse ku kanë kërkuar azil qytetarët tanë, por jam për t'i trajtuar përkohësisht edhe për një kohë në këtë mënyrë siç edhe janë duke u trajtuar, por me kushte edhe më të mira siç i kanë tani. Kaq desha të inkuadrohem në këtë temë dhe desha të jap një opinion timin duke i shprehur këto shqetësime të cilat natyrisht që nuk i kam pasur shumë të përmbledhura edhe nuk i kam pasur të stivuara për arsye se nuk ka qenë e fushës sime kjo materie e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Skënder Hyseni.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetë zbatimi i Ligjit për ri pranim po edhe çështja e ri pranimit si e tillë në tërësi është çështje shumë delikate dhe shumë dimensionale dhe është pothuajse e pamundshme që të bëhet analiza më e saktë dhe të jepet trajtimi më meritues i duhur, sepse vetë azilkërkimi nga Kosova dhe me këtë edhe ripranimi janë të veçanta, janë pak më komplekse se që është azilkërkimi si dukuri nga shtetet tjera me status plotësisht të konsoliduar ndërkombëtar.

Prandaj, edhe konsekuencat e një veprimi ose tjetri janë shumë dimensionale, qofshin ato konsekuenca pozitive, qofshin negative.

Pse ka numër të madh të azilkërkuesve nga Kosova, kryesisht në shtetet e Evropës Perëndimore? Nuk është vështirë të japim përgjigje në këtë pyetje. Numri i madh i azilkërkuesve është në rend të parë pasojë e gjendjes dhe mundësive tej mase të reduktuar

dhe të kufizuara për punë dhe prosperim në Kosovë dhe për këtë përgjegjëse ekskluzive është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pastaj, një arsye tjetër që është pak më shumë e natyrës psikologjike është vrapi pas asaj, që shpeshherë përcillet në mënyrë artificiale, si jetë idilike në Perëndim dhe për fatin e keq të shumë azilkërkuesve, në momentin e parë të takimit me ato sfida ndodh dhe fillon ai procesi i deziluzionimit të azilkërkuesve potencialë.

Zbatimi konsekuent i Ligjit për pranim është thelbësor edhe në rrafshin e liberalizimit të vizave, që është aq shumë e nevojshme për kosovarët. Dhe, këtu nuk duhet të ketë absolutisht ngathtësi as ngadalësim, Qeveria duhet të jetë e rreptë në zbatimin e këtij ligji, sepse duke e zbatuar si duhet dhe me përpikëri dërgohet një mesazh shumë pozitiv dhe inkurajues për arritjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Në të njëjtën kohë, nuk është e tepërt të bëhet apel nga ky Kuvend te qytetarët e Republikës së Kosovës, që të jenë të kujdesshëm edhe ata të bartin një pjesë të përgjegjësisë, sa i përket mesazhit që dërgohet duke bërë kërkesa për azil dosido, shkel e shko dhe shpeshherë pa nevojë. Prandaj, është shumë e nevojshme që barra e përgjegjësisë për t'i plotësuar kriteret dhe standardet për liberalizim të bartet deri në nivelet më të ulëta të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhafer Tahiri e ka fjalën.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kosova, për fat të keq dhe qytetarët e saj vazhdojnë të mbeten qytetarët më të izoluar të rajonit. Është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit i cili ende nuk ka liberalizim të vizave dhe qytetarët e Kosovës, përveç Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në fakt nuk mund të lëvizin më tutje me pasaportat e Kosovës, si pasojë e mungesës së liberalizimit të vizave.

Pa diskutim që në rrugën drejt integritimeve evropiane liberalizimi i vizave është hapi i parë që do të mundësonte lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës nëpër gjithë Evropën. Unë konsideroj që është e domosdoshme që të gjithë qytetarëve të Kosovës, por edhe studentëve, sidomos, sa më parë t'u mundësohet që të lëvizin lirshëm dhe të gëzojnë një të drejtë elementare që e kanë të gjithë qytetarët e Evropës.

Sigurisht që në këtë proces të liberalizimit të vizave zbatimi me përpikëri i dispozitave të Ligjit për ri pranimin e personave të cilëve u është refuzuar azili në vendet e Bashkimit Evropian, është qenësor.

Prandaj, edhe këtu duhet të kihet vëmendje shumë e madhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, por edhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që këta persona të marrin trajtimin adekuat në rastin e kthimit të tyre në Kosovë. Në fakt, këta persona janë fatkeq dy herë, një herë, sepse janë të thjeshtë e kanë të pamundur që të gjejnë një vend pune në Kosovë dhe të prosperojnë dhe synojnë që të ndërtojnë një jetë më të mirë në Evropë dhe, kur këtë ata prapë nuk arrijnë ta realizojnë përmes azilit, ata ballafaqohen me

probleme edhe më të mëdha, kur kthehen në Kosovë. Sepse, thjesht, procedura e riintegritit të tyre është shpeshherë e komplikuar, ashtu qysh vërehet edhe nga ky raport i Komisionit dhe kjo përbën edhe një cenim të të drejtave të tyre njerëzore.

Dua të rikujtoj këtu dhe e shoh që në raport nuk është përmendur dhe uroj që të jetë zgjidhur njëherë e mirë, çështja e skandalit që ka qenë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me tenderin për akomodimin e personave të riatdhesuar, i cili ka qenë në vitin 2011 dhe vitin 2012. Dhe, unë nuk e shoh që ka zënë vend në raportin e Komisionit dhe uroj që Komisioni të mos ketë gjetur shkelje në këto aspekte. Por, nga ajo që kemi parë nga kronikat e shumta edhe radio-televizive, të sfidave me të cilat ballafaqohen personat e riatdhesuar, mendoj se kjo sfidë vazhdon të mbetet për këta qytetarë, prandaj edhe ky aspekt do të duhej të zinte vend në këtë raport.

Sidoqoftë, unë do ta përkrah raportin dhe rekomandimet dhe uroj që këto të zbatohen në përpikëri në favor të të drejtave të këtyre qytetarëve, por edhe në drejtim të liberalizimit të vizave dhe mundësimit të lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Konstatoj që edhe pika nëntë nuk mund të votohet, për shkak se s'ka kuorum. Janë 34 deputetë.

Sa i përket pikës 11 që është tejet e rëndësishme për t'u diskutuar dhe për të vendosur e për ta miratuar, që është Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, besoj që nuk do të duhej për të hyrë në debat, meqenëse janë kaq pak deputetë në sallë.

(Debat nga sala.)

Si? Nuk ka deputetë dhe unë mendoj, që duhet shtyrë këtë punë.

SABRI HAMITI: Deputetë ka...

KRYESUESI: Po, s'janë në sallë. Pa paragjykuar as prejudikuar, për asnjë, unë duhet të vendos që seanca të shtyhet për një ditë tjetër, kur Kryesia vendos, bashkë me shefat e grupeve parlamentare. Është çështje, e cila duhet të vendoset. Faleminderit!

Mirupafshim!

* * *

E enjte, 3 prill

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 mars

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 27 mars 2014. Pasi në sallë nuk e kemi kuorumin e mjaftueshëm, vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës për seancën në vazhdim:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me vendimet e Kuvendit, datë 31 janar 2014, e ka hartuar Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Qeveria e Kosovës brenda afatit të përcaktuar ia ka dërguar Kuvendit vendimin lidhur me Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kryetari i Komisionit nuk është këtu. Kush e do fjalën në emër të komisionit. A është dikush prej zëvendësit të kryetarit të komisionit që e merr fjalën për të raportuar? Atëherë, shkojmë sipas grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep përkrahje parimore miratimit të Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Ne jemi të vetëdijshëm se ky ligj nuk e promovon një reformë substanciale zgjedhore çfarë Kosova ka pasur nevojë. Kemi qenë pjesë e procesit në mënyrë të veçantë, kontribut të veçantë kemi dhënë në Komisionin e Ligjeve.

Ndryshimet që i përmban ky ligj më tepër merren me administrimin e procesit zgjedhor se sa me sistemin zgjedhor për shkak se sistemi zgjedhor ka ngelur pothuajse i njëjti, shtyllat kryesore të sistemit zgjedhor mbeten të pandryshueshme.

Kosova do të vazhdojë të mbetet një njësi e vetme zgjedhore. Sistemi zgjedhor do të jetë sistem proporcional, do të jetë sistem me lista të hapura, dhe këto shtylla po mbeten të pandryshuara, sepse në Komisionin Parlamentar asnjë parti politike nuk ka pasur vullnet apo iniciativë për ta bërë një reformë substanciale në këtë drejtim.

Një varg ndryshimesh që janë propozuar, ne mendojmë se i rregullojnë disa segmente të administrimit të procesit zgjedhor, duke e bërë një proces më efikas, më azhur dhe u

ndihmojnë përpjekjeve për një proces shumë më të rregullt, shumë më efikas zgjedhor, dhe këto ndryshime paraqesin përmirësim të kornizës ligjore në raport me zgjedhjet e kaluara.

Por, siç e kemi të gjithë të qartë, për të mbajtur zgjedhje të mira nuk mjafton vetëm ligji i mirë.

Ne e kemi dhënë një provim në zgjedhjet e kaluara lokale. E kemi ndërtuar një standard të munguar dhe mendoj që Kosova duhet të përgatitet edhe në segmente të tjera, jo vetëm tek ligji, për të promovuar zgjedhje të mira nacionale me integritet territorial.

Kanë mbetur disa çështje për të cilat Parlamenti do të diskutojë ndërmjet dy leximeve. Do të ketë nevojë për një amendamentim në leximin e dytë në Komisionin e Ligjeve. Janë disa çështje për të cilat edhe në opinion ka pasur shqetësime.

Ne nuk kemi shkuar me më shumë amendamente, apo me kundër-argumente në Komisionin Legjislativ. Por, seanca do të vendosë për 3-4 çështje për të cilat ka ende edhe debate. Bëhet fjalë për numrin e kandidatëve që do të votohen dhe për cilësinë e bartësit të listës, a do të jetë edhe ai i votuar, apo do të jetë i nominuar sipas subjektit politik.

Pastaj, janë edhe çështjet e numrit të votave, një çështje që mendoj se Parlamenti duhet të fokusohet ndërmjet debateve. Komisioni për Ligje e ka propozuar një reformë në këtë drejtim sa i përket numrit të votave, sepse është propozuar që votat për kandidatë që kanë qenë dhe elementi që më së shumti i ka vënë në pyetje zgjedhjet në mandatin e kaluar të votohen në qendrat regjionale të votimit, apo në qendrën nacionale të votimit. Këtë çështje mbetet që partitë politike ta definojnë midis dy leximeve, në mënyrë që Komisioni i Ligjeve me rastin e leximit të dytë të marrë qëndrim final për 2-3 segmente, të cilat ende nuk e kanë marrë një formë finale.

Gjithashtu ne kemi promovuar disa ndryshime në ligj, të cilat do të azhurnojnë numrin e rezultateve, do ta modernizojnë procesin elektorale në KQZ, me mundësinë e digjitalizimit të votimit elektronik, në mënyrë që transparenca të rritet plotësisht.

Po e përfundoj me konstatimin final që Partia Demokratike i jep përkrahje parimore këtij versionit të projektligjit dhe angazhohet që ndërmjet dy leximeve të ndërtohet një konsensus sa më i gjerë, në mënyrë që ky ligj të votohet me kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, Arben Gashi. Urdhëro Arben, e ke fjalën. Tani jemi duke i prezantuar qëndrimet e grupeve, e jo ato individuale të deputetëve.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar me kujdes Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe konstaton se ky ligj teknikisht mund të procedohet dhe bile është dashur të procedohet më herët.

Jemi të vetëdijshëm se disa çështje janë çështje akoma që mund të jenë në diskutim, siç është çështja e bartësit të listës dhe siç janë disa çështje tjera teknike sa i përket pragut për individ, apo për kandidatë të pavarur, por edhe çështje tjera që kanë të bëjnë edhe me çështjen e përkatësisë gjinore në Komisionin Qendror Zgjedhor dhe në sistemin vëzhgues.

Por, po ashtu jemi të vetëdijshëm se mund të ketë edhe ndonjë lëshim teknik, i cili mund të përmirësohet, por, në përgjithësi, kriteret formale i plotëson dhe besojmë që duhet të shkojmë në nivelin tjetër dhe sa më shpejt të krijohen kushtet që vendi të shkojë në zgjedhje të lira dhe demokratike dhe ky ligj të kalojë.

Mendoj që jemi vonuar shumë për disa arsye. Deri më tani Grupi Parlamentar ose strukturat e Partisë Demokratike e kanë bllokuar sistemin kohëve të fundit dhe kemi parë në seancën e fundit që s'kanë pasur vullnet që të kalojë. Por, duhet të kalojë patjetër dhe ta kemi një situatë, kur vendi do të shkojë në zgjedhje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

E para, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” shpreh shqetësimin për futjen e dispozitave në mënyrë tinëzare, dispozita për të cilat nuk ka vendim komisioni, pasi as nuk janë debatuar fare në mbledhjen e komisionit.

Pra, është fjala për nenin 108b, për formulën e ndarjes së ulëseve në Kuvend, e që në mënyrë tinëzare është ndërruar formula për ndarjen e ulëseve nga ajo që është aktualisht dhe ky është kontrabandim.

Madje, kërkojmë nga kryetari i Kuvendit që t'i marrë të gjitha masat karshi kësaj, sepse ky është tentim për degradim të Kuvendit dhe procedurave të parapara me Rregulloren, vetëm e vetëm për t'i akomoduar apetitet e PDK-së dhe të LDK-së.

Edhe pse ky projektligj po shqyrtohet pas tre vjetëve nga marrëveshja antikushtetuese dhe jashtinstitucionale, është larg ndryshimeve përmbajtjesore. Pra, tashmë po dëshmohej ajo që përherë e kemi thënë se nuk ka reformë zgjedhore dhe nuk do të ketë për shkak se nuk ka vullnet politik për të bërë reformë zgjedhore dhe ky është vetëm një ndryshim kozmetik i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Madje, në disa raste, sikur te neni 104, ku thuhet se vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik, kjo dispozitë është edhe më e keqe se sa që është në ligjin në fuqi.

Pra, ky ndryshim për ne është i papranueshëm, e përveçse nuk është demokratik, edhe e thellon pabarazinë ndërmjet kandidatëve në listë dhe si i tillë duhet hequr.

Më tutje, në nenin 36.2 thuhet: “Qytetari me të drejtë vote mund të kërkojë që të hedh votën fizikisht në Kosovë në ditën e zgjedhjeve në një tjetër vendvotim”.

Ky nen me dy paragrafë është i paqartë dhe i pazbatueshëm dhe nëse mbetet si i tillë nënkupton votimin me kusht, ndërsa ne kemi rënë dakord për ta hequr votimin me kusht. Nuk mund që në ditën e zgjedhjeve dikush ta hedhë votën në një tjetër vendvotim pa e pasur emrin në listën e votuesve të atij vendvotimi. Pra, ky nen si i tillë krijon mundësi për votim të dyfishtë dhe nëpërmjet tij po na rikthehet vota me kusht, por tashmë në mënyrë të tërthortë.

Në nenin 37 parashihet lista e votuesve. E drejta për të votuar sipas Kushtetutës dhe Ligjit për shtetësinë ndërlidhet me të qenët shtetas i Republikës së Kosovës dhe duke poseduar dokumente të vlefshme të Republikës së Kosovës. Mirëpo, fatkeqësisht janë bërë shumë pazarllëqe politike të cilat kanë sjellë deri te një listë e tillë e votuesve, e cila, përveç se ka shumë pasaktësi, është edhe kundër kushtetuese.

Andaj, propozimi ynë është që lista e votuesve ta përmbajë ekstraktin e fundit në dispozicion nga regjistri i shtetasve të të gjithë personave me të drejtë vote sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe të cilët posedojnë dokumente të Republikës së Kosovës, që e dëshmojnë pra shtetësinë sipas Ligjit mbi shtetësinë.

Një veprim i tillë do ta pastronte listën e votuesve nga rreth 50 mijë emra të personave të vdekur dhe mbi 300 mijë persona që janë regjistruar në vitet e para të Administratës së UNMIK-ut pa i plotësuar fare kriteret dhe që asnjëherë nuk e kanë ripërtërirë regjistrimin, si dhe mijëra emra të personave të tjerë, që për arsye të kufizimit të dyshtetësisë janë detyruar të heqin dorë nga njëra shtetësi, por që nuk janë pasivizuar nga regjistri civil.

Në draftin që po e shqyrtojmë, neni 93, si dokument i vlefshëm vazhdon të mbetet ai i kartës së refugjatit, e që nuk lëshohen as nga institucionet tona dhe si të tilla janë në kundërshtim të plotë me çfarëdo praktike dhe procedure, andaj të gjitha këto maskarallëqe duhet hequr sa më parë nga ky draft, pasi vazhdimi i tyre do të thotë vazhdimi i përpjekjeve për të manipuluar me vullnetin dhe votën e qytetarëve.

Ky ndryshim pra do ta parandalonte edhe KQZ-në që të fusë në listën e votuesve persona pa dokumente të Republikës, ashtu siç bëri në zgjedhjet lokale, duke i futur në listën e votuesve 20 000 serbë, të cilët fare nuk posedojnë dokumente të Republikës, e si pasojë e kësaj u zgjodhën 9 kryetarë nga lista serbe e Daçiqit, të cilat po e luftojnë aktivisht shtetin e Kosovës.

Çështje tjetër gjithashtu e rëndësishme vazhdon të mbetet edhe procesi i numërimit të votave. Dihet tashmë nga të gjithë se vjedhja dhe manipulimi industrial i votave në zgjedhjet e vitit 2010, duke votuar mbi 120% në vendvotimet e caktuara dhe mbushja e kutive të votimit kanë ndodhur në mënyrë të organizuar, si gjatë procesit të votimit, ashtu edhe gjatë numërimit të rezultateve.

Pra, kur manipuluesit nuk kishin arritur të vjedhin mjaftueshëm gjatë votimit, kujdeseshin që manipulimin e rezultateve ta bënin edhe nëpërmjet numërimit të fletëvotimeve. Manipulimi dhe ndërhyrja në rezultate kanë ndodhur duke u shtuar vota si subjekteve politike të caktuara, po ashtu dhe kandidatëve të tyre. Prandaj, si rrjedhojë, edhe sot

brenda këtij Kuvendi dhe kësaj legjislature kemi deputetë që kanë ardhur pikërisht nga një manipulim i tillë i zgjedhjeve.

Përkthimi i saktë i vullnetit të votuesve në përfaqësues është funksioni themelor i zgjedhjeve me integritet, ndërsa për ta bërë të mundur një gjë të tillë duhet t'i marrim masat e domosdoshme që së paku në aspektin ligjor të pamundësojmë dhe të mbajmë larg kutive të votimit duart e manipuluesve të zgjedhjeve.

Zgjedhjet e vitit 2010 na kanë dhënë mësim që sidomos numërimin e fletëvotimeve duhet ta bëjmë në masa të larta të sigurisë dhe në mënyrë transparente, duke u larguar nga vendvotimet dhe duke u përqendruar në qendrat komunale të numërimit. Tash së fundi, pra zgjedhjet lokale rezultuan me rreth 500 kuti të votimit në të cilat ka pasur parregullsi serioze që nga numërimi dhe plotësimi i formularëve, e deri te mungesa e shiritave të sigurisë dhe hapja e tyre, si dhe mbi 100 000 fletëvotime të pavlefshme që kanë rezultuar, përveç nga informimi i dobët, edhe nga mënyra e vlerësimit të fletëvotimeve nga komisionarët.

Nisur nga parregullsitë e shumta në zgjedhje, ne duhet të fokusohemi në gjetjen e mekanizmave ligjorë për ta penguar cenimin e vullnetit të votuesve, duke përdorur praktikën dhe standardet më të mira për të mundësuar proces të sigurt, të saktë, të besueshëm, të shpejtë dhe transparent të numërimit të fletëvotimeve që mundësojnë integritet të zgjedhjeve.

Pra, pikërisht kjo është arsyeja që ne kemi propozuar që numërimi i fletëvotimeve të bëhet në qendra komunale të numërimit të votave. Pra, për këtë duhet të ngrihen qendra komunale të numërimit në secilën komunë, të cilat do të bëjnë pranimin e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, do të numërojnë dhe bëjnë vlerësimin e votave dhe do ta plotësojnë tabelën e rezultateve për secilin vendvotim.

Këto qendra duhet të vendosen në hapësira të mëdha publike, kryesisht në salla të sportit apo shtëpi të kulturës, ku mundësohet transparencë më e madhe dhe kushte të punës më të përshtatshme. Qendrat komunale të numërimit duhet ta kenë infrastrukturën e nevojshme, përfshirë aksesin në internet, të monitorohen jashtë dhe brenda me kamera dhe të sigurohen nga Policia e Kosovës.

Të gjitha këto, pra, që i përmenda, sigurojnë një integritet zgjedhor për të cilin është folur shumë gjatë këtyre muajve dhe viteve të reformës zgjedhore, por shumë pak është bërë, pasi këtu ndërthuren shumë interesa dhe fate politike të mbijetuara nëpërmjet keqpërdorimit e manipulimit. Nga kjo varet shumë nëse duam të vazhdojmë t'i lejojmë mandatet e fituara nga vjedhjet në kutitë e votimit dhe nga manipulimet në tavolinat e numërimit, apo nëpërmjet votës së lirë të qytetarëve.

Në legjislaturën e ardhshme edhe mund të pritet që ndonjë nga ne të mos mund të zgjidhemi si deputetë dhe kjo është normale, por nuk mund dhe nuk duhet lejuar kurrësi që dikush si subjekt politik apo si individ të jetë prapë në legjislaturën e ardhshme me vota të vjedhura dhe me proces të manipuluar.

Në fund, për shkak të kontrabandimit të formulës për ndarjen e ulëseve që e përmenda më parë, ne do të abstenojmë në këtë fazë dhe do të bëjmë amendamentet tona për këto që i thashë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar

Sa i përket deklaratës së fortë të zonjës paraprake për kontrabandim, është absolutisht e pavërtetë dhe është manipulim me foltoren e Kuvendit. Varianti i numërimit ose formula siç njihet ..., ka qenë qysh në Komisionin ad hoc. Komisioni ad hoc e ka lënë si variant. Është diskutuar në komision, është në të gjitha korrespondencat që i ka pasur komisioni, me të gjithë anëtarët e vet që i ja dërguar edhe në mënyrë elektronike, edhe në mënyrë fizike, dhe është votuar në komision. Kjo është e pavërtetë çfarë po deklarohet këtu dhe është një paturpësi e deklaramit të tillë, e para.

Dhe, e dyta, sa i përket këtij deklarimi dhe këtij qëndrimi është fajtorë personalisht zonja dhe partia së cilës i takon pse plot tri javë ditë është vonuar ligji, sepse e ka humbur kuorumin dhe sot jemi tri javë me vonesë dhe rrezikojmë të shkojmë në zgjedhje pa reformë. Personalisht je fajtorë dhe ia pafsh hairin fajit që e ke bërë! Dhe, tash jemi në një situatë tjetër, kur komunitetet po shantazhojnë dhe bllokojnë dhe thonë që nuk do të marrim pjesë në votimin e ligjit dhe do ta bllokojmë ligjin nëse nuk u kthehen vendet e rezervime. Kjo po jep efekt të multiplikatorit si rezultat i një qasjeje të pasaktë dhe të pakoordinuar dhe e cila po e dëmton edhe procesin e zgjedhjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Zoti Gashi po thotë që Lëvizja “Vetëvendosje” i ka fajet pse ligji është vonuar 3 javë. Kjo është e pavërtetë, kjo është shpifje, për shkak se ju si LDK e keni bllokuar procesin e reformës zgjedhore tash 3 vjet, herë për interesat tuaja, e herë për interesat e PDK-së. Dhe, kjo çka po deklaroni ju është e pavërtetë. Më vjen shumë keq!

Sa i përket formulës për ndarjen e ulëseve në Kuvend, e vetmja herë kur është diskutuar për këtë formulë, ka qenë në një grup punues të mbledhjes të Komisionit për Legjislacion. Zoti Demolli është këtu. Në ish-Komisionin ad hoc, me përgjegjësi të plotë e them, asnjëherë nuk është diskutuar ndarja e ulëseve në Kuvend. Kjo është kontrabanduar nga ju dhe nga PDK-ja dhe këtë duhet pranuar dhe si të tillë këtë dispozitë duhet hequr. Faleminderit!

KRYETARI: Enis Kervan, replikë!

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Duhet të qartësohet se të gjitha komunitetet nuk e kundërshtojnë dhe kur bëhet fjalë për komunitetet, është mirë të ceket, sepse komunitetet joserbe, përfaqësuesi i komuniteteve joserbe, edhe në komision e ka dhënë përkrahjen, por edhe ne sot, krejt komunitetet joserbe këtu jemi të të gjitha komuniteteve, prandaj duhet të qartësohet.

KRYETARI: Mirë! Faleminderit! Një minutë e ke, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm desha të sqarohem me komunitetet joserbe. Ju kërkoj falje nëse ka ndodhur ndonjë keqkuptim. Bartës i këtij procesi ka qenë komuniteti serb dhe ka përdorur metoda të ndryshme.

Sa i përket Albulenës, besoj që të gjithë e dinë që kjo e ka bllokuar punën në Komision dhe sot jemi tri javë me vonesë dhe formula e 'D Hontit' në Kuvend është formulë fer, e cila e bën rishpërndarjen e përqindjes që nuk hyn në Kuvend në mënyrë proporcionale, prandaj mendoj se është e pasaktë, e pavërtetë dhe mënyra qysh drejtohet këtu është jodinjitoze. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht, formula e 'D Hontit' nuk e shpërndan në mënyrë proporcionale mbetjen e vendeve, por cilido që të jetë vullneti i Kuvendit është rregull për ne, por nuk është e vërtetë që e shpërndan në mënyrë proporcionale. Duhet të ju them që Kuvendi ka mundësi sot të reflektojë pak. Ka qenë e pritshme për të besuar se pas zgjedhjeve të vitit 2010, Ligji për zgjedhjet është dashur të konsiderohet si ligji më i rëndësishëm i një legjislature.

Domethënë disa deputetë të cilët e kanë të qartë se procesi zgjedhor në vitin 2010 është abuzuar skajshëm, atëherë të paktën ta marrin njëfarë përgjegjësie për ta përmirësuar çka është e mundshme, por ndoshta ky është edhe pak paradoks - si të pritet prej njerëzve të cilët kanë përfituar prej atij procesi zgjedhor, ta ndërrojnë atë proces zgjedhor. Ndoshta kemi hyrë në një fazë goxha kritike dhe nuk e di, mund të na përcjellë ky problem edhe në të ardhmen.

Tani, për çfarëdo ligji apo për çfarëdo legjislacioni, i cili nuk kalon në demokracinë parlamentare fajin e ka mazhoranca dhe prapë ka qenë e pritshme. Prapë ka qenë e pritshme për shkak se abuzimi ekstrem me vota në vitin 2010 ka ndodhur prej partive që janë sot në pushtet dhe nuk ka askush asnjë pikë dileme.

Çështja tjetër që duhet reflektuar për këtë ligj është se në vitin 2011 ka pasur një marrëveshje politike ndërmjet PDK-së, LDK-së dhe AKR-së për ta nisur procesin e ndryshimit të ligjit dhe sot jemi në vitin 2014, nëse nuk është e tepërt t'ua përkujtoj deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Tre vjet pas po flasim për detaje krejt të parëndësishme për një ligj zgjedhor. Pyetja që duhet ta bëjmë tani është çka po ndryshon me këtë ligj? Cilat janë ndryshimet? Nëse dikush di të dalë në foltoren e Kuvendit dhe të tregojë konkretisht cilat janë ndryshimet esenciale, çka kemi ndryshuar në sistem me këtë ligj, ma merr mendja që secili prej deputetëve do të ishte i lumtur po të dijë dikush të thotë diçka, por praktikisht nuk po ndryshon kurrgjë.

Krejt ndryshimet esenciale që kanë nisur në fillim të vitit 2011, pak nga pak janë latuar, janë hequr dhe kemi ardhur në një ligj i cili bën vetëm ndryshime, të cilat kanë të bëjnë me njëfarë forme të administrimit të zgjedhjeve, pak me KQZ-në dhe disa elemente tjera që janë më tepër teorike se sa që kanë për të ndryshuar diçka në praktikë. Sidoqoftë, do të ishte ‘non sens’ të provohet tani për ta bllokuar ligjin. Ne mendojmë se ligjin duhet ta votojmë. Ne do ta votojmë si Grup Parlamentar. Do të shohim se çka mund të bëjmë edhe në leximin e dytë, por po duket që Kosova nuk mund të ndryshojë në proces zgjedhor absolutisht aspak me këtë ligj, të cilin, ne, sipas të gjitha gjasave, do ta kalojmë sot.

Edhe një herë po ju them, është e dhimbshme ta vërtetojmë edhe një herë se praktikisht, kryesisht, por jo vetëm prej partive në pushtet, nuk ka pasur kurrfarë vullneti për të ndryshuar diçka në mënyrë thelbësore në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përhëndetje për dy ministrat,

Përhëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh se sot e kemi në shqyrtim Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mund të themi se ndryshimet të cilat kanë ndodhur në këtë projektligj nuk i plotësojnë as për së afërmi kriteret për të garantuar zgjedhje të lira, të drejta, demokratike dhe fer.

Megjithëse jemi në një moment kur ndoshta edhe zgjedhjet gjysmake mund të jenë më të mira se sa ajo që ka qenë, ne i kemi disa vërejtjeje dhe sugjerime të cilat do t'i japim në komision, e në esencë theksojmë se më së shumti është nevoja e krijimit të qendrave komunale të numërimit, e jo në vendvotime, meqë aty do të ndalej manipulimi i votave që ka ndodhur gjatë zgjedhjeve të kaluara.

Duke e parë që nuk është interesimi shumë i madh i deputetëve për një ligj shumë të rëndësishëm, besoj që interesimi do të jetë më i madh kur të mbahen zgjedhjet. Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahjen, ndërsa amendamentet do t'i japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të SLS-së, nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit “6+”, kryetarja Myfera Shiniq e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Faleminderit!

Kosova Cumhuriyeti Genel Seçimler Yasa Tasarısını 6+ Parlamenter Gurubu olarak dikkatli bir şekilde inceledik.

Kosova genelini ve toplulukları yakından ilgilendiren konulara dikkat çekmek istiyoruz.

Örneğin, bu Yasa Tasarısının 31.3 maddesinde seçim yerlerinde sandık görevlileri vurgulanırken, seçim yeri başkanı diğer topluluklardan öngörülmemiş. Seçim yeri başkanı belediye çapında seçimlerde en çok oy alan dört partiden seçilebilir öngörülmesi,

topluluk haklarıyla karşı düşmektedir. Bu maddenin en son kelimesi “Belediye” yerine “Seçim yeri” geçmelidir.

Yasanın 84. maddesine göre, Merkez Seçim Komisyonu tarafından 750 seçmen sayılı bir veya fazla sandık koyması öngörülüyor. Öngörülen ev ile seçim yeri arası 3 kilometreyi de gözönünde bulundurursak, bu 750 seçmen sayısı sandıklara 750-850 arası geçmesini öneriyoruz. Aynı zamanda önümüzdeki seçimlere kadar seçim listelerinin temizlenemeyeceğini gözönünde bulundurarak, şartlı oylama sisteminin çekilmemesini, yani listeler temizlenene kadar devam etmesini öneriyoruz.

İki okunuş arası komisyona vereceğimiz önergelerle birlikte Genel Seçimler Yasa Tasarısını desteklediğimizi ve yasanın en iyi bir şekilde hazırlanması doğrultusunda 6+ Parlamenter Gurubu olarak katkımızı sunacağız.

Söz seçimlerde iken bir konuyu daha vurgulamak istiyorum. Topluluklara ayrılan garanti ve tahsis edilmiş yerlerin Anayasa konusu ayandır. Ancak parti liderleri arasında bugüne kadar diğer önemli konularda yapıldığı gibi, siyasi anlaşma olarak bir dönem daha devam etme gereğini vurgulamak istiyoruz. Bu anlaşmanın olacağına inanıyor, tüm topluluklar olarak Kosova’nın her alanda kalkınması için en az diğer topluluk temsilcileri kadar zaten katkımızı sunuyoruz. Bu önerinin kabul edilmesiyle daha da katkımızı sunacağımıza inanıyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Pasi e kemi numrin e mjaftueshëm për votim, po i votojmë pikat e mbetura, pastaj vazhdojmë me diskutimin. A jeni dakord? Do të thotë,

7. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi për votim është shtyrë për sot.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Sipas Rregullores, kur janë baras nuk kalon. Jo, jo nuk ka dy. Unë po lexoj, ju dëgjoni. Detyra juaj është të dëgjoni ose edhe e dini rendin e ditës, e keni përpara.

8. Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 51 vota për, 24 kundër, dy abstenime, Kuvendi miratoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013.

Pika e nëntë:

9. Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e kaluar, tani ka mbetur votimi për shkak të mos prezencës së kuorumit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatoj se me 80 vota për, asnjë kundër, dy abstenime...,

... u bënë 79 se një u hoq, për, dhe dy abstenime, asnjë kundër, Kuvendi miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Dhe, pika dhjetë

10. Votimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës janë kryer në seancën e kaluar, tani ka mbetur votimi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 79 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi deklaratën për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile, të paraqitur nga deputeti Glauk Konjufca dhe grupi i deputetëve nënshkrues.

Dhe, tani vazhdojmë me diskutimet:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Vazhdojmë me diskutimet. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi, kush tjetër?

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kush i nderuar, shumë i respektuar! Faleminderit për komplimente!

Unë do të jem shumë konciz për arsyen se këtë materie e njoh mirë dhe bashkë me kolegun Haki Demolli, ndoshta më së miri, sepse kemi vjel gjithë eksperiencën e demokracive të konsoliduara dhe kemi një eksperiencë të jashtëzakonshme dhe kemi një ekspertizë.

Ajo çka tash është debat në shoqërinë tonë, në opinionin publik - vota për kryetarët. Quhet se s'është demokratike, e tjera, e tjera...

Pikërisht, nuk është demokratike, po të jemi në listë me të tjerët, sepse janë shumë të privilegjuar dhe nuk janë të barabartë me ne të tjerët, me gjithë të tjerët, se ndoshta nuk jam në listë, sepse ata duke prezantuar partinë në çdo moment dhe përditë janë prezent në publik, natyrisht se nuk janë të barabartë me të tjerët.

Dhe kështu që kuota e partisë, nëse i shkon kryetarit të partisë, është një proces demokratik normal, sepse të tjerët janë të barabartë pastaj mes vete.

Kështu që, këtë e kemi analizuar, e kemi sheshuar dhe këtë eksperiencë nuk e kemi sjell kokë më vete, por këto praktika janë edhe në demokraci të konsoliduara. Kështu që këtë dilemë duhet ta heqim dhe këtë debat duhet ta mbyllim, sepse është pikërisht demokratike, në qoftë se të tjerët janë në listë dhe kryetari i partisë merr të gjithë votat, kuotën e partisë. Në siglën e partisë votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Veç është mirë të na tregosh në cilin vend demokratik është kjo praktikë? Urdhëro, Halit, tregona në cilin vend është kjo praktikë.

HALIT KRASNIQI: Tani, është listë e gjatë i nderuar kryetar. Dhe, tani është një eksperiencë e gjatë që e kemi bërë dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Zgjedhjeve i kanë parë se në demokracitë e konsoliduara kjo praktikë është kaheerë dhe natyrisht që edhe te ne këto eksperiencia duhet të barten.

Madje, disa qëndrime që i kemi marrë tani, i kemi marrë kudo që ne kemi vërejtur se ka ngjashmëri me shoqëritë tona. Çdo qëndrim që ne e kemi parë të dobishëm për zgjedhjet e ardhshme e kemi marrë. Ka praktika, të cilat janë shumë të dobishme, po praktikisht nuk janë funksionale te ne. Dhe, natyrisht që nuk kemi arritur konsensusin dhe pajtueshmërinë, që t'i fusim në zgjedhje, në Ligjin zgjedhor. Madje, madje të gjitha ato propozime që i kemi pasur, po të futeshin në këtë ligj zgjedhor do të ishte shumë perfekt. Por, neve nuk kemi mundur të arrijmë konsensusin e përbashkët dhe natyrisht, që ky ligj tani nuk është nga më të dëshirueshmit, nuk është më perfekt dhe nuk është ai që i duhet procesit politik të Kosovës dhe sistemit zgjedhor tonit, por nuk kemi mundur të arrijmë konsensus më tepër sesa kaq.

KRYETARI: Mirë, ne jse, në pyetjen time s'u përgjigje! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Kam përshtypjen që liderët po kanë frikë me. Zoti Halit, dëgjoje përgjigjen. Kam përshtypjen se liderët po kanë frikë me dalë në zgjedhje, me garua, lideri juaj e kam fjalën, se mund të mos i marri të njëjtat vota, prandaj.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me ligjin, që në fillim mund të konstatojmë se ka pësuar shumë pak ndryshime, ose pothuajse aspak. Unë do të them mendimet e mia personale në lidhje me këtë.

Personalisht mendoj që është dashur të ketë më shumë zona zgjedhore, se sa një zonë zgjedhore. E di që janë dakorduar subjektet politike për një zonë zgjedhore dhe kjo është e pandryshueshme, por në mënyrë që deputetët të rrisin llogaridhënien dhe kontaktet me votuesit e tyre, mendoj që varianti me shumë zona zgjedhore do të ishte më i

përshtatshëm, se sa ky me një zonë zgjedhore, ku deputetët në fakt, janë deputetë të gjithë Kosovës, që i bie të gjithkujt, po njëkohësisht dhe të askujt.

Ligji në fjalë, Projektligji në fjalë nuk e ka zgjidhur gjithashtu, çështjen e partive me ideologji antikushtetuese, që në përgjithësi kanë një diskurs që synon të rrënojë korpusin e të drejtave themelore të njeriut, të përfshira në Kushtetutën e Kosovës, por ky korpus është i përfshirë në të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ligji në fjalë nuk e ka zgjidhur këtë çështje. Në fakt, Komisioni Qendror për Zgjedhje do të ndeshet sërish me këtë problem, kur për certifikimin dhe regjistrimin e subjekteve politike do t'i shkojnë subjekte të cilat me dokumente janë në rregull, por me veprime janë të ndryshme.

Unë nuk mendoj që Kosova duhet të presë, që këtu të na shfaqet një Agim i Artë, në mënyrë që të marrë masa. Ka modele të cilat e kanë zgjidhur këtë çështje dhe mendoj që ekspertë të shumtë, që kanë punuar për të bërë këtë ligj, është dashur të konsultojnë, për shembull, modelin gjerman, i cili e ka zgjidhur më së mirë këtë çështje.

Një çështje tjetër që nuk e adreson ligji, është përfshirja e votuesve jashtë vendit. Mendoj që shqiptarët që jetojnë jashtë Kosovës, vazhdojnë të mbeten të diskriminuar. Kosova tashmë i ka disa ambasada, ka ambasada nëpër vende të caktuara. Dhe, për mendimin tim, duhet që këto ambasada të shërbejnë edhe si vendvotime, në mënyrë që kush ka dëshirë, t'u mundësohet vota shqiptarëve që jetojnë jashtë Kosovës. Dhe, kjo nuk është vetëm një shqetësim imi, por i shumë e shumë qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës, që ma kanë adresuar këtë problem dhe po e ngre edhe në emrin e tyre.

Një gjë tjetër, që ligji nuk e ka adresuar, është rritja e transparencës, gjë e cila do të duhej të bëhej në radhë të parë me sanksionimin në ligj që ky proces të monitorohej me kamera. E kam fjalën për vendnumërimet. Duhet të jenë prezente kamerat, në mënyrë që të rritet transparenca, sepse e dimë se çfarë abuzimesh të jashtëzakonshme ka pasur në zgjedhjet e kaluara. Jo se kamerat do të pamundësojnë tërësisht vjedhjen, sepse ajo varet nga vullneti i njerëzve, por mendoj që do ta zvogëlojnë atë. Dhe, nuk e di se pse është hezitur edhe për këtë, mbase Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund ta bëjë këtë me akte nënligjore, por për mendimin tim, kjo është dashur të sanksionohet në ligj.

Çështja e fundit, që dua të paraqes këtu para jush si shqetësimin tim, po më vjen mirë që ky është shqetësim i shumë deputetëve, lidhet me kandidatin e pavarur, pragu i të cilit është lënë 2,5%. Mendoj që është antikushtetuese, është shumë i lartë, me 2,5% në këtë Kuvend mund të hyjnë 3 deputetë. Mendoj që kjo duhet të zgjidhet përpara se çështja të shkojë në Gjykatën Kushtetuese.

E di që kjo është kërkesë edhe e Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile dhe më vjen mirë që e kanë konstatuar këtë, edhe pse me vonesë, mendoj unë, sepse edhe në zgjedhjet e kaluara është dashur të jetë ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Ta dhashë mundësinë unë... një minutë, Halit!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pa dashur po përfshihem në një replikë, tash me dy personalitete që këtu shumë i respektoj, me ju i nderuar kryetar, që ma apostrofuat emrin dhe me shumë të nderuarën, miken time Alma Lama.

Ju të dy keni ndërruar partitë dhe keni pak problem me liderin tani dhe keni kompleks tash për liderin. Dhe, nuk është faji im. Kështu që, ju lutem, unë solla një praktikë të demokracive të konsoliduara në Evropë, në të cilat dy vjet OSBE-ja na ka financuar, jo Kuvendi. OSBE-ja na ka financuar që ne të marrim eksperiencë dhe t'i bartim këtu në Kuvend. Dhe, më besoni nuk kam besuar që më karakterizon një urti e tillë, një qasje kaq konstruktive mua edhe kryetarin Demolli, që ne me maturi të dëgjojmë edhe ato të padëgjua, edhe ato, edhe ato emocione të cilat nuk i shërbenin ligjit, edhe ato ide e koncepte të cilat ishin arkaikë, kështu që ne kemi bërë një punë të përkushtuar dhe kemi sjell eksperiencë të çmueshme.

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Një minutë, Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë i respektuar deputeti Halit Krasniqi,

Dua të t hem diçka që më duket se ju e keqkuptoni partinë politike, konceptin për partinë politike. Njerëzit bashkohen kur kanë ide dhe koncepte të njëjta, në momentin që s'i kanë ato besoj që nuk kanë se të rrinë më bashkë dhe për më tepër vërtet se unë kam ndryshuar parti, por nuk kam ndryshuar qëndrime, kështu që duhet të jeni i sigurt në këtë.

Tani për sa i përket liderëve e thashë mendimin tim personal, zgjedhjet janë fushëbetejë për të gjithë. Mendoj se të gjithë duhet të dalin në fushëbetejë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

Mërgata shqiptare përbën rreth 30% të popullsisë së tërësishme të Kosovës. Deri në përfundim të luftës ai ishte një faktor i rëndësishëm ekonomik dhe politik, pas përfundimit të luftës ajo vazhdoi ta luajë rolin e saj të madh ekonomik, sot më shumë se 10% e të ardhurave të përgjithshme kombëtare, rreth 600 milionë në vit, vijnë nga mërgata.

Fatkeqësisht dhe jo për fajin e saj ajo e ka humbur gati tërësisht rolin politik. Gjatë zhvillimit të seancës së kaluar disa portale mes tyre edhe Alb-info, publikoi një kërkesë të një varg organizatash, shoqatash dhe institucionesh të mërgimtarëve shqiptarë nga Zvicra dhe vende tjera si aktivistët shqiptarë, të Sindikatës Unia, Shkolla Shqiptare e vallëzimit "Shota" Lidhja shqiptare në botë, me qendër në Zvicër, Qendra profesionale për migracion Pro-integra, Shoqata shqiptare e gruas "Drita" në Cyrih, Bashkësia shqiptare

në Shafhausen, institucioni Abi SM, në Bazel, Shoqëria kulturo-artistike “Dardania” në Vintertur, Ansambli “Arbëresha” në Sirnah, Grupi i vallëzimit “Rinia” në Shtrajtenbach, Qendra e integritit kulturor “Aleksandër Mojsiu” në Zvicër, Shoqata “Blat-alb” në Opikon-Bratbruk, Shoqata “Iliria” Laiman, Gjermani, Shoqata “Nënë Tereza” në Gjermani, Shoqata “Arbëria” Vaishlloch, Unioni Artistik për mërgatë ku bëjnë pjesë rreth 30 shoqata artistike të mërgimtarëve në gjithë diasporën.

Të gjitha këto kërkojnë që përmes Ligjit për zgjedhje të krijojnë mundësi për votim në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës si dhe përmes postës elektronike, pa përjashtuar edhe mundësitë tjera.

Kjo kërkesë i drejtohet Parlamentit, ndërsa kërkesa tjetër që i drejtohet partive politike ka të bëjë me atë që këto shoqata, organizata kërkojnë që zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të zhvillohen më 3 gusht, ku shumica e qytetarëve nga vendet perëndimore vijnë në Kosovë dhe mund të votojnë edhe fizikisht.

Deri tani e drejta për të votuar jashtë vendit është njohur formalisht nga institucionet tona, ndërsa është mohuar praktikisht. Zgjedhjet e vitit 2010 dhe zgjedhjet e fundit lokale në të cilat numri i votuesve jashtë vendit nuk ka kaluar asnjëherë shifrën 1 500 e vërteton këtë pohim.

Pjesëmarrja e ulët është pasojë e operacionit të komplikuar të votimit, mungesës së informacioneve të mjaftueshme dhe të nevojshme dhe afateve të shkurtra për regjistrim e votim.

Aktualisht një shtetas i Kosovës që jeton jashtë vendit i ka mundësi, të vijë fizikisht për të votuar në mënyrë të rregullt në vendin tonë ose të votojë përmes postës. Për të votuar përmes postës duhet të regjistrohet pranë KQZ-së duke e plotësuar një formular dhe duke e bashkëngjitur një numër dokumentesh që dëshmojnë se është personi me të drejtë vote.

Faza e regjistrimit zakonisht fillon disa ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe përfundon me projektligjin e ri, 70 ditë para datës së zgjedhjeve.

Deri më tani votuesit për t’u regjistruar kanë pasur mundësi t’i dërgojnë aplikacionet dhe dokumentet përmes postës, e-mail-it dhe faksit. Pas regjistrimit kanë marrë me postë konfirmimin e KQZ-së, më pas fletëvotimin dhe pas saj kanë votuar përmes postës.

Fakti që procedura e regjistrimit të votuesve jashtë vendit përfundon kaq shumë ditë para datës së zgjedhjeve është një arsye pse numri i votuesve është kaq i vogël, ndërsa fletëvotimin kanë mundësi ta dërgojnë vetëm përmes postës duke futur në zarf së bashku me një dokument identifikimi.

Për t’u krijuar mundësi qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, për të marrë pjesë në proceset politike duhet të plotësohen dy kushte. Kuvendi i Kosovës duhet të ketë vullnetin politik dhe të angazhohet seriozisht për një pjesëmarrje më të gjerë të mërgatës në zgjedhje dhe këtë vullnet duhet ta shprehë përmes normave ligjore duke thjeshtëzuar

procedurat e regjistrimit dhe votimit përmes Ligjit për zgjedhjet. Në shërbim të pjesëmarrjes sa më të gjerë të mërgimtarëve të Republikës së Kosovës, në zgjedhje, ne propozojmë:

Të zgjate periudha e regjistrimit të shtetasve për të votuar jashtë vendit. Në procesin e regjistrimit të përfshihen përfaqësitë diplomatike të vendit tonë duke u mundësuar mërgimtarëve që përveç mundësisë së aplikimit përmes postës në KQZ të kenë edhe mundësinë e regjistrimit direkt dhe personalisht në përfaqësitë e Republikës së Kosovës.

Ambasadat në vlerësimin e tyre dhe në bashkëpunim me organizatat e diasporës dhe në praninë e vëzhguesve të organizojnë aktivitete të veçanta për regjistrimin vullnetar të shtetasve jashtë Kosovës dhe në lokacionet tjera brenda të njëjtit shtet ku veprojnë.

Paralelisht me regjistrimin përmes postës dhe ambasadave duhet të zhvillohet një aplikacion online ku qytetarët me të drejtë vote të kenë mundësi të regjistrohen online si votues jashtë vendit pa pasur nevojë që ata të aplikojnë duke dorëzuar aplikacionet për regjistrim në fahun postar të KQZ-së. Karshi votimit përmes postës të aplikohet edhe votimi direkt në ambasada dhe përfaqësi të Republikës së Kosovës.

Në ato vende ku nuk kemi prezencë diplomatike të shfrytëzohen ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, kurse në shtetet tjera kur nuk kemi mundësi të kemi qendër votimi, atëherë shfrytëzohen qendrat e votimit të shtetit më të afërt ku kemi prani diplomatike.

Përveç mënyrave klasike të votimit duhet të hulumtohet seriozisht edhe modaliteti bashkëkohor dhe që lehtësohet nga teknika dhe teknologjia, të merret në konsideratë edhe mundësia e votimit përmes internetit paralelisht me votimin përmes postës dhe në ambasada.

Zgjidhja më e mirë dhe më e qëndrueshme për votim jashtë vendit do të ishte votimi përmes internetit. Një votim i tillë do të ishte i mundshëm përmes identifikimit të votuesve me kod, kodi i gjenerohet automatikisht votuesit që në momentin e regjistrimit, ndërsa në momentet kur votojnë identifikohen përmes të njëjtit kod.

Votuesi tashmë i regjistruar voton përmes internetit duke u identifikuar. Hartohet aplikacioni për të aplikuar online nëpërmjet ueb-faqes së KQZ-së ku formulari integrohet brenda tij ku mundësohet ngarkimi, shkarkimi i dokumenteve të identifikimit. Duhet të sigurohet gjithashtu që aplikacioni është kompaktibël me të gjitha programet e teknologjisë informative. Duhet të përcaktohet që secila fushë e aplikacionit të plotësohet, t'iu bashkëngjiten dokumentet e identifikimit dhe përfundimi rezulton me dërgim automatik si e-mail në adresë të KQZ-së.

Platforma e vendosur nga KQZ-ja ua kthen konfirmimin me automatizëm për pranimin e aplikacionit.

Pra, këto janë disa propozime konkrete të cilat ne do të dëshironim të shqyrtoheshin në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është debati më i rëndësishëm për demokracinë e Kosovës, për krijimin e parakushteve të kërkuara në rrugën e integritit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Mund të them se me këtë ligj nuk është arritur as minimumi i kompromisit në debatin që është organizuar në opinion lidhur me zgjedhjet.

Dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj sidomos te pragu elektoral. U tha edhe nga parafolësit se ky prag në të vërtetë është një prag i lartë për koalicionet është 7.5, për partitë politike 5, ndërsa sidomos janë të diskriminuar kandidatët e pavarur të cilët duhet të kalojnë prapun prej 2.5% të votave të vlefshme.

Sidomos është e keqja e madhe te kandidatët e pavarur për shkak se me këtë projektligj parashikohet që ata të vlejné sa 50% e numrit të votave të partive politike që është diçka e pamundur, madje unë mendoj që edhe termi prag elektoral për këtë rast nuk ka vlerë për shkak se kjo në të vërtetë është një derë e mbyllur për ta.

Në kushte të mira do të ishte mirë që ky prag të ulej dhe kam propozim që pragu zgjedhor të ulet në 1% sidomos për kandidatët e pavarur për të cilët vendi jonë ka shumë nevojë, sepse ne kemi të bëjmë me një Kuvend, me një Parlament ku ka nevojë për debat edhe nga grupe te vogla të interesit, po edhe nga individët e pavarur të cilët shpeshherë kanë dëshirë që ta japin kontributin e tyre këtu.

Kosova nuk ka nevojë të shkojë drejt një polarizimi partiak politik, për më shumë ka nevojë që ky Kuvend ta ketë fytyrën e vet, ta ketë fytyrën e demokracisë, domethënë fytyrën e tranzicionit në të cilin po kalojmë dhe nuk ka nevojë që të llogaritet si një vend i cili ka kaluar një fazë të lartë të demokracisë për shkak se ne ende jemi në një proces i cili proces ia vlen që të jetë proces transitiv edhe për një kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe të drejta është shtylla kryesore e demokracisë të cilat legjitimojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente përfaqësuesit e popullit që ta udhëheqin atë, prandaj duhet zgjedhur praktikat më të mira dhe më të lehta që të arrihet një legjitimitet sa më i plotë.

Për herë të parë në shtetin e pavarur të Kosovës u mbajtën zgjedhjet parlamentare më 12 dhjetor të vitit 2010. Parregullsitë, mangësitë dhe manipulimet që u shfaqën gjatë procesit zgjedhor që nga zgjedhjet e para pas pavarësisë deri më tani vërtetojnë nevojën për një reformë të tërësishme zgjedhore.

Pas evidentimit të mangësive dhe parregullsive në zgjedhjet e kaluara partitë politike në Kosovës me rekomandimet e faktorit vendor dhe ndërkombëtar iniciuan reformën zgjedhore që konsistojnë në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhje.

Në seancën plenare të 22 prillit të vitit 2011, me 76 vota për, 6 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi i Kosovës formoi Komisionin ad hoc për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Detyra e Komisionit pra ishte plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit, të cilët pra do të krijonin përmes ligjit parakushte për një sistem zgjedhor që do të sigurate votimin dhe zgjedhjet demokratike.

Puna e Komisionit për amendamentimin e ligjit dhe grupit për formë zgjedhore filluan në vitin 2010 dhe tani para vetes kemi një projektligj i cili nuk i ka pritjet e kërkuara.

Unë kam shumë kritika lidhur me ecurinë e procesit të reformës zgjedhore dhe them se kjo reformë është duke u bërë sa për sy e faqe.

Po të kishte vullnet politik deri më tani reforma do të ishte përfunduar dhe edhe me ndryshime kushtetuese duke garantuar një formë të mirëfilltë dhe të zbatueshme.

Në këtë projektligj i cili nuk paraqet reformë, nuk kemi garanci që zgjedhjet e ardhshme do të organizohen me listën e pastruar të votuesve apo do të eliminohen problemet e evidentuara nga zgjedhjet e kaluara.

Partitë e mëdha janë duke bërë ndryshimin në Ligjin zgjedhor siç po u shkon për shtati atyre.

Si ka qenë procesi zgjedhor deri më tani, cilat kanë qenë përparësitë dhe të metat e këtij procesi, çfarë duhet të ndryshojë në mënyrë që të kemi zgjedhjet e bazuara në standarde ndërkombëtare, cilat masa duhet t'i marrim që të parandalojmë manipulimin e mundshëm?

Këto janë pra disa pyetje që duhet t'i kemi parasysh gjatë plotësimit të këtij projektligji.

Një ndryshim apo edhe përmirësim i mëtutjeshëm i sistemit zgjedhor do të ndikonte në rritjen e legjitimitetit demokratik dhe të përgjegjshmërisë së gjithëmbarshme.

Republika e Kosovës deri më tani ka pasur një zonë zgjedhore me lista të hapura dhe në debatin mbi reformën është fokusuar në këto tema, mirëpo ajo çka është e rëndësishme

dhe që është faktor kyç në mbarëvajtjen e zgjedhjeve është mënyra e menaxhimit të zgjedhjeve.

Sa i përket menaxhimit është e rëndësishme që kësaj duhet t'i kushtojmë pra më së shumti rëndësi.

Dobësitë e theksuara në procesin zgjedhor në Kosovë, ashtu siç u demonstruan më 12 dhjetor të vitit 2010 erdhën më tepër pra si rezultat i administrimit të dobët të zgjedhjeve dhe ndërhyrjeve politike në institucionet e shtetit se sa prej vet natyrës së sistemit zgjedhor.

Rëndësinë e një reforme të gjithëpërfshirëse e ka nënvizuar edhe raporti i misionit të ekspertëve të BE-s për vitin 2010 edhe në Raportin e Progresit, pra të Komisionit Evropian për vitin 2011, në të cilën është bërë thirrje për një sistem më të thjeshtë dhe më transparent, si dhe për shqyrtimin e rasteve të mashtrimit në zgjedhje.

Në hyrje e Kodit të Komisionit të Venecias përshkruhen pesë parime të trashëgimisë zgjedhore evropiane, të cilat janë votimi universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë.

Vazhdimisht theksohet se në këto parime themelore të sistemeve elektorale evropiane mund të garohet vetëm nëse plotësohen tri kushtet e përgjithshme.

Së pari, referohet te respektimi i të drejtave themelore të njeriut, së dyti - Ligji zgjedhor duhet të gëzojë një stabilitet të caktuar, i cili do ta mbrojë atë kundër manipulimeve nga partitë politike dhe, së treti, ka të bëjë me nevojën e një numri të garancive procedurale që duhet të sigurohen veçanërisht sa i përket organizimit të votimit.

Sipas Kodit të Komisionit të Venecias, procedurat zgjedhore duhet të jenë shumë të thjeshta. Pra, çështje kryesore të një reforme zgjedhore janë përfaqësimi dhe menaxhimi.

Vërejtjet dhe propozimet e mia konkrete sa i përket projektligjit janë disa prej këtyre dhe po i theksoj.

Me ligj duhet të përcaktohet pragu i validitetit të zgjedhjeve dhe propozoj që ky prag të jetë 40% e pjesëmarrjes së popullatës në zgjedhje.

Në një reformë të mirëfilltë zgjedhore do të duhej të ndërrohej edhe përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mirëpo me qenë se kjo është e përcaktuar me Kushtetutë, atëherë nuk mund të bëhet ndryshimi. Mirëpo, propozimi do të ishte: 50% e anëtarëve nga opozita, 50% e anëtarëve nga pozita dhe komisioni të ketë gjithsej 11 anëtarë, e kryesuesi të vijë nga radhët e gjykatësve.

Gjithashtu, me nenin 29, kualifikimi i kryesuesit dhe anëtarëve të KVV-së, kryesuesi dhe anëtari i KVV-së propozoj që të jenë nga qytetet tjera, në mënyrë që të pamundësohet keqpërdorimi duke e ndryshuar edhe ambientin.

Gjithashtu, lista e votuesve ka qenë një problem shumë i madh. Ekzistojnë me qindra mijëra kosovarë që jetojnë jashtë vendit, persona që kanë vdekur më parë, apo persona që kanë lëvizur brenda vendit dhe janë të përfshirë në adresa të papërditësuara dhe të pasakta në listën e zgjedhjeve.

Në ligjin aktual, neni 37.1 thotë që KQZ-ja mban listën e votuesve dhe siguron që të jetë e saktë dhe e përditësuar. Pra, propozoj që në këtë projektligj të përkufizohet se do të merret parasysh ekstrakti i fundit i regjistrimit të popullsisë.

Kur jemi te kuotat te neni 56, i cili e përcakton edhe kuotën gjinore, unë propozoj që nëpërmjet këtij projektligji të përcaktohet një kuotë për pjesëmarrjen e mërgatës për përfaqësim në Kuvend. Pra, t'i rezervohen edhe mërgatës disa ulëse në Kuvendin e Kosovës dhe gjithsesi të bëhen lehtësime për votim, sepse procedurat e rënda për aplikim dhe votim po e detyrojnë mërgatën që ta bojkotojnë votimin. Propozoj me këtë rast që për mërgatën të aplikohet edhe votimi elektronik.

Kurse sa u përket dokumenteve të pranueshme të identifikimit te neni 93, unë propozoj, siç pata propozuar edhe në grupin punues për draftimin e këtij projektligji, që leximi i votuesve të bëhet në mënyrë biometrike, duke dhënë shenjën e gishtit dhe në këtë mënyrë do të evitoheshin votimet e përsëritura, votimet me kusht do të hiqeshin dhe do të kishim statistika në kohë reale, çka do ta shtonte besimin në procesin zgjedhor. Aplikimi i kësaj pajisje do të kishte kosto të përballeshme.

Gjithashtu, problem esencial ka qenë edhe numri i fletëve të votimit dhe propozoj që te numërimi dhe përpilimi i rezultateve, Kreu XV, neni 103 të ndryshohet dhe numri i votave të bëhet me pajisje elektronike, respektivisht me skaner në çdo vend votim, ose duke u përcjellë nëpërmjet kamerave në qendrat e numërimit komunal ku do të grumbulloheshin të gjitha fletëvotimet dhe do të numëroheshin në praninë edhe të vëzhguesve, por edhe të medieve.

Gjithashtu te Kreu XVI, sistemi zgjedhor për Kuvendin e Kosovës, neni 107, dispozitat e përgjithshme, përcaktohet se Kosova e ka një zonë të vetme zgjedhore dhe bëhet ndarja e vendeve në nenin 108.2.a.

Në mesin e subjekteve politike që e përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera shumicë, në mesin e subjekteve politike që nuk përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet joshumicë, të cilat kanë fituar së paku 5%, për koalicione 7,5% dhe për kandidatët e pavarur 2,5%. Nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend, konsideroj se kemi të bëjmë me një kufizim të qartë të të drejtave të njeriut. Ky kufizim nuk mund të derivohet nga asnjë normë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, as shprehimisht, e as sipas interpretimit kuptimor.

Kufizimi është rezultat i marrëveshjeve politike ndërmjet partive kryesore politike.

Përveç shkeljes së parimeve themelore kushtetuese, ky kufizim është në kundërshtim edhe me përcaktimin kushtetues për ndarjen e vendeve në Kuvendin e Kosovës.

Neni 64 i Kushtetutës së Kosovës, që e përcakton strukturën e Kuvendit, thotë: “Kuvendi i ka 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen ndërmjet të gjitha partive, koalicioneve, nismave të qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvendin”. Shihet, pra, që nuk ka asnjë kufizim për prapenjë të zgjedhor.

Kushtetuta e Kosovës e përcakton shtetin tonë si shtet të qytetarëve të barabartë, që garanton të drejtat për secilin qytetar, lirinë qytetare dhe barazinë e të qytetarëve para ligjit.

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Faleminderit! Ministri Jagxhilar e ka një sqarim për çështjen e shërbyesve civilë.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë nga aspekti i cilësisë së Ministrisë së Administratës Publike, sa u përket disa çështjeve të cilat prekin nëpunësit civilë ose nëpunësit publikë, dëshiroj të jap disa sqarime, në qoftë se më lejohet.

Është konkretisht të përkufizimet e shërbyesve civilë, ku njëkohësisht thuhet ‘shërbyesit civilë’ por njëkohësisht kërkohet sipas Ligjit të shërbimit civil, por Ligji i shërbimit civil e mbulon fushën e nëpunësve civilë.

Në këtë aspekt, fusha e shëndetësisë, fusha e arsimit dhe disa fusha të tjera mbeten jashtë ligjit.

Në këtë aspekt do të ishte mirë që kjo çështje të saktësohet, a do të bëhet për të gjithë nëpunësit publikë ose përfituesit nga paga e Buxhetit të Republikës së Kosovës, a vlen vetëm për nëpunësit civilë.

Sa u përket nëpunësve civilë, ashtu-ashtu është rregulluar me Ligjin e shërbimit civil. Kështu që edhe duhet të harmonizohet me Ligjin e shërbimit civil, por edhe të mendohet për fushat tjera.

Por, gjithashtu unë e shfrytëzoj rastin të propozoj, do të ishte mirë për t’i realizuar mandej edhe këto çështje, që në Ligjin për zgjedhjet të kërkohet, ose nga KQZ-ja, ose në njëfarë mënyre tjetër, të dërgohen të gjitha listat e kandidatëve në Departamentin për Realizimin e Pagave, që të mos krijohen probleme gjatë zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve. Gjithashtu, të kërkohet edhe dërgimi i zyrtar listës së të zgjedhurve që prapë të mos krijohet paqartësi në realizimin e pagave, prapë duke bazuar në përkufizimin, i cili duhet të përmirësohet.

Unë jam i gatshëm të vij edhe në komision për këto çështje, në qoftë se ka nevojë të përmirësohen. Besoj që do t’i ndihmojmë edhe institucionet, por edhe kandidatët

eventuale do ta kenë shumë më të qartë para kandidimit për zgjedhjet se cilat të drejta i kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që është sjellë ky ligj, sado që mendoj se do të duhej të ishte sjellë më herët për ta evituar shkallën e lartë të politizimit, me të cilën po përballemi.

Megjithatë, është ligji i nevojshëm dhe unë si të tillë e mbështes.

Është një ligj që është përgatitur e sponsorizuar nga Kuvendi dhe i ka veçoritë e veta.

Megjithatë, për mua mbetet pak e paqartë kjo që është bashkangjitur edhe në memorandum - çështja e kostos financiare që është ndryshuar dhe që nuk është arsyetuar. Nuk e kuptoj pse Ligji për zgjedhjet duhet të lidhet me periudha vjetore. Pse duhet të lidhet patjetër, ta zëmë, me zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe deklarata financiare për Këshillin Qendror Zgjedhor dhe gjithë infrastrukturën zgjedhore nuk ka të bëjë vetëm me zgjedhjet qendrore.

Prandaj, mendoj që në këtë mënyrë ne hyjmë ose në hullinë që të bëjmë gjithmonë përshtatje edhe financiare strukturës e të gjitha për zgjedhjet, kur të vijnë ato qendrore, pas tyre, pastaj lokale, pastaj presidenciale e tjera. Konsideroj se neve na duhet një kod zgjedhor, që përfshin gjithë legjislacionin zgjedhor dhe gjithë sistemin zgjedhor.

Së dyti, në përgjigjen e saj, sepse këtu duhej ta jepte një mendim, Qeveria është kufizuar vetëm me një vlerësim, një vërejtje krejt formale, jo shërbyes civilë, por nëpunës civilë, dhe konsideroj se ka pasur vend për angazhim më të madh të Qeverisë.

Kurse në qëndrimin për afrimin me 'acquis communautaire' është një formulim që të bën përshtypje. Një konstatim se në 'acquis communautaire' nuk ka një akt legjislativ të posaçëm për këtë. Prandaj, ligji nuk bie ndesh me 'acquis communautaire', kurse ne e dimë që kemi shumë kërkesa nga raportet për Kosovën, nga rezolutat për Kosovën, që edhe këto kohëve të fundit janë përditësuar, e që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor.

Nuk mund t'i anashkalojmë me aq elegancë. Ligji është rasti për t'i korrigjuar dhe vërejtja ime kryesore parimore është këtu që ne nuk e shfrytëzuam këtë rast për t'i bërë reformat e duhura zgjedhore. Jo vetëm pse na i kërkojnë partnerët ndërkombëtarë, por, në radhë të parë, sepse përvoja jonë ka dëshmuar defekte të shumta, që na kanë kushtuar shumë dhe është e pakuptueshme që ne të shkojmë tani, jo vetëm në zgjedhje të reja, por edhe në ligje të reja, me defekte e hendikepe të moçme.

U formua Komisioni Zgjedhor. Komisioni Zgjedhor e ka bërë punën e tij së paku sa i përket pjesës së zgjedhjes së presidentit. Është hartuar Ligji për presidentin dhe u ngri.

Nuk mund ta anashkaloj edhe me këtë rast. E konsideroj një dëm që i bëhet procesit të demokratizimit dhe kompletimit të sistemit zgjedhor.

Ç'është e vërteta, edhe sistemi zgjedhor që këtu thuhet se ky ligj do ta rregullojë dhe vërejtja ime tjetër me ligjin, me përmbajtjen e tij, ka të bëjë me këtë: Ligji nuk mund ta rregullojë atë që e rregullon Kushtetuta. Ligji e rregullon fushën që i është lënë me Kushtetutë ligjit, dhe kjo duhet të thuhet edhe në diapozitiv.

Për më tepër, ligji nuk i rregullon edhe anomalitë që janë derivuar që nga Korniza Kushtetuese, Kushtetuta, dokumenti i Ahtisarit, e me radhë. Ndoshta edhe nuk është e lehtë në këtë fazë të ndryshohen, por së paku do të duhej thënë se e dimë që ka anomali, në të cilat ne do të vazhdojmë të funksionojmë dhe ta paguajmë tagrin e tyre.

Për shembull, ligji thirret te barazia e votës. A kemi barazi të votës me këtë sistem? Barazi e qytetarëve, e të zgjedhurve. Madje, neni edhe tekstualisht thotë “votuesit janë të barabartë në të drejtën për të votuar dhe sa vota do t'i hedhin” e tjera. Pamundësohet çfarëdo diskriminimi, dhe ne e dimë që në praktikë, meqë e kemi një sistem që mundëson shumë vota, dikush është i prirë ta japë një votë, dikush do t'i japë dy, dikush katra - nuk është barazi e votuesve.

Për më tepër, edhe efekti i votës, me disa zgjidhje, formula që janë ‘sui generis’ diskriminon votues të caktuar.

Shikoni në praktikë, ta zëmë, a është efekti - votuesi i njëjtë i votës së votuesve të komunitetit shumicë dhe komuniteteve tjera? Ne e quajmë diskriminim pozitiv. Por, edhe diskriminimi pozitiv, nëse teprohet, kthehet në një diskriminim jo gjithmonë pozitiv.

Ka edhe vërejtje tjera, edhe të natyrës teknike e gjuhësore. Për shembull, ka nen që ka paragraf me numër, ka nen që s'i ka fare të tilla. Ka për më tepër edhe formulime gjuhësore që çuditërisht në gjuhën shqipe janë pa kuptim, e në dy gjuhët tjera dalin me kuptim, dhe kjo më vë në huti në çfarë gjuhe është shkruar ky ligj.

Te definicionet - ka definicione që më bëjnë përshtypje - komuniteti ‘anëtar’ në shqip, ‘inhabitat’ në anglisht, ‘pripadnici’ në serbisht. Asnjëra nuk janë të njëjta dhe grupeve etnike. Ka dallim ndërmjet komunitetit dhe grupit etnik.

Kurse pak më poshtë në ligj flitet për të drejtat e bashkësive, të komuniteteve dhe të drejtat e pakicave në kuptimin lingvistik gjuhësor. Nuk e kemi si kushtetues këtë formulim.

Ose, ta zëmë, te neni 8.2 - përjashtohen nga e drejta për të qenë në Komisionin Qendror Zgjedhor dhe shumë komisione tjera, s'po e përmend gjithkund, përveç tjerash edhe të dënuarit për një vepër me burg një ose më shumë. Dhe, shumë herë është shtruar kjo në këtë Kuvend. Çuditërisht nuk korrigjohet, që nuk korrigjohet.

Zonja e zotërinj,

Kjo dispozitë kështu siç është i përfshin edhe ata që janë të dënuar pa faj, që janë dënuar në kohët e shkuara, me legjislacionin që tani nuk është i dënueshëm, për vepra që nuk janë të dënueshme.

Do të duhej një herë e përgjithmonë të pamundësohet kjo, sepse në praktikë ka raste kur kanë funksionuar si abuzive edhe për të dënuarit politikë.

Ose te neni 36 - votimi jashtë vendit - vazhdon praktika, e theksoi edhe dikush prej parafolësve, diskriminuese e njerëzve tanë që ndodhen jashtë vendit.

Dikush konsiderohet i zhvendosur dhe ai ka të drejtë që të votojë, e lehtësime tjera. Por, dikush tjetër që është në të njëjtin status praktikisht nuk konsiderohet i zhvendosur.

Në një vend fqinj konsiderohet i zhvendosur dhe ka të drejta, në një vend tjetër fqinj, ose në disa vende tjera fqinja, nuk e ka këtë të drejtë. Kurse ligji thirret në trajtim të barabartë dhe Kushtetutë, e të tjera. Më në fund, duhet të rregullohen këto. Nuk mund të diskriminohet mërgata shumicë shqiptare për arsyt që u thanë dhe për shkak se ka përvoja pozitive përreth nesh, ta zëmë në Kroaci, e tjera, që janë dëshmuar efektive.

Është koha më në fund që edhe ne t'u mundësojmë mërgimtarëve tanë që të jenë pjesë e realitetit, sepse janë në fushën ekonomike, janë në çështje të mbijetesës zhvillimore e të tjera, pse mos të jenë edhe në procesin e funksionimit demokratik.

Ka, madje, këtu një referencë dhe ndërlidhje me Kreun XVI, por që del problematike edhe krejt e pakuptimtë. Ata që do të punojnë, i ftoj t'i krahasojnë këto.

Te dokumentet e pranueshme për të votuar, te neni 93, përsëri e kemi një konfuzion që është dëshmuar si abuziv dhe ne po e rilegjitimojmë prapë. Mund të votohet me letërnjoftim, me dokument të vlefshëm identifikues, që ka fotografi, kaq duhet, ose me pasaportë të vlefshme dhe dokument i udhëtimit të vlefshëm. Në gjuhën shqipe madje edhe tekstualisht, jo dokument i vlefshëm i udhëtimit, po dokument i udhëtimit të vlefshëm, se ka edhe udhëtim të pavlefshëm.

Dhe çka është dokumenti i vlefshëm i udhëtimit, ose dokumenti që ka një fotografi me të cilin votohet. A e mundëson kjo pastaj që të votohet dy herë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Edhe një minutë!

HYDAJET HYSENI: Është po ashtu anomalia e numërimit, siç e thatë, të pavarur me 2,5%, ai që është individual, nuk mund të krahasohet me entitete politike, ose me koalicione vetëm te ne është kjo.

Dy, do të duhej të amendamentoheshin pa nxitim këto, se është edhe një defekt që po na imponohet, si të thuash me ngut, dhe pastaj kjo po e pamundëson korrigjimin. Prandaj,

mendoj që më mirë është të na shtyhen pak zgjedhjet dhe të bëhen në kohën e duhur normale, sesa të nxitohemi me ligjin dhe pastaj ta paguajmë tagrin për një periudhë të tërë deri sa ta ndryshojmë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Si ish-kryetar i Komisionit ad hoc për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi zgjedhjet, më duhet të them se pavarësisht se ky draftligj nuk përmban ndonjë dispozitë me të cilën është bërë ndryshimi i segmenteve kryesore të sistemit zgjedhor, siç janë zonat, listat zgjedhore dhe vota preferenciale, prapëseprapë mendoj se ky draftligj është më i avancuar dhe më i kompletuar se sa ligji që është në fuqi.

Kur e them këtë, kam parasysh në radhë të parë përbërjen dhe strukturën e komisionit dhe të grupit punues zgjedhor, në të cilët trupa, përveç grupeve parlamentare, i kanë pasur përfaqësuesit e tyre edhe Shoqëria Civile, institucionet relevante vendore, siç janë KQZ-ja dhe GZAP-i, si dhe institucionet dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, siç janë: Komisioni Evropian, OSBE, ICO-ja, Ambasada e SHBA-ve, ajo e Britanisë së Madhe e tjera, të cilat institucione duhet falënderuar për përkrahjen dhe angazhimin e dhënë në përgatitjen e këtij draftligji.

Së dyti, duhet theksuar se këta trupa punues, me qëllim të përpilimit të një draftligji sa më cilësor, kanë punuar me një përkushtim të theksuar, duke e analizuar nen për nen, respektivisht paragraf për paragraf ligjin që është në fuqi, dhe duke i formuluar dispozitat më të mira të mundshme për rrethanat konkrete kosovare dhe duke u bazuar në legjislacionin dhe përvojat, jo vetëm të vendeve të regjionit, por edhe të vendeve tjera të Evropës dhe më gjerë. E tërë puna e këtyre trupave punues është kryer me një objektiv, respektivisht qëllim të vetëm që subjekteve politike kosovare dhe votuesit kosovar t'i ofrohet një ligj, i cili do të përmbante dispozita me të cilat do të garantoheshin zgjedhjet transparente, zgjedhje më të thjeshta, gjatë mbajtjes së të cilave do të zvogëlohej mundësia e keqpërdorimeve, e vjedhjeve, mashtrimeve, respektivisht e cenimit të vullnetit të lirë të votuesit kosovar.

Siç thashë më lart, ndonëse komisioni, për shkak të mungesës të konsensusit të karakterit politik, nuk ia doli që t'i ndryshojë dispozitat me të cilat rregullohet numri i zonave zgjedhore, vota preferenciale dhe natyra e listave zgjedhore, ia doli që të bëjë ndryshimin e numrit të madh të dispozitave të karakterit tekniko-juridik, me të cilat ndryshime ngrihet cilësia dhe funksionaliteti i këtij ligji. Unë shkurtimisht do t'i theksoja vetëm disa prej çështjeve, të cilat, sipas këtij draftligji, rregullohen më ndryshe në krahasim me ligjin në fuqi. Kështu, me dispozitat e këtij draftligji parashihet sforcimi i përpilimit dhe azhurnimet e listave zgjedhore, në mënyrë që të kemi lista me sa më pak gabime që të jetë e mundshme. Pastaj, votimi me kusht si njëri prej formave të votimit që ka shkaktuar probleme të shumta dhe ka qenë burim i keqpërdorimeve të panumërta, me këtë draftligj hiqet në tërësi.

Më tutje, duke pasur parasysh se herë-herë tollovitë e mëdha, të shkaktuara nga komisionarët dhe vëzhguesit, kanë mundur të jenë si rrethanë e volitshme për parregullsi të ndryshme, me dispozitat e këtij draftligji parashihet që numri i vëzhguesve të një subjekti politik në një vendvotim të jetë vetëm një, e jo dy, siç ka qenë më parë, me çka është zvogëluar numri i vëzhguesve për afro 7 000 veta.

Po ashtu, edhe çështja e ftesës dhe e sigurimit të vëzhguesve ndërkombëtarë është riformuluar dhe saktësuar. Përveç çështjeve të theksuara më lart, me këtë ligj janë ndryshuar edhe dispozitat me të cilat rregullohet struktura dhe kompetencat e komisioneve komunale zgjedhore, menaxherët e qendrave zgjedhore, këshillat e vendvotimeve, pastaj mënyra e financimit dhe raportimit për financimin e fushatës zgjedhore, pastaj është zvogëluar kohëzgjatja e fushatës zgjedhore nga 30 në 15 ditë, me çka do të kursehen shuma të theksuara të parave që do të shpenzoheshin për fushatë zgjedhore, si dhe do të kursehen qytetarët dhe simpatizantët e subjekteve politike nga tubimet dhe veprimet tjera të fushatës elektorale, herë-herë të panevojshme.

Edhe problemi i certifikimit të kandidatëve është rirregulluar dhe, sipas këtij drafti, personat që janë dënuar në tre vjetët e fundit me burg nuk do të mund të kandidohen. Në anën tjetër, dënimet kolektive janë hequr në tërësi, si dhe është përcaktuar lartësia e shpenzimeve të lejuara për fushatë për subjektet politike dhe atë deri në 50 centë për numër të votuesve.

Me dispozitat e këtij ligji, është trajtuar edhe Kodi i Mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore dhe zgjedhjeve në përgjithësi, duke i përcaktuar afatet kohore, vendet për vënien e materialit elektorale, por edhe sanksionet për mosrespektimin e tyre. Po ashtu, për OJQ-të që do të dërgojmë vëzhgues në vendvotime, janë përcaktuar në mënyrë decitive kriteret që duhet t'i plotësojnë vetë OJQ-të dhe vëzhguesit e tyre.

Gjithashtu, edhe çështja e ndihmës së personave me aftësi të kufizuara gjatë votimit është trajtuar duke ofruar zgjedhjen që një person mund t'i ofrojë ndihmë vetëm një personi me aftësi të kufizuara, mirëpo ka edhe shumë e shumë çështje të natyrave të ndryshme që janë shqyrtuar, kurse solucionet më të përshtatshme dhe më funksionale janë shndërruar në formë të dispozitave dhe janë inkorporuar në këtë draftligj.

Ndërsa, do të theksoja për deputetët, të cilët patën vërejtje lidhur me procesin e ndryshimit të ligjit, do të them se nëse keni ide, nëse keni mendime, propozime konkrete, ju lutem përgatitni amendamentet konkrete, shkruani dhe paraqitni në komision, sepse ende nuk është vonë të bëhet amendamenti i këtij draftligji, por le ta dinë se për ato amendamente do të votohet, si në komision, ashtu edhe në seancë, e ndodh që të njëjtat të mos kalojnë.

Në fund duhet theksuar se ky draftligj, para se të vijë në këtë Kuvend, është shqyrtuar, analizuar dhe përpunuar edhe nga Komisioni për Legjislacion. Prandaj, duke pasur parasysh punën dhe angazhimin e të gjitha këtyre komisioneve dhe grupeve punuese, vlerësoj se ky draftligj përmban dispozita më kualitative që do të garantojnë zgjedhje më

cilësore se sa ato të kaluara. Andaj, kërkoj nga deputetët e Kuvendit që të njëjtin në parim edhe ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më intrigoi sot diçka që dëgjova në këtë pikë të rendit të ditës dhe atë nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, i cili tha që deputetja Albulena Haxhiu e paska bllokuar reformën zgjedhore për 3 javë rresht, meqenëse e paska bllokuar Komisionin për Legjislacion.

Unë kam parë dhe kam dëgjuar që Albulena është një deputete goxha e fuqishme, por që e ka këtë fuqi kaq të madhe për ta bllokuar krejt punën e komisionit këtë nuk e kam ditur dhe nuk është se nuk më gëzon kjo.

Dje LDK-ja, në një komunikatë, ka thënë që “Vetëvendosje” është shumë e vogël për t’u marrë me çështje, siç e quanin, këta madhore, kurse sot Arben Gashi i LDK-së thotë që “Vetëvendosje” paska qenë aq e madhe sa ta bllokojë punën e komisionit dhe kjo, pra, ose na tregon që Arbeni nuk është i LDK-së tamam-tamam, ose na tregon që LDK-ja nuk është një, pra që kanë qëndrime të ndryshme për çështjen e njëjtë, edhe karshi subjekteve politike.

Është e vërtetë që formula e kontrabanduar, pra ajo e ‘D Hontit’, është formulë e cila shkon në dëm të proporcionalitetit, siç u tha edhe këtu, por nuk është problemi tash aty. Në këtë moment problem është procesi i kontrabandimit të kësaj formule në ligjin, në draftin e parë të ligjit që po e diskutojmë këtu, pa pasur miratim të komisionit, as të Komisionit ad hoc, e as të Komisionit për Legjislacion, dhe prapë unë i bashkohen edhe një herë Albulenës, e cila në emër të Grupit kërkoi edhe nga kryetari i Kuvendit, por edhe nga Administrata e Kuvendit, që ta ndjekin dhe ta hetojnë dhe ta zbardhin këtë ë rast për shkak se mendojmë se ky lloj kontrabandimi do të duhej domosdoshmërisht të ndëshkohej.

Pra, kjo formulë apo ndryshimi i kësaj formule ka qenë ide e njërit prej anëtarëve të KQZ-së, përfaqësuesit të Partisë Demokratike, Betim Gjoshi, dhe pastaj është kontrabanduar nëpërmjet kryetarit të Komisionit për Legjislacion në tekstin e ligjit. Pra, asnjëherë nuk është diskutuar as në Komisionin ad hoc, nuk është diskutuar as në Komisionin për Legjislacion, e aq më pak është votuar.

Kjo na e shpërfaq një logjikë që ka vazhduar për një kohë të gjatë në kuvendet e Republikës së Kosovës, logjikën e një forme të kontrabandimit të ligjeve dhe neneve në këto ligje. Pra, ajo logjikë që është përdorur më herët për ligjet që quheshin të planit të Ahtisarit, të cilat kanë kaluar nëpër Kuvend pa u shqyrtuar fare, tash po na ndjek edhe në Ligjin për zgjedhjet, siç ka qenë rasti edhe me disa ligje tjera, të cilat janë përshpejtuar në këtë Kuvend me arsyetimin se është në të mirën e vendit.

Po ju them, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, asnjë kontrabandim nuk është në të mirën e vendit, pavarësisht a është i mallrave, pavarësisht a është i neneve të caktuara të ligjeve dhe pavarësisht a është i ligjeve. Por, për të qenë i sinqertë, nuk më çudit kjo, sepse po ta analizojmë me kujdes - i tërë procesi i asaj që është quajtur reformë zgjedhore ka qenë një proces i kontrabanduar. Pra, nuk është një proces për të cilin ka pasur dakordancë të të gjitha subjekteve, aq më pak të qytetarëve të Kosovës. Është një proces për të cilin janë marrë vesh tre persona dhe ata tre persona pastaj vullnetin e tyre e kanë imponuar në Kuvend nëpërmjet deputetëve që i kanë këtu.

Të gjithë e dimë se si është themeluar ky Komision ad hoc. Është themeluar pas marrëveshjes, e cila e zgjodhi ose e nxori nga zarfi presidenten Atifete Jahjaga dhe e cila e nisi themelimin e dy komisioneve ad hoc, atë për reformën e sistemit zgjedhor dhe tjetrin për reformën kushtetuese.

Dhe, themelimi i komisionit natyrisht që i ka problemet e veta. Për shembull, njëri prej problemeve është ai që e kemi diskutuar këtu disa herë në Kuvend, e veçanërisht kur e kanë sjellë një copë letër ta quaj ashtu, të cilën ata e quanin raport. Ky komision, i cili e ka marrë një pjesë të konsiderueshme të energjiave edhe të resurseve financiare të këtij Kuvendi, nuk ka prodhuar në fund kurrfarë raporti domethënës dhe gjithëpërfshirës për të na shpjeguar ne të tjerëve, deputetëve që nuk kemi qenë pjesë të këtij komisioni se çfarë kanë diskutuar dhe këto konkluzione që i kanë arritur si komision, pse i kanë bazuar ata. Pra, ne nuk e dimë se si është diskutuar dhe si ka shkuar procesi i diskutimit të ndryshimit të sistemit zgjedhor.

E dimë që nuk ka ndryshuar asgjë. E kemi parë në draftin e ligjit që e kanë sjellë këta, me ato ndryshime që ata i kanë propozuar, por nuk e dimë se cili ka qenë diskutimi prapa tyre. Pra, na thuhet se është një proces i politizuar për të cilin jam dakord, por nuk na thuhet se kush e politizoi, si dhe pse? Në çfarë mënyre dhe me të cilat kërkesa? Pra, mendoj që ky komision ad hoc ia ka borxh këtij Kuvendi, sepse ky Kuvend e ka themeluar, ky Kuvend ia ka ndarë mjetet financiar, dhe ky Kuvend ia ka ndarë edhe kohën dhe energjinë dhe, rrjedhimisht, këta kanë përgjegjësi para këtij Kuvendi të na tregojnë se për këtë kohë sa kanë punuar çka kanë punuar, çka është diskutuar dhe si është diskutuar.

Pastaj, problemi i dytë është që, shumë shkurt, pas themelimit të komisionit, në fakt diskutimi për reformën zgjedhore kaloi te ato që quheshin takime të liderëve. Pra, prej një përqendrimi shkuam te përqendrimi tjetër. Përqendrimi tjetër ishte diskutimi i disa personave për sistemin zgjedhor në përgjithësi në Kosovë, të cilat takime mbaheshin kryesisht jashtë institucioneve, madje-madje edhe jashtë objekteve të institucioneve, dhe të cilat u krijuan si një lloj ndeje të disa prej udhëheqësve të partive politike, ku diskutonin çështjen që të gjithë po pajtohemi, është shumë me rëndësishme për demokracinë dhe për qytetarin e Republikës së Kosovës.

Dhe, një sistem i cili mëton të jetë gjithëpërfshirës, siç është sistemi zgjedhor, pra i cili formalisht ua garanton të drejtën që të zgjedhin dhe të zgjidhen secili qytetar të Kosovës, në diskutimin tonë është një sistem, i cili është diskutuar me përjashtimin flagrant të

këtyre qytetarëve nga pjesëmarrjet në diskutim. Pra, u tha këtu edhe nga ish-kryetari i Komisionit ad hoc që aty kanë marrë pjesë, përveç deputetëve edhe ICO-ja, edhe ambasadat edhe OSBE-ja, edhe EULEX-i, edhe të gjithë të tjerët, por nuk u tha asnjëherë që kanë marrë pjesë grupet e interesit, që kanë marrë pjesë grupet e qytetarëve dhe që është diskutuar kjo me ata të cilëve u takon si proces zgjedhor.

Pra, ky është monopolizim edhe uzurpim i sistemit zgjedhor, sepse është përqendruar në diskutimin ndërmjet subjekteve politike dhe përfaqësuesve të shteteve të ndryshme, apo organizatave mbishtetërore që gjenden në Kosovë.

Pra, nuk është sistem që ka qenë i mëtuar t'i përshtatet qytetarit dhe demokracisë, por është sistem i cili prej fillimit kanë qenë i mëtuar që të manipulohet për interesat e subjekteve politike.

Pra, ky mendoj unë është elementi i partizimit të skajshëm të këtij procesi zgjedhor dhe të këtij ligji që e ka prodhuar ky diskutim. Në vend se në Kosovë ta zgjerojmë demokracinë përfaqësuese, duke ia shtuar asaj pjesët përbërëse të saj, që janë demokracia e drejtpërdrejtë, demokracia pjesëmarrëse, ne po shkojmë duke e reduktuar edhe atë demokraci përfaqësuese pra në diskutim të një grupi të vogël të njerëzve dhe pastaj në krijimin e një shtate të liderizmit në politikë, ku e kemi tendencën për ta shtruar rrugën, për ta krijuar një parti - një njeri.

Pra, të gjitha ato që u diskutuan, që nuk po dua t'i përsëris prapë, të neneve të caktuara, mendoj që dërgojnë në këtë drejtim dhe mendoj që kjo është shumë e dëmshme për Kosovën. Nuk është aspak demokratike që në ligjërimit tonë politik më shumë t'i diskutojmë emrat e personave të veçantë se sa të diskutojmë koncepte politike edhe programe politike, dhe ajo po ndodh fatkeqësisht në Kosovë dhe kjo e dëmton rëndë politikën në përgjithësi, e dëmton rëndë pjesëmarrjen e qytetarëve në këto vendime politike dhe natyrisht që e dëmton edhe këtë Kuvend dhe demokracinë, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziri e ka fjalën. Le ta lexojnë Rregulloren deputetët që janë pa grup parlamentar.

XHEVDET NEZIRI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!
Kolegë deputetë,

Unë do të flas shkurt për arsye se shefi i grupit i paraqiti vërejtjet në emër të Aleancës, po për mua është shqetësuese se në zgjedhjet e fundit janë 100 mijë fletëvotime të pavlefshme. Do të thotë, njerëz nuk kanë ditur të votojnë dhe nuk kanë ditur të votojnë për arsye se po ndryshohet ligji prej zgjedhjeve lokale në zgjedhje të përgjithshme brenda 3-4 muajsh. Derisa në zgjedhjet lokale bartës i listës ka qenë kryetari dhe nëse është jashtëligjor dhe është antikushtetuese, atëherë pse tash?

Do të thotë, duhet pasur një rregull, për arsye se tek popullata po shtimë huti, do të thotë s'po dihet se çka po votohet.

E dyta është organizimi i votimit jashtë vendit. Unë po e përmend një praktikë që si subjekt politik në komunën e Istogut i kam fituar zgjedhjet dhe më vonë, kur OSBE-ja ka pru zgjedhjet të një partie politike serbe, jam ndalur dhe nuk jam përfaqësues në komunë të Istogut dhe dua të dyshoj, sepse nga kanë ardhur ato kuti dhe se si janë votuar jashtë vendit. Nëse i është dhënë e drejta komunitetit serb të votojë jashtë Kosovës, atëherë pse s'i është dhënë komunitetit egjiptian që jeton në Mal të Zi, ose edhe në Serbi? Atëherë, nuk duhet që të përdoren dy kritere.

Dhe kështu që tani ka mbetur padrejtësisht në komunën e Istogut pa përfaqësues, për arsye se ka ardhur me vota të paketuara një përfaqësues i partisë politike serbe dhe jam dalë nga këto zgjedhje.

Një diçka tjetër është se një praktikë e di se rezultati përfundimtar më së shumti vonohet në Kosovë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare certifikimi i zgjedhjeve na ka zgjatur hiç më pak, se 3-4 muaj. Dhe, kjo në asnjë vend të botës, përafërsisht me 2 milionë banorë, siç jemi ne, nuk ndodh përveç në Kosovë, për arsye se ka ndryshime të ligjit.

E dyta, është përbërja e KQZ-së. Në KQZ janë të përfaqësuara të gjitha partitë politike parlamentare dhe të gjitha komuniteteve. Vetëm te tri komunitetet ndodh rotacioni, te komuniteti rom, egjiptian dhe ashkali nuk kemi përfaqësues, po njëri nga këto tri komunitetet me rotacion. Atëherë, pse të ndodhë kjo, kur të gjitha komunitetet kanë përfaqësues, ku të gjitha subjektet parlamentare kanë përfaqësues, atëherë pse të mos ndodhë që edhe këto tri komunitete të kenë nga një përfaqësues në Komisionin Qendror Zgjedhor? Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Kolege poslanici,

Posebno stavljam akcenat na članove komisije za izborne reforme. Imam niz primedbi na rad Centralne Izborne Komisije. Član 6 govori o mandatu, sastavu i imenovanju članova, gde i pored upozorenja u pismenoj formi i predsednici naše zemlje, kao i predsednici Centralne Izborne Komisije da jedan od članova Bajram Latifi, kao jedini nepromenljivi član CIK-a, već celu deceniju, gde sam i za ovom govornicom govorila o kršenju zakona u opštim izborima i nisam naišla na razumevanje, niti sam dobila bilo kakvu vrstu odgovora u pismenoj formi od Centralne Izborne Komisije, te postoji velika zabrinutost ostalih bošnjačkih političkih partija NDS-a, CDU-a, SDA-a i drugih građanskih inicijativa o ponovnoj malverzaciji, oko imenovanju komisionera po opštinskim izbornim centrima, zatim promene biračkih centara meštanima Župe i Podgore, koji su bili prinuđeni da putuju više od 10 kilometara, da bi obavili svoju građansku dužnost u procesu glasanja, a naši posmatrači apsolutno nisu imali uvid u to kome i gde ti uslovni glasovi idu i kojoj partiji ili zajednici se pripojavaju.

Takođe, nekoliko biračka mesta na zadnjim lokalnim izborima su anulirana, u nekim selima iz nepoznatih razloga, upravo tamo gde je naše najjače glasačko biračko telo, što govori o kršenju demokratskog prava svakog glasača.

Zatim član 20 govori o sastavu članova opštinske izborne komisije, gde tačka b kaže da jedan član može biti imenovan od strane političkog subjekta, koji su prešli izborni prag na zadnjim izborima za skupštinu Kosova i imaju jedno mesto u Parlamentu Kosova.

I ovo pravo nam je bilo uskraćeno na prošlim lokalnim izborima, odnosno pravo na članove opštinske izborne komisije a zatim i komisionere po biračkim mestima i centrima.

Zatim član 31, tačka e, kaže da porodične veze su konflikt interesa i zloupotreba radnog mesta članova CIK-a, a svedoci smo da na svim izborima do sada, za ove 14 godine član CIK-a Bajram Ljatići krši zakon te postavlja svoju ćerku, sestru, zeta i celokupnu njegovu rodbinu, što možete proveriti i na spiskovima opštinske izborne komisije u opštini Prizren.

Žalili smo se organima CIK-a, međunarodnim izbornim posmatračima, te sada iznosim ovu problematiku za vladom u nadi da će Komisija za zakonodavstvo ali i nadležni pravosudni organi obratiti više pažnje, te zaustaviti razne malverzacije oko zloupotrebe službenog položaja, koji direktno utiče na izborne rezultate političkih partija, kršeći demokratsku izbornu volju građana.

Ono što je, po meni, u ovom trenutku najbitnije, je član 107, izborni sistem za Skupštinu Kosova, odnosno član 108, govori o raspodeli mesta, gde se manjinskim poslanicima ukida pravo na rezervisana mesta, te ostaju samo garantovana. U momentu kada sve nacionalne zajednice pokušavaju da se na najbolji mogući način afirmišu na ovo kosovsko društvo kao autohtoni narod, koji vekovima živi na ovim prostorima, gradeći zajednički su život sa svima, apelujući na mir i toleranciju, uvažavajući i jedne i druge uz poštovanje vrednosti različitosti i ne mogu prihvatiti izjave pojedinih albanskih lidera o rezervisanim mestima, koji u ovom momentu predstavljaju sigurnost, zastupljenosti manjinskih zajednica u institucijama Kosova, a ne politički marketing političkih određenih partija na samom pragu centralnih izbora.

Koristim priliku, da se u ime bošnjačke zajednice zahvalim američkoj ambasadori na javnoj podršci manjinskim zajednicama u vezi rezervisanih mesta kao i specijalnom izaslaniku Evropske Unije na Kosovu gospodinu Samuelu Žbogar. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Pikërisht para dy muajve kam bërë një shkrim autorial në mediet e shkruara dhe elektronike për reformën zgjedhore dhe çfarë sistemi zgjedhor ka nevojë Kosova.

Duke qenë ish-anëtar i Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe fatkeqësisht që puna e atij komisioni nuk përfundoi kurrë dhe tani iu dha Komisionit për Legjislacion, po shihet qartë se nuk ka një diskonim të partive politike, kuptohet të partive të mëdha politike, për një reformë të mirëfilltë zgjedhore.

Këtu u përmendën edhe sistemet e vendeve demokratike, unë mund të them se familjet e sistemeve zgjedhore janë të shumta, si ato mazhoritare, proporcionale, gjysmë proporcionale, vota bllok, përfaqësimi proporcional e të tjera. dhe pikë nuk iu ka vënë askush këtyre sistemeve zgjedhore.

Për këtë arsye konsideroj se ne kemi filluar punën si komision nga bishti e jo nga kryet, sepse ne fillimisht është dashur vetëm ta zgjedhim llojin e sistemit zgjedhor çfarë do ta marrim dhe ato do të rridhnin vetë këto finesat tjera të cilat ne sot po i diskutojmë.

Kam aq shumë vërejtje për këtë sistem zgjedhor, sa që nuk e di se a do të bëhet një reformë e mirëfilltë, ashtu qysh u kemi premtuar qytetarëve të Kosovës, ashtu qysh Komisioni për Reformën Zgjedhore e ka marrë mandatin nga ky Kuvend, për t'i bërë ato reforma.

Konsideroj se Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme apo reforma zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme nuk ka përfunduar me të njëjtën frymë, të cilën ne e kemi filluar si komision. E kemi punuar vërtet me përkushtim, por fillimisht ne bëmë plane dhe në vija të trasha me vërejtje e sugjerime tona se çka do të ndryshojmë nga ky ligj zgjedhor.

Por, fatkeqësisht, më vonë e kuptuam se jemi të pafuqishëm për të ndryshuar ato pikat esenciale të ligjit. Kështu që sa herë që vinim të ndryshimet esenciale të ligjit, si për shembull, për zonat zgjedhore, lista të hapura apo të mbyllura, për pragun zgjedhor, gjithherë duhej tejkaluar, sepse na thuhej se për këto ka mbetur me u takua liderët politikë për të vendosur. Thjeshtë, ne u morëm me disa finesa të panevojshme si komision, jo pse ne nuk kishim kohë, se nuk dëshironim t'i ndryshonim ato gjëra të vogla, por ato kanë mundur të ndryshohen nga ekspertët e zgjedhjeve dhe nuk kishte pasur nevojë që deputetëve t'u jepet një mandat i tillë dhe pastaj të merreshin vetëm me finesa të vogla të zgjedhjeve.

Kjo është edhe arsyeja që në fillim thashë se nuk kemi përfunduar, nuk ka përfunduar reforma zgjedhore me të njëjtën frymë, qysh e kemi filluar. Ne si komision punuam me përkushtim, por kur u kuptuam se ishim të pafuqishëm, atëherë ishte vonë dhe punuam, më duket për aq kohë, sa u nevojitej liderëve politikë të partive të mëdha, që ata të fitonin në kohë dhe këtë qëllim ata e arritën. Dhe, pas një pauze njëvjeçare, tani në mënyrë të ngutshme iu dha Komisionit për Legjislacion, që kjo “reformë” zgjedhore të përfundojë sa më shpejt.

Unë konsideroj se për vendet demokratike, që u përmendën këtu, ka ndryshime të vazhdueshme në sistemin zgjedhor, madje ato bëhen edhe të shpeshta edhe të shumta. Por, ato në të gjitha vendet e botës në përgjithësi bëhen për dy arsye. Në vendet demokratike ato bëhen për të ndryshuar ligjin, që ajo t'i përshtatet nevojave të popullatës

dhe nevojave të vendit, në mënyrë proporcionale, në mënyrë të zonave zgjedhore, që qytetari të jetë më afër zgjedhësve të tyre.

Dhe, kjo, kemi menduar ne si komision, se ne do ta bënim këtë të arritshme, që të jemi sa më avër votuesve, por ka edhe ndryshime të cilat i bëjnë vendet e ndryshme të botës, që është e kundërta e kësaj, për ta reformuar sistemin zgjedhor, që të jetë një sistem më i afërt, ose me iu përshtatë nevojave të qytetarëve, por bëhen ndryshime për t'ia përshtatur partive në pushtet, për t'ia përshtatur ligjin, që ata prapë t'i fitojnë zgjedhjet.

Kjo po ngulfat demokracinë në vendin tonë dhe i kemi të njëjtat parti politike që janë në pushtet, e kanë bërë sikur me rotacion, herë njëra parti për të ardhur në pushtet, herë tjetra, por nuk kemi frymë të re demokratike në Kosovë që mund të vijë përmes zgjedhjeve të lira. Kësaj jam duke iu frikësuar.

Dhe, mund të jap vërejtje shumë të rëndësishme, mendoj, tek zonat zgjedhore, sepse sikur të zgjidhnim me zona zgjedhore, atëherë edhe listat do t'i kishim të qarta, se kanë mund të jenë edhe të mbyllura, ose të hapura. Por, nëse ne e kemi vetëm një zonë zgjedhore, atëherë në asnjë mënyrë nuk mund të vijë listat e mbyllura.

Po ashtu, te pragu zgjedhor, të mos harrojmë se me pragu zgjedhor po bëhet një diskriminim i madh, ku 15% e qytetarëve të cilët marrin pjesë në zgjedhje do t'u izolohet vota e tyre, për shkak të pragut zgjedhor dhe të zgjedhurit e tyre nuk do të arrijnë të vinë në Parlament, për t'i përfaqësuar ata e aq më tepër, diskriminimi më i madh është ndaj kandidatëve të pavarur, të cilët nuk kanë një prag natyral, ku për shembull, për shumicën shqiptare janë 100 vende në ulëse në Parlament dhe ato 100 vende kanë mund të jenë për kandidatin vetëm pragu natyral 1%, e jo pragu 2,5%, sepse ai duhet të fitonte vota sa për 3 deputetë, ndërsa do të përfaqësohej vetëm nga një person.

Konsideroj, se kjo reformë zgjedhore është një reformë kozmetike dhe nuk do t'i sjellë shumë pozitivitet reformës zgjedhore, të cilën ne kemi synuar dhe nuk do të ketë ndryshime të mëdha edhe në zgjedhjet e ardhshme, të cilat do të mbahen, pak a shumë do të jenë të ngjashme me ato të vitit 2010. Por, shpresoj që me amendamentimet që do të bëhen nëpër komisione, vërtet të ketë gjëra, të cilat do ta përmirësojnë rrënjësisht reformën zgjedhore dhe të kemi një sistem zgjedhor që do ta kishin lakmi edhe vendet tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, unë në parim edhe në Komisionin për Legjislacion e kam votuar edhe kundër edhe këtu do ta votoj kundër, për faktin se kam dhen edhe arsyetimet dhe prapë po e them, se nuk është ligj i cili paraqet një reformë të mirëfilltë të zgjedhjeve në Kosovë.

Paraqet një modifikim teknik nga ligji i kaluar, ndërsa në kuptim të plotë të fjalës nuk kemi reformë zgjedhore me këtë projektligj, i cili ka ardhur në mënyrë mjaftë të ngutshme, me të vetmin arsyetim që kur ta kemi një projektligj, atëherë edhe do të shkohet në zgjedhje sa më shpejt.

Vetë mënyra e procedimit dhe ngutja në këtë projektligj ka bërë që ky projektligj të devijojë nga binarët e reformës zgjedhore. Dhe, ajo çka është më e rënda, unë mendoj që katër pika kryesore, katër shtylla kryesore më bëjnë që të votoj kundër këtij projektligji.

Në radhë të parë, është se edhe me këtë projektligj, fatkeqësisht hapet dera, një derë tjetër e re shtesë për vjedhje të votave. E kemi pasur në zgjedhjet e kaluara një përvojë jo të mirë me keqpërdorim të votës, ndërsa me këtë projektligj hapet prapë dera e keqpërdorimit të votës së qytetarëve.

Kjo është në faktin ku kemi të bëjmë me numërimin e votave, kur është vendosur që numërimi i votuesve të bëhet në vendvotim, ndërsa i fletëvotimeve, do të thotë, të subjekteve politike që garojnë të bëhet në vendvotim, ndërsa në qendrat e numërimit të numërohen votat e secilit kandidat që ka qenë për deputet.

Do të thotë, në qendra të numërimit dashur e padashur dikush mund të dërgojë përfaqësues të vet, i cili qoftë brenda vetë subjektit t'i keqpërdor vota, qoftë nga subjektet tjera.

Prandaj, kjo është shtylla kryesore, që hap derën për vjedhje të sërishme të votave me këtë projektligj. Derë tjetër, e cila prapë e hap mundësinë, që e kam kundërshtuar fuqishëm, ka qenë edhe mënyra e votimit të votuesit në vendvotim. Kam propozuar që kabina e votuesit të jetë e kthyer, do të thotë votuesi të jetë i kthyer me shpinë nga komisionarët, në mënyrë që të përcillet çdo lëvizje e tij manuale, vizuale dhe fizike, për faktin se kemi një përvojë jo të mirë në zgjedhjet e kaluara edhe të përgjithshme edhe lokale, kur shumë votues janë imponuar të votojnë për iks-partinë e caktuar apo për iks-kandidatin e caktuar, vetëm e vetëm që ta ruajnë vendin e tyre të punës dhe këtë duke e dëshmuar përmes fotografimit të tyre përmes telefonave celularë apo në forma të ndryshme.

Prandaj, me kthimin e kabinës së votuesit nga komisionarët, do të pamundësohet që një gjë e tillë të bëhet, do të thotë, fotografimi i votës dhe keqpërdorimi apo shantazhimi i votuesit.

Kjo është ajo çka ka qenë sa i përket keqpërdorimit të votës, ndërsa shtyllë e tretë, që unë nuk pajtohem me këtë projektligj është edhe pragu zgjedhor, i cili ka mbetur i lartë, por fatkeqësisht është rritur edhe më shumë për koalicione. Unë mendoj që nuk ka qenë këtui qëllimi që një apo dy parti të mos kalojnë në këtë Parlament, sa ka qenë dilema e disa partive të caktuara që të parandalojnë ndarjen e partisë apo ndarjen e deputetëve dhe të formojnë formacione të vogla politike dhe t'u pamundësohet atyre që të jenë pjesë e Parlamentit të Kosovës.

Unë mendoj, në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës, në kundërshtim të plotë me vullnetin e qytetarëve, sepse po kemi monopol të partive në Parlament dhe nuk po kemi përfaqësim të denjë të qytetarëve të Kosovës, prandaj vetë pragu i madh është kundërkushtetues dhe kundër vullnetit të qytetarëve të Kosovës.

Dhe, vërejtja ime e katërtë është për diasporën, e cila fatkeqësisht është lënë anash në këtë proces. Nuk kemi një gatishmëri edhe nga vetë KQZ-ja që t'i lehtësojë procedurat e votimit të qytetarëve tanë që jetojnë jashtë Kosovës. Të mos harrojmë se pothuajse gjysma e Kosovës, më shumë se 40% të qytetarëve të Kosovës jetojnë jashtë Kosovës dhe atyre me këtë projektligj nuk u mundësohet, apo nuk do të kenë lehtësime të pasurit të drejtë në votim.

Prandaj, këto katër shtylla më bëjnë të pamundur që ta mbështes këtë ligj i cili në parim nuk paraqet reformë të mirëfilltë zgjedhore dhe do të votoj kundër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Do të provoj të jem i shkurtër, vetëm dy vërejtje, domethënë, mendoj në aspektin ligjor, t'i paraqes.

E para, te përkufizimet, te neni 3, mungon Komisioni i Numërimit. Numërimi i votave deri më tani është bërë në Qendrën e numërimit të votave dhe është bërë nga ekipet e numërimit.

Mendoj që do të duhej të rregullohet me ligj kjo çështje dhe të kemi në përkufizime edhe Komisionin e Numërimit dhe të përcaktohen, domethënë, ato të cilat janë detyra, deri tani kanë qenë për ekipet e numërimeve, të jenë, domethënë, detyra për arsye se është komision, i cili bën numërimin e votave.

Dhe, nëse provohet që të avancohet me anë të këtij ligji, numërimi i votave të jetë edhe më transparent, jo vetëm në një qendër numërimi, por numërimi i votave të jetë edhe në qendrat komunale nëpër komuna, atëherë ky sigurisht se do të ketë nevojë t'i kemi edhe komisionet e numërimit të votave.

Dhe, çështja e dytë ka të bëjë me nenin 75 të “veprimet e ndaluara nga subjektet politike”. Në pikën 1, domethënë është e paraparë domethënë abuzimi me të drejtën e ankesës, që duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme të pavlera irrituese në PZ AP. Mendoj se gjithsesi këtu duhet të shtohet edhe “shpifja me qëllim të dëmtimit të kandidatëve apo subjekteve të caktuara politike”, për arsye se të nderuar kolegë deputetë, ju e dini që në zgjedhjet e fundit lokale edhe djali im i pa lindur atëherë është akuzuar se ka votuar disa herë nga subjekti politik i “Vetëvendosjes”, për të cilën edhe kam ngritur kallëzim penal pas përfundimit të zgjedhjeve.

Dhe, sigurisht, shpifje të këtij niveli të cilat janë të dërguara edhe në formën zyrtare të ankesave në PZAP, domethënë duhet të sanksionohen me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Balje e ka fjalën.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem se predsedavajući!

Ja ću se fokusirati na dve tačke član 107 i 108. Izborna reforma odnosno zakon o izborima koji je započela komisija je nedorađena, dvosmislena i jako nejasnoće. Ja mislim da se nalazimo na jednoj stranputici gde se baziramo znači na stvari zakon o izborima koji je bio dosta loš i spremamo se za nove parlamentarne izbore sa novim zakonom o izborima koji takođe dosta kritikujemo i nalazimo se znači na jednoj, jedna deo zakona koji dosta kritikujemo a koji bi morao znači da se izglasa i dolazimo u situaciju da li da usvojimo ovaj zakon ili ne.

Ipak fokusira ću se znači na deo koji se bazira na član 107. I 108. Svaki certifikovani politički subjekat će se pojaviti na glasanje sa otvorenom listom. U demokratiji otvorena lista znači puno pravo svakog člana te liste da bude izabran odnosno da bi mogao znači da prođe u Parlamentu Republike Kosova.

Međutim, odmah iza toga sledi isti, koji označava glasom za jedan i političkog subjekta. Malte ne u manjinskim zajednicama odnosno u političkim subjektima koji su manji ne može doći do izražaja onaj koji je drugi, treći, četvrti ili deseti na toj listi.

Ja mislim da se tu ukida demokratsko pravo svakog člana te liste odnosno političkog subjekta koji se pojavio na izborima.

Član 108. Govori o raspodeli mesta. I član 108 se bazira na raspodelu zagarantovanih mesta i ne spominju se rezervisana mesta o kojima se mi jako dugo borimo i ja mislim da zaslužujemo da makar u još jednom mandatu dobijamo ta rezervisana mesta.

Čak bih, u zadnjem pasusu člana 108 tačka 1. Trebalo bi se izbrisati, ako je broj dobijenih glasova svake zajednice manje od broja garantovanih mesta, i dodati svako mesto koje je dodatno usvojeno na izborima potrebnim brojem dobijenih važećih glasova nezavisno od izbornog praga 5% za većinsku zajednicu biva pridodato 20 zagarantovanih mesta za zajednice kosovskih Srba i ostalih nevećinskih zajednica.

Član 108 tačka 4, broj glasova znači kandidata. U ovom članu postoji ovaj dosta nejasnoće i ja bih samo da obrazložim u kratkim crtama.

Svi glasovi koji je dobijao kandidat čije se ime nalazi na otvorenoj listi političkog subjekta će se brojati pojedinačno. Ova rečenica nije dovršena i ne govori se o političkom subjektu gde se ističu znači veće političke subjekti koji bi imali dupli veći broj glasova od ostalih manjih ili novo formiranih političkih subjekata gde prvi kandidat odnosno nosioc liste ako nema duplo veći odnos od 50% veći broj od 50% dobijenih glasova neće moći steći pravo da se kandiduje za Parlamentu Republike Kosova. Izvršiće se, kaže

reorganizacija liste na osnovu padajućeg niza sve u skladu sa brojem glasova koje je dobijao svaki kandidat.

Znači opet se ne govori o političkom subjektu nego o kandidatu. Ja mislim da je ovaj član 108 tačka 4 dvosmislen i da bi se trebao izmeniti odnosno na drugom glasanju bi se trebalo dodati amandman koji bi trebalo znači tačno i jasno odrediti da li politički subjekat iz nevećinskih zajednica dobija ili kandidat, onda dolazi u obzir da se ne većinske partije bi trebalo oformiti jednu širu koaliciju i svaki kandidat bi trebalo dobiti osim onog nosioca koje ste napomenuli u ovom zakonu, što veći broj glasova. To je jedan vid udruživanja.

Još jednom bih naglasio znači da ovaj zakon bi trebalo znači dosta preciznije odraditi i ova komisija koja odradila po meni ad hoc ovaj posao bi trebalo sesti i da se još jednom razmotriti i do drugog čitanja, tačno preformulisati neke tačke i stavove i članove koje se tiču posebno znači manjinskih zajednica i ja mislim da naročito bošnjačke zajednice i ja mislim da ćemo u rad ove komisije učestvovati i zauzeti pravi stav da li ćemo ostaviti znači reformu odnosno Zakon o izborima po novom ili ćemo ići znači na izbore po starom zakonu o izborima. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Kosovë pas zgjedhjeve të vitit 2010 është iniciuar një debat mbi nevojën për reformën e sistemit zgjedhor dhe ky debat në Kosovë është përqendruar kryesisht në Ligjin zgjedhor e shumë pak ose nuk është diskutuar fare në mënyrë të informuar mbi atë se cili sistem zgjedhor do t'i përshtatej më shumë Kosovës në rrugën e saj të tranzicionit drejt një shoqërie demokratike.

Edhe ky ligj që po e diskutojmë tash, nuk e ka prekur sistemin zgjedhor, por është përpjekur që teknikisht të jetë më i avancuar dhe më i qartë. Ligji ka për qëllim të rregullojë së paku sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikën e Kosovës, financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar, listën e votuesve, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike. Po ashtu ky ligj rregullon përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin dhe funksionimin e panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtrës, riorganizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve, si dhe rregullat për akreditimin e vëzhguesve në fushatën zgjedhore.

Vërejtjet e mia në ligj në vazhdimësi do të jenë në çështjen e bartësit së listës, numërimin e votave dhe votimin me kusht, sepse të gjitha këto çështje kanë ndikim të caktuar dhe në shumicën e rasteve nuk arrijnë të përfshijnë... të cilat pastaj janë rezultatet e pritshme nga miratimi i ligjit.

Ky ligj i mundëson KQZ-së kohën e mjaftueshme që të avancojë logjistikën zgjedhore, të bëjë pastrimin e listave, të bëjë modernizimin e sistemit elektoral që votat të numërohen në mënyrë sa më transparente.

Ky ligj përcakton obligimin e institucioneve që janë organizuese të zgjedhjeve, të bëjnë me kohë edukimin e votuesve dhe mos të ndodhë pra sikur në zgjedhjet lokale ku fatkeqësisht ka munguar kjo pjesë e organizimit. Vetëm në komunën time, për shembull nga zgjedhjet e fundit 4 mijë vota kanë dalë të pavlefshme, si pjesë dhe mungesë e një edukimi paraprak ose një fushate paraprake të Komisionit Zgjedhor.

Unë do të përkrah në parim dhe sigurisht se amendamentet që do t'i kemi do t'i adresoj me kohë te Komisioni përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Meni je žao što mora da ukažem na neke stvari što pojedini poslanici zloupotrebljavaju Skupštinsku upravu, prvenstveno se izvinjavam i bošnjačkoj zajednici što mi ispred bošnjačke zajednice moramo da jedni drugima ukažemo na neke stvari koje na žalost mnogi poslanici ne poznavaju.

Kada je u pitanju imenovanje CIK-a, član 6 koji govori o tome o imenovanju CIK-a po zakonu o opštim izborima na Kosovu članovi CIK-a imenuju se na osnovu pobjede. Ako pojedini poslanici to ne znaju, ja ću ih posjetiti da je koalicija Vakati u bošnjačkoj zajednici apsolutni pobjednik nakon rata pa do današnjeg dana tako da mi ispred koalicije Vakati imamo i svoga predstavnika u CIK-u a inače to je uređeno i zakonom.

Dalje. Kada su u pitanju članovi biračkih komisija, opet bi ukazao pojedincima koji e bave sa porodičnim stvarima da se članovi biračkih komisija postavljaju onako kako odredi partija a ne kako to zloupotrebljavaju upravu Skupštine i kažu da to ide po porodičnoj vezi, znači ne određuju pojedinci.

I mislim da danas oni koji govore o drugima, koji se bave o drugim stvarima, bolje bi bilo da se govori, kada je u pitanju nosilac liste, gde sigurno neko imaju svoj interes, i evo ja ću opet ispred koalicije Vakati ukazati na primedbu da zaista kada je u pitanju nosilac liste znamo da to nije realno jer na taj način neće biti interesovanje za uzimanje odnosno za učešće na izborima po gotovo kada su u pitanju nevećinske zajednice i mi smatramo na jedan način da je to zatvorena lista jer se ne daje prostor ostalim kandidatima koji će biti na listi da bi se izborili kada znamo da pojedine partije osvojiće po jedan glas.

Inače što se tiče naših primedbi vezano za zakon o izborima mi smo ispred Parlamentarne grupe 6+ govorili tako da ćemo svoj rad dati do drugo čitanje, da ćemo aktivno učestvovati i nadam se da će neki naši amandmani proći u komisiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe unë do t'i jap disa vërejtje, do të thotë lidhur me Ligjin për zgjedhje dhe që në fillim po përmendi që do të thotë rezultatet e zgjedhjeve si pikë e parë duhet të jenë transparente, pastaj të jetë i saktë edhe numri i votuesve dhe i votave të vlefshme e po ashtu edhe i votave të pavlefshme për shkak se gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, do të thotë, kemi pasur parregullsi në këtë drejtim dhe po thuaj se një e dhjeta votë ka qenë e zhvlerësuar për shkak të procedurave, do të thotë, të ndërlikuara dhe komplekse të votimit që i kemi parë në zgjedhjet e fundit. Po ashtu të integrohen do të thotë, afatet nënligjore që i harton KQZ-ja, këto të jenë të inkorporuara brenda Ligjit zgjedhor.

Një vërejtje që e tha, më duket kolegu Kelmendi që kabina zgjedhore, do të thotë të kthehen në anën e kundërt nga e cila kanë qenë të vendosura deri tani, në mënyrë që të sigurohet, do të thotë, të jenë të dukshme për vëzhguesit dhe komisionarët dhe mundësia e manipulimit, do të thotë të jetë sa më e vogël. Të zgjatet periudha e verifikimit të listës së votuesve dhe kjo listë të bëhet publike nga data kur shpallen zgjedhjet, do të thotë kemi parë gjatë zgjedhjeve të kaluara që ka pasur parregullsi, do të thotë votuesit kanë pasur telashe që t'i gjejnë emrat e tyre brenda listës dhe është mirë që kjo të saktësohet, do të thotë me kohë dhe që mos të jetë i ndërlikuar dhe kompleks ky proces i votimit.

Dhe, krejt në fund, është mirë që të shtohet një pikë e veçantë, do të thotë në cilën do të përcaktohet edhe përbërja e KKZ-ve, në kontekstin e përfaqësimit gjinor. Këtë po e përmend dhe propozoj që të reflektohet një pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve të nivelit 30% në KKZ, sepse në zgjedhjet e kaluara shumica e pjesëtarëve në kuvendet komunale zgjedhore kanë qenë meshkuj dhe është mirë që të ketë edhe një përfaqësim të grave në këtë drejtim.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme është që të shkurtohen afatet e publikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Kemi pasur afate të stërzgjatura dhe është mirë që këto afate të shkurtohen dhe të jenë precize. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi, besoj për replikë është lajmëruar.

EMILIJA REDŽEPI: Ne, nije replika! Gospodine predsjedavajući, ne želimo da polemiziramo sa pojedinim osobama.

Ja sam se obratila nadležnim organima pa neki oni preispitaju članove CIK-a. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

Le t'i bihet ziles. Sa veta janë prezentë? Do të thotë, në qoftë se ka kuorum, e votojmë e nëse s'ka...

Sa u bënë? Meqenëse s'ka kuorum, sepse janë 59 deputetë, duhet të jenë edhe 2.

(Ndërhyrje)

Si? Janë 59.

(Ndërhyrje)

E tani kemi kuorum! Unë ju kisha lutur të votoni të gjithë, nëse doni të kalojë ligji, e në qoftë se vetëm 1 nuk voton, atëherë nuk konsiderohet ligji i votuar, pa marrë parasysh kush voton për ose kundër.

A ka ndokush pa kartelë që është në sallë? Nuk ka.

Atëherë, lus regjinë dhe juve kolegë dhe kolege të përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

A janë 61, dhe a kanë votuar të gjithë?

Meqenëse u shtuan edhe disa deputetë, tani janë 64, po e votojmë për së dyti, sepse ka edhe një ankesë që ka gabuar në votim. Pra po e votojmë edhe një herë dhe votojmë tani.

Janë 64 deputetë në sallë.

Faleminderit! Konstatoj se me 44 vota për, 18 abstenime dhe 2 vota kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-165 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*